

---

Harrone Vietnamin .....	3
Palestina.....	5
Fitoreja dhe tre jo- të .....	7
Pejgamberi si mësues .....	10
Dija obligim fetar dhe domosdoshmëri kohore .....	15
Virtytet e nxënësit.....	19
Bë mirë! .....	23
Mikpritja e Ramazanit .....	28
Metoda e Ehli Sunnetit .....	32
Gjërat që bëjnë dobi në kohë të fitneve .....	49
Rregulla për hifz .....	51
Zinaja .....	54
Statusi social i femrës perëndimore .....	57
Abdul Kadir Xhejlani.....	63
Imam Ebu Davud et Tajalisi .....	66
Tema: Urtësia e agjërimit .....	67
Ramazani .....	68
15. Bujaria.....	70

---

edicion i botuar / viti i parë / nr: 15

botues: ALBISLAM

kryeredaktor: Ramadan Ramadani

redaksia: Bekir Halimi, Talha Kurtishi,  
Alajdin Idriz, Fatmir Zaimi

[www.albislam.com](http://www.albislam.com)

[albislam@albislam.com](mailto:albislam@albislam.com)

str: 386 no: 11 lokal: 44

1000 Shkup

fax: +389 2 3290 408

## Harrone Vietnamin...

Harrone Vietnamin dhe brengosuni për Irakun dhe Afganistanin

Kudo që është, Osama bin Ladeni do të gëzohet javën e ardhshme përderisa e shikon qytetin tim të dashur, New Yorkun, të shndërruar në një kamp të armatosur dhe të kërcënuar nga 250 mijë demonstrues të mllefosur, anti-Bush, në një thyerje të mllefosshme komunale.

Sheik Osama vazhdimisht është kërcënuar se Amerika asnjëherë nuk do të shijojë paqen nëse nuk tërhiqet nga Lindja e Mesme dhe ndërpret përkrahjen për Izraelin. Ai i ka urdhëruar pasuesit e tij të sulmojnë zemrën e fuqisë së Amerikës, ekonominë e saj dhe t'i mbajnë amerikanët në te.

Bin Ladeni ka qenë tmerrsisht i suksesshëm. Sulmet e 11 shtatorit i kanë kushtuar Amerikës 98 miliardë dollarë, dhe me miliarda të tjera në vjet për mbajtjen e sigurisë së brendshme. Paralajmërimet e vazhdueshme dhe në periudha politikisht të caktuara të Administratës së Bushit për sulmet e ardhshme të Al-Qaedas – që asnjëra nga ato nuk u materializua – dhe histeria mediale, i kanë bërë amerikanët të trishtuar dhe emocionalisht të rraskapitur.

Konventa e Republikanëve që do të mbahet këtu do të mbrohet nga 37 mijë policët e qytetit – forcë dyfish më e madhe se e gjithë ushtria e Kanadasë; 10 mijë policë do të mbrojnë qendrën ku do të mbahet konventa, Madison Square Garden, të ndihmuar nga mijëra të tjerë nga FBI-ja, ATF-ja, Shërbimi Sekret dhe "Federalë" të tjerë.

Edhe më tej, nuk ndalen thashethemet se Al-Qaeda mund ta sulmojë Konventën – edhe pse përvoja tregon se Al-Qaeda dëshiron të sulmojë ku më së paku, jo më së shumti, pritët.

Postbllloqet, pikat e kontrollit, dritat e kuqe, paramilitarët jashtëzakonisht të armatosur dhe autobлиндat do të shndërrojnë trafikun në New York në ankth, do të shqetësojnë tregtinë, dhe do të bëjnë që qyteti më i rëndësishëm në botë të duket si Damasku gjatë një revolucioni ushtarak, ose si ri-incizimi i filmit "Escape From New York" (Ikja nga New Yorku)

Përderisa ky spektakël i çuditshëm hapet, fushatat e Bushit dhe Kerryt janë duke u fjalosur rreth Luftës së Vietnamit, 30 vjet e vjetër – në një kohë kur Sh.B.A.-të janë duke i humbur luftërat që i udhëheq në Irak dhe Afganistan, ku deri tani kanë vdekur më shumë se 1 mijë ushtarë amerikanë.

Asnjëri kandidat nuk ka paraqitur ndonjë plan real për ballafaqim me këto situata të vështira ushtarako-politike.

Bushi vazhdon të intonojë klishetë pa domethënie siç janë: "duhet të rrimë në këtë drejtim" ose "duhet të luftojmë për lirinë". Kerry vazhdon të premtojë se trupat nga Evropa dhe Shtetet Muslimane në një mënyrë do të përfshihen në zëvendësimin e amerikanëve në vijën e frontit në Irak. Askush nuk duhet të besojë në pakuptimësitë e tilla.

Mirëpo, se paku, Bush ka pasur qëndrime të vazhdueshme ndaj Irakut, edhe pse vazhdimisht ka qenë gabim. Kerry vazhdon të ndërrojë pozitën e tij dhe seriozisht ka dëmtuar kredibilitetin e tij duke u përpjekur të jetë edhe pro-lufte dhe kundër-lufte në të njëjtën kohë.

Fushata e fëlliqur që u lansua kundër dosjes luftarake të Kerryt nga një grup i finansuar nga Republikanët i quajtur "Swift Boat Veterans" (Vete-

ranët e Anijes së Shpejtë) poshtëruan reputacionin e të dy kandidatëve dhe edhe më tej kanë dëmtuar imazhin, tanimë të prishur të Amerikës në botë.

Reagimi i dobët i Kerryt ndaj sulmeve të turpshme Republikane duket si edhe një dëshmi për dobësi dhe pavendosmëri.

Si mund që fushata e Kerryt të vazhdojë duke lejuar një president që i ka ikur ftesës ushtarake të sulmohet dosjen luftarake të tij. Ndoshta Kerry është shumë i butë. Si mund që amerikanët e denjë dhe organizatat e veteranëve, si "American Legion" (Legjioni Amerikan), të cilës i takoj, të pranojnë këtë aktivitet të turpshëm dhe mos të reagojnë me mospajtim ndaj presidentit dhe njerëzve të tij? Kjo nuk është politikë, kjo është fëlliqësi e qartë.

Si një veteran i ushtrisë amerikane, e di se mirënjohjet ushtarake shpesh ndahen shumë lirë në një proces të dyanshëm të masazhës së shpinës, dhe të egzagjuar për të promovuar karriera.

Kerry mund të mos jetë Ramboja i tillë Demokratik, siç e përshkruajnë përkrahësit e tij, por së paku ai ka qenë atje, në luftë – përdërisa Bushi ka bërë paraqitje si musafir në Gardën Nacionale të Teksasit dhe Alabamas.

Administrata e Bushit nuk u largua nga thënia e shumë gënjeshtërve rreth kërcënimit jo-ekzistues irakian – duke përfshirë edhe armët bërthamore të Irakut dhe pohimet e presidentit se irakianët do të shpërndajnë helm në Amerikën e përgjumëshme.

Pra, pse të tërhiqet Shtëpia e Bardhë nga orkestrimi i fabrikimeve kundër një kërcënimi serioz – së paku ndaj presidencës aktuale – të quajtur John Kerry?

Bush dhe Kerry duhet të debatojnë se si t'i tërheqin 150 mijë trupat amerikanë jashtë dy lufërave që Amerikës i kushtojnë 6.5 miliardë dollarë në muaj. Një raport i parado-

kohshëm i Kongresit spanjoll vlerëson se nëse Bushi nuk do të sulmonte Irakun, çmimi i naftës tani do të silleshte rreth 30 dollarë për barel, e jo 43 dollarë për barel.

Amerikanët ende duhet ta kuptojnë çmimin e plotë të aventurave të këqija të administratës. Ose faktin se regjimet e vogla në Irak dhe Afganistan nuk mund të mbijetojnë pa mbrojtjen masive dhe permanente nga ana e Sh.B.A.-ve. Me fjalë të tjera, nuk ekziston ndonjë zgjedhje e parashikueshme politike për asnjë luftë, dhe për këtë shkak asnjëra nuk mund të quhet "fitore". Vetëm edhe shumë miliardë dollarë të shpenzuara dhe shumë jeta të humbura.

Asnjëri kandidat nuk është duke ua treguar amerikanëve të vërtetën rreth Irakut, Afganistanit ose rreth gabimisht të ashtuquajturës "luftë kundër terrorizmit". Për fat të keq shumë amerikanë nuk dëshirojnë të dëgjojnë për faktet shqetësues, njëjtë siç e kuptoi guvernatori Howard Dean gjatë turpërimit të tij.

E vërteta e fuqishme është se Sh.B.A.-të janë ngatërruar në dy luftëra koloniale që nuk mund të fitohen, që më saktësisht është ajo që Bin Ladeni një kohë të gjatë e ka dëshiruar. Strategjia e tij është ta zgjerojë (gjakderdhë) Amerikën nëpër një numër të konflikteve të vogla, shkatërruese.

Sh.B.A.-të janë me të madhe nën sulme të militantëve islamikë (të quajtur si 'terroristë') të cilët nuk e urrejnë Amerikën për shkak të, siç pohon Bushi, lirisë dhe demokracisë së saj, por për shkak të asaj që Sh.B.A.-të janë duke e bërë në Botën Muslimane.

Një analist anonim i CIA-s, i cili sapo botoi librin e tij të ri brilliant, "Imperial Hubris" (Arroganca Imperiale) e quan invazionin e Bushit në Irak, "akull në tortën e Bin Ladenit".

Amerikanët duhet të debatojnë rreth kësaj, e jo të rikthejnë Vietnamin.

Eric S. Margolis  
15.10.2004

## Palestina, kjo është gjendja, cilat janë shpresat?

### Lajmi

Refugjatët palestinez në Jordani, të cilët janë më shumë se gjashtë milion, e ripërtërinë në përkrahjen e vazhdimin të intifadës dhe rezistencës kundër okupatorit izraelit për të fituar të drejtën e tyre për kthim në vendbanimin e vet, nga i cili i ka dëbuar Izraeli me fuqi ushtarake, dhe të drejtën e tyre për themelimin të shtetit palestinez të pavarur me Kudsin si kryeqytet të vet.

Gjatë kontakteve të ndryshme që i kanë patur programet e ndryshme satelitore me shumë refugjat, me rastin e hyrjes së intifadës në vitin e pesë, ata kanë potencuar se intifada e ka kthyer unitetin kombëtar të popullit palestinez në Palestinë dhe në vendet tjera, pas përçarjes e cila erdhi pas nënshkrimit të udhëheqësisë së Organizatës për çlirimin e Palestinës të marrëveshjes së Oslos me Izraelin në vitin 1993.

Refugjatët janë të mendimit se intifada ka shpalosur zbehtësinë e të gjitha marrëveshjeve palestineze me Izraelin, gënjeshtërën e pretendimeve izraelite për pranim të paqës përballë rikthimit të tokave palestineze dhe arabe të okupuara, ashtu sikurse intifada ia ka kthyer konsideratën çështjes së refugjatëve, të drejtën e tyre për kthim dhe kompenzim, pasi që në Oslo u injoruan tërësisht.

Refugjatët thonë se intifada e ka bërë unike rezistencën palestineze dhe ka arritur që ta dështojë projektin sionist, i cili u impononte zgjedhje nënshtruese popullit palestinez me fuqinë e armës.

Të dëbuarit mendojnë se fuqia ushtarake

izraelite nuk ka arritur sukses në ndaljen e intifadës dhe rezistencës dhe se vazhdimi i tyre do ta detyrojë Izraelin që të pranojë zgjidhje që do të mer pëlqimin e popullit palestinez, duke themeluar shtetin palestinez në tokën e vet dhe zgjidhje të drejtë çështjes së refugjatëve.

Sa i përket reziqeve që i kanosen intifadës e cila personifikohet me represionet e ritura izraelite dhe të ndihmuara politikisht nga Amerika në një anë dhe nga reziku i dështimit politik nga ana tjetër, të gjithë refugjatët ishin të mendimit se: "besimi i popullit Palestinez dhe forcave politike të saja në këtë zgjidhje na bën edhe më të bindur për kalimin e këtyre reziqeve".

Refugjatët gjithashtu kanë thënë: "ne nuk shpresojmë prej arabëve që ta luftojnë Izraelin, sepse kjo gjë ka përfunduar për ne, mirëpo kërkojmë prej tyre që ta ndalin valimin e flamurit izraelit përmbi kryeqytetet e shteteve arabe dhe ta ndalin normalizimin e marrëdhënieve me këtë shtet sionist, derisa ta kupton Izraeli dhe aleati i vet Amerika, se palestinezët nuk janë vetëm".

### Komenti

Ska dyshim se gjendja e popullit Palestinez dhe gjendja e tokës, të cilën Allahu e ka bekuar, që nga okupimi i padrejtë në vitin 1948 e deri para katër viteve, para se të fillon intifada e të përhap aromën e vet, e cila e ripërtërinë besimin, e ngjall shpresën dhe e pjek ummetin, ka qenë shumë e mërzitshme, sepse ishin të poshtërsuar njerëzit e shtypur në ato vende të pastra, poshtërsim të cilin e kishin sjellur ata

që ishin ulur në foteljet e tyre të mëdha dhe me zemra përplot me qelbësi dhe sëmundje.

U shtua poshtërsimi kur u shtua derdhja e gjakut si lum nga pleqtë e paaftë, gratë e veja dhe fëmijët bonjak, kurse askush nga ummeti nuk lëvizte. Aty binin kufomat në gjakun e tyre herë pas here, masakrime të cilat i bënin sionistët, vepra me të cilat e ndërtonin të ashtuquajturin shtet të tyre.

Kjo ishte gjendja... dëshiruan të përdorin poshtërsimin, gjakun dhe kufomat që të bëhen themelet e ndërtimit, shtetit dhe faltores së tyre, mirëpo do Zoti që ta bëjë betejë e cila i pastron zemrat, të ripërtërinë shpresën në zemrat e njerëzve, të qetëson shpirtat me rënien e shehidave një pas një, derisa të vijë premtimi i All-llahut i shkruar dhe se kjo që ndodh edhe pse është gjë e dhimbshme, është lindje e mëngjesit të ti, ringjallje e shpirtit, pastrim nga ai poshtërsim, i cili u është ngjitur shpirtërave para se tu ngjitet trupave dhe mendjeve.

Erdhi çështja që të furon gjaku dhe të shpërthen pjesa e mbetur e mishit dhe eshtrave që të vret dhe dridh atë ndërtesë. Palestinezët e krijuan frikën e cila i ka mbushur zemrat e çifutëve, të cilët janë kundërrthënës në fjalët dhe veprat e tyre, kurse interesi i tyre kryesor është si ta ndal intifadën dhe njerëzit e intifadës, si ta ndal këtë rebel që doli nga skuti i vet, e çliron veten nga prangat me të cilat e kemi lidhur me shekuj dhe si tua kthejmë sionistëve sigurinë në tokën e premtuar.

Njerëzit e intifadës shijuan shijen e nderit dhe krenarisë, larguan nga zemrat, shpirtërat dhe trupat e tyre petkun e poshtërsisë dhe nënçmimit, kurse ai që shijon të hidhurën e pastaj shijen e lirisë, ai nuk dakordohet asesi përpos se me lartësi.

Intifada nuk do të ndalet edhe përshej kurtheve dhe hileve, ky vullkan që ka shpërthyer nuk do të ndalet nga nxjerja e flakës që ta mbulon atë papastërti që e ka mbuluar tokën, edhe pse është i nxehtë, ai do ta pasuron tokën dhe do ta pastron ummetin. Këto zemra të gjalla dhe shpirta përplot sinqeritet, të cilat e kanë flijuar edhe këtë në rrugë të Zotit janë fillim dhe do të udhëzohen nga Zoti në rrugën e drejtë, sepse: "E ata, të cilët luftuan për hir Tonë, Ne me siguri do t'i orientojmë rrugës për te Ne, e nuk ka dyshim se All-llahu është në krahun e bëmirsëve". (El-Ankebut: 69).

Kurse kurtha sadoqë është e madhe dhe e fuqishme nuk mund ta dëmton të mirën, sepse: "E, ata (jehuditë) i kurdisën një dredhi (mbytjen e Isait), All-llahu iu kundërvu dredhisë së tyre, All-llahu është asgjësuesi më i fuqishëm kundër atyre që bëjnë dredhi". (Ali Imran: 54).

Vetëmse kanë filluar të vijnë ditët e All-llahut, jemi duke e nuhatur aromën e tyre, shpejt do të zbret dhurata hyjnore: "E Ne duam t'i lartësojmë ata që u shtypën në tokë, t'i bëjmë udhëheqës dhe t'i bëjmë trashëgues. Dhe atyre t'u japim pushtet në tokë, ...". (El-Kasas: 5).

Marrë nga: islammemo.com

Përktheu: B. H.

15.10.2004

## Fitoreja dhe tre jo- të

Shkaqet e fitores janë të shumta, sikurse i përshkruan sureja Jusuf, disa i kemi përmendur, kurse këtu do të flas për disa, që sipas meje, janë më të rëndësishmet.

Prej shkaqeve më të mëdhaja të ngadhnjimit të Jusufit, alejhisselam, është: kompaktësia e metodologjisë së tij që nga fillimi i jetës e deri në fund të jetës së tij, ai tërë këtë kohë e kalon në një vijë të drejtë.

Këtë e themi sepse jemi të vetëdijshëm për konfuzionin i cili gjindet te disa thirrës, këtë konfuzion e shohim edhe në jetën dhe metodën e disa organizatave dhe institucioneve islamike. Një organizatë fillon me një metodë të caktuar, pas disa viteve e shohim se e ka ndëruar atë metodë, pas tredhjet viteve ose katërdhjet viteve, ajo organizatë më nuk është e njëjta sikur në fillimin e vet, ndonëse i ka mbetur vetëm emri dhe disa simbole. Disa thirrës disa vite i thërrasin njerëzit në metodë të shëndoshë, e kur të bëhet i njohur dhe të fillojnë fitoret e tija, fillon edhe ndryshimi i tij, ose pasi që të sprovohet, ndryshohet, ose për shkaqe tjera.

Jusufi, alejhisselam, nuk ndryshoi aspak që nga fillimi i jetës e deri në fund të saj:

"Andaj, ti përmbaju asaj që po të shpallet, e s'ka dyshim se ti je në rrugë të drejtë". (Ez-Zuhruf: 43).

Kjo kompaktësi dhe mosndryshim është prej shkaqeve më të rëndësishme të fitores, mirëpo fatkeqësisht e neglizhojnë shumica e thirrësve, andaj edhe në ankesë thonë: pse dështuam? Pse nuk fituam?

Sepse nuk ngadhnyet ndaj vetes, nuk u kapët për metodën e vërtetë sikur që u kap për te Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sellem, pronar i metodës që nuk ndryshon as në kohëra të mira e as në vështirësi, kurse sprovat vetëm ia shtojnë fuqinë, qëndruesën dhe kompaktësinë:

"A menduan njerëzit të thonë: "Ne kemi besuar, e të mos vihen në provë?". (El-Ankebut: 2).

"Po ju menduat se do të hyni në xhennet, pa u provuar edhe ju me shembullin e atyre që ishin para jush, të cilët i patën goditur skamjet e vuajtjet dhe qenë tronditur, saqë i dërguari thoshte, e me te edhe ata që kishin besuar: "Kur do të jetë ndihma e All-llahut"?! Ja (u erdhi ndihma) vërtet ndihma e All-llahut është afër"! (El-Bekare: 214).

Domethënë fitoreja qenka afër, mirëpo problemi është tek ne dhe tek kapja ynë për këtë metodë.

Prej komponenteve më të mëdhaja të fitores është mosnxitimi, mos dhënia koncesione në fe, largimi nga të qëndruarit, dëshpërimi ose demoralizimi, unë këto gjëra i quaj tre jo-të. Nëse dëshiron fitore atëherë thuaj:

- jo nxitimit;
- jo koncesioneve;
- jo dëshpërimit.

Kam studiuar realitetin e shumë xhemateve islamike dhe i parashtrosha vetvetes pyetjen: pse nuk kanë realizuar atë që kanë premtuar?

Kuptova se kjo gjë ka shumë shkaqe, mirëpo prej më të dalluarave është se ekziston një pjesë e njerëzve që nxitojnë, dëshirojnë të

realizojnë fitoren për kohë rekorde, andaj për këtë shkak ata veprojnë vepra që janë në kundërshtim me metodën, për shkak të nxitimit.

Ka njerëz që e thërrasin popullin e tyre, e pasi të kalon një kohë e nuk përgjigjen, ngrihen kundër tyre dhe ballafaqohen me ta në përmjet armës, e fillojnë luftë në vend dhe kohë të gabuar. Sa e sa e kanë dëmtuar ummetin këta njerëz të ngutshëm! Kurse të zgjedhurit e pejgamberëve kanë duruar derisa u ka ardhur fitorja nga Zoti.

Kurse koncesionet shumë njerëz i kanë rëzuar. Xhemi i tyre e përcakton metodën dhe ajo në të cilën dëshiron ti edukon njerëzit, pasi që të kalon një kohë dhe vëren se nuk ka arritur atë që ka synuar dhe që u ka premtuar tjerëve, fillon me koncesione me zullumqarët gjersa ajo organizatë dhe shoqatë ose ai individ shëndërrohet në formë pa realitet dhe do të vërejmë në fund se nuk ka dallim mes tyre dhe zullumqarëve përpos se në pak gjëra. Kjo është koncesion në fe dhe mbështetje në zullumqarë.

Grupi i tretë, ata punojnë në dave, e kur të kalojnë disa vite, ata nuk kanë nxituar e as që kanë bërë koncesione, mirëpo kur nuk e kanë parë përgjigjen e njerëzve, janë dëshpëruar dhe janë tërhjekur nga skena!

Kurse Jusufi, alejhisselam, i ka luftuar këto tre komponente:

"...pse ai që ruhet dhe bën durim, s'ka dyshim All-llahu nuk humb shpërblimin e punëmireve". (Jusuf: 90).

Pra, pa nxitim, pa koncesione dhe pa dëshpërim.

O ju thirës!

Ju që keni institucione për thirje në fe, sa jeni të kapur për këto çështje të mëdhaja? A nxitoni? Nëse keni shpëtuar prej kësaj, urime. A bëni koncesione në emër të interesit të përgjithshëm, nëse nuk keni bërë koncesione, urime. A ka depërtuar dëshpërimi në

zembrën tuaj, nëse jo, urime.

Këto komponente janë të rëndësishme në fitoren e muslimanit dhe nëse i praktikon një individ, një institucion dhe një ummet sigurisht se do të fiton. Fitore me kuptimin e vërtetë, e jo vetëm fitim të pushtetit, sepse fitimi i pushtetit është një lloj fitore, kurse fitoreja më e madhe është fitoreja e metodës, andaj; vjen në ditën e kijametit Pejgamber me grup njerëzish, grupë të vogël, vjen Pejgamber me një njeri, me dy njerëz, ose ndonjë Pejgamber vjen vetëm, pa askend, siç ka ardhur në hadith të vërtetë. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

"Kam parë një Pejgamber të cilit i kishte besuar vetëm një njeri".

Duhet qenë të bindur se të gjithë pejgamberët kanë fituar:

"Ne patjetër do të ndihmojmë të dërguarit tanë në jetën e kësaj bote, edhe ata që besuan, e edhe në ditën e prezentimit të dëshmive". (Gafir: 51).

"...Obligim Yni ishte të ndihmojmë besimtarët". (Er-Rum: 47).

Secili Pejgamber ka fituar, fitorja e tij është në qendresën e tij në metodë, në mos konfuzionin, në kapjen për rregullat dhe pikënisjet në të cilat thërret, kjo është fitoreja e vërtetë, e nëse pas kësaj ndodh që edhe njerëzit i përgjigjen ftesës së tij, edhe kjo është fitore, e nëse arrin edhe në pushtet, edhe kjo është fitore, mirëpo fitorja më e madhe është fitoreja e metodës, e tjerat janë nafi.

Sa shumë kemi nevojë për këto komponente me qëllim që të arrime fitore për ne dhe ummetin tonë. Kemi nevojë të madhe për llogari të vetvetes dhe autokritikë të vërtetë dhe të çiltër: pse nuk fitojmë? Pse nuk ka fituar ummeti edhe pse ka ofruar mund të madh në historinë e vet, shtatëdhjet vjet i shohim organizatat islamike, institucionet islamike, të cilat kanë dhënë mund për të



cilën falenderohen dhe kjo nuk mund të u mohohet, kanë ofruar flijime, të cilat janë bërë shembull për flijimin për fenë dhe akiden, mirëpo vërejmë se nuk ka arritur fitoren, as fitore në metodë e as në realitet, vallë pse?

Sepse nuk i ka plotësuar komponentet e fitores, të cilat i kishte marrë Jusufi, alejhisselam.

Kur Herakli e pyetke Ebu Sufjanin, radijall-llahu anhu: pasuesit e Muhammedit a shtohen ose pakësohen? Tha: shtohen. Tha: kështu është puna e pejgamberëve derisa të plotësohen.

E njehta vlen edhe për thirrësit edhe për xhematet, a shtohen anëtarët ose paksohen. Disa xhemateve u paksohet numri, në një kohë u shtohet, e pastaj fillon tu paksohet. Andaj prej shkaqeve të mosfitores është moskëzistimi i këtyre komponeneve në jetën e thirrësit, xhematit dhe ummetit, e pastaj e themi: pse nuk fitojmë?

"E kur juve u goditi një dështim (në Uhud) e që ju ia patët dhënë atë dyfish (armikut në Bedr), thatë: "Prej nga kjo"? Thuaj: "Ajo është nga vetë ju"! S'ka dyshim se All-llahu është i plotëfuqishëm për çdo send". (Ali Imran: 165).

"...Obligim Yni ishte të ndihmojmë besimtarët". (Er-Rum: 47).

"Ne patjetër do të ndihmojmë të dërguarit tanë në jetën e kësaj bote, edhe ata që besuan, e edhe në ditën e prezentimit të dëshimive". (Gafir: 51).

"(nuk dërguam tjetër vetëm burra e ndihma u vonua) Derisa të dërguarit gati e humbnin shpresën (se do t'i besojë populli), dhe menduan se u përgënjeshtuan (pse ende nuk i kapi dënimi), atëherë u erdhi atyre (të dërguarve) ndihma Jonë. Ne e shpëtuam atë që deshtëm...". (Jusuf: 110).

Ajetet e ngadhnjimit janë të qarta, kurse All-llahu nuk e then premtimin e Vet, atëherë bëhet e qartë se defekti është te ne, qoftë si individ, bashkësi, institucion ose shoqëri, andaj nëse nuk arrijmë fitore duhet pyetur veten, sepse po iu referuam Kur'anit dhe Sunnetit do të shohim se:

"Ju kam lërë në mesin tuaj që nëse kapeni për to nuk do të devijoni asnjëher: Libri i All-llahut dhe Sunneti im".

Nëse ne kapemi me të vërtetë për këto burime do të realizojmë fitore të madhe në kohën e tashme dhe në ardhmëri.

Ti që je thirrës, ti që je dijetar, ti që je musliman, kapu për këto komponente në të cilat aludon jeta e Jusufit, alejhisselam, nëse dëshiron fitore në të tashmen dhe të ardhmen, me lejen e All-llahut.

Nëse fiton ndaj vetes, epsheve, dëshirave dhe pasioneve tuaja, nëse metoda është e shëndoshë, larg bidateve dhe gjërave të shpikura, nëse nuk nxiton, nëse nuk bën koncesione, nëse nuk demoralizohesh, nëse nuk humb shpresë, përgëzo, sepse premtimi i All-llahut sigurisht se do të realizohet:

"... pse ai që ruhet dhe bën durim, s'ka dyshim All-llahu nuk humb shpërblimin e punëmireve". (Jusuf: 90).

All-llahun e lus që ti realizojë këtij ummetit fitoren që ia shpresojmë, në duar të dijetarëve, thirrësve dhe institucioneve të veta. E lusim All-llahun që të na e kënaq syrin me ngritjen e flamurit të kësaj feje dhe flamurin e xhihadit në rrugë të Zotit që të ngadhnjejë mbi armiqtë e vet, jo vetëm me shpresa boshë, por me fakte të vërteta.

Prof. dr. Nasir Sulejman El-Omer,  
1.10.2004

## Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, si mësues

Pasi që jemi në fillimin e vitit shkollor dhe pasi që në hutbet e kaluara folëm për rëndësinë e mësimit, arsimimit, shkollimit dhe disa këshilla që ua drejtuam mësimitdhënësve, të cilët, gjithashtu, kanë rol të rëndësishëm në këtë drejtim, tani do t'ju prezantojmë disa çështje që kanë të bëjnë me shembëlltërinë supreme, e ai është Muhammedi, alejhisselam, i cili përveç se ka qenë Pejgamber i Zotit, ka qenë edhe mësues dhe pedagog.

Andaj të gjithë neve muslimanëve duhet të na interesojnë edhe karakteristikat e tija që kanë të bëjnë me mësimitdhënien dhe pedagogjinë, me synim tu ofrojmë mësuesve tanë edhe një përvojë shume të bujshme dhe detyrimisht të saktë dhe të shëndoshë, pasi që në këtë drejtim ka vepruar në bazë të udhëzimeve hyjnore.

Një: Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, është emërtuar në Kur'an mësues.

Pa dyshim se roli i çdo pejgamberi është mësimi i ummetit të vet dhe udhëzimi i tyre kah e mira.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"Ai është që arabëve të pashkolluar u dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre që t'ua lexojë ajetet e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë librin dhe sheriatin, edhe pse më parë ata ishin në një humbje të dukshme". (El-Xhuma: 2).

"(Sikurse plotësova mirësinë Time ndaj jush) Ashtu siç dërguam nga gjiu i juaj të dërguar t'u lexojë ajetet Tona, t'ju pastrojë, e t'ju mësojë librin dhe traditën, e edhe t'ju

mësojë atë që nuk e dinit". (El-Bekare: 151).

U doli Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, te shokët e tyre dhe i gjeti duke lexuar dhe mësuar Kur'an, mes tjerash u tha:

"Jam dërguar si mësues". (Ibën Maxhe).

"All-llahu nuk më ka dërguar të vështirë dhe vështirësoj, mirëpo më ka dërguar mësues dhe lehtësues". (Muslimi).

Muavije ibën Hakemi ka thënë:

"Nuk kam parë mësues me mësim më të mirë se ai as para tij e as pas tij". (Muslimi). Kurse në transmetimin e Ebu Davudit qëndron:

"Nuk ka parë mësues më të butë se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem".

Dy: Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, është mësuesi më i madh

Studimet pedagogjike konsiderojnë se mënyra më e mirë për vlerësimin e nivelit të mësuesit është vlerësimi i nxënësve të vet. Andaj nëse mbështetemi në këto studime do të vijmë në përfundim se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka qenë edukatori dhe mësuesi më i madh, sepse për nxënësit dhe studentët e tij All-llahu, subhanehu ve teala, ka thënë:

"Ju jeni populli më i mirë, i ardhur për të mirën e njerëzve, ...". (Ali Imran: 110).

Tre: Karakteristikat e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, për të cilat ka nevojë secili mësues

Ska dyshim se karakteristikat e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, virtytet e tija dhe morali i tij i madh janë të shumta, ne

do t'i përmendim vetëm disa prej tyre, për të cilat ka nevojë secili mësues, i cili dëshiron të pason Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në realizimin e detyrës së tij edukativo arsimuese.

#### a) Kujdesi

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vie rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndijshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët". (Et-Teube: 128).

Një herë i ka thënë Ebu Dherrit, radijall-llahu anhu:

"Ebu Dherr! Po të shoh të dobët, kurse unë dua për ty atë që ia dua vetes". (Muslimi).

"Shembulli im dhe i ummetit tim është sikur shembulli i njeriut që ka ndezur një zjar, kurse insektet dhe fleturat synojnë të bien në te, kurse unë ju kapi që mos të bini atje, e ju insistoni të bini në zjar". (Muslimi).

#### b) Butësia dhe ngrohtësia gjatë udhëzimit

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"All-llahu është i butë dhe e do butësinë në çdo gjë". (Buhariu).

Në transmetimin tjetër qëndron:

"Kudo që është butësia ajo gjë është e stolisur, kurse nëse largohet prej ndonjë gjëje ajo shëmtohet". (Muslimi).

Nga butësia e tij është edhe ajo që ka treguar Enesi, radijall-llahu anhu, për te, kur iu ka drejtuar me: "djali im". (Ahmedi).

Enesi, i cili i ka shërbyer Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ishte njeriu me sjellje më të mirë. Më dërgoi një ditë për një nevojë. I thash: vall-llahi nuk shkoj, kurse nga brenda dëshiroja të shkoj sepse më kishte urdhëruar Pejgamberi, sal-

lall-llahu alejhi ve sel-lem. Dola në rrugë, aty ku luanin fëmijëet, kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, më kapi nga mbrapa dhe më tha i buzëqeshur: Unejs, a ke shkuar atje ku të dërgova? I thashë: jam duke shkuar, o i Dërguar i All-llahut".

Nga butësia e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, është edhe ajo që e tregon Abdullah ibën Xhafer ibën Ebi Talibi, kur tregon:

"Më përkdheli mbi kokë tre herë". (Ahmedi).

Në këtë hyn edhe dashuria që ka patur me sahabet, saqë secili prej tyre ka menduar është i dalluar te Ai, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Amr ibën Asi, radijall-llahu anhu, thotë:

"Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, drejtohej me fytyrën e tij kur bisedonte kah njerëzit që tua zbutë zemrën. Aq shumë e mbante fytyrën dhe bisedën kah unë saqë mendova se jam më i miri. Thash: o Resulull-llah, a unë jam më i miri ose Ebu Bekri? Tha: Ebu Bekri. A unë jam më i miri ose Omeri...". (Tirmidhiu).

Xherir ibën Abdullah El-Bexheliu, radijall-llahu anhu, ka thënë:

"Asnjëher nuk më ka kthyer kokën Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, që nga dita që jam bërë musliman dhe çdo herë që më ka parë buzëqeshej me mua". (Buhariu).

Xhabir ibën Abdullahu, radijall-llahu anhu, thotë:

"Asnjëher ska thënë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, jo". (Tirmidhiu).

Enesi, radijall-llahu anhu, ka thënë:

"Vall-llahi, i kam shërbyer Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhjetë vite nuk di që ndonjë herë për ndonjë gjë që kam bërë më ka thënë: pse e ke bërë këtë vepër, ose për ndonjë gjë që e kam lërë: pse nuk e ke bërë kështu". (Muslimi).

Në transmetimin e Ahmedit qëndron: "As-

njëher nuk më ka thënë: of".

Në transmetimin tjetër të Ahmedit qëndron: "Asnjëher nuk më ka sharë e as nuk më ka thënë: of".

Tregimi i Muavije ibën Hakemit, para të cilit teshtisi një njeri, kurse këta të gjithë ishin në namaz, e ai ia tha: jerhamukall-llah. Ai e tregon këtë e pastaj thotë: të gjithë njerëzit më shikun, e thash: vaj për mua, pse po më shikoni? Atëherë njerëzit i ranë kofshave me duar, e kur e pashë se dëshirojnë të më heshtin, unë heshta. Kur u krye namazi, më thirri Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, fliofsha për te babë e nënë, sepse ai nuk më rrahu, nuk më qortoj e as nuk më shau. Nuk kam parë mësues më të mirë se ai asnjëher. (sahih, Nesaiu dhe Ebu Davudi).

Një beduin u ngrit dhe u urinos në xhami. U ngritën njerëzit ta ndalin, kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, u tha: lereni dhe derdhni një kovë ujë në vendin ku ka urinosur, sepse ju jeni dërguar të lehtësoni e jo të vështirësoni". (Buhariu dhe Muslimi).

### c) Modestia

Mësuesi duhet të jetë modest me nxënësit e vet, duhet të kujdeset për gjendjen e nxënësit të dobët, duke i mundësuar sqarime dhe kohë shtesë.

Ebu Rifaa'h thotë: shkova te Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kurse ai ishte duke mbajtur hutbe. I thashë: O Resulull-llah, një njeri i huaj, i cili nuk e din fenë, ka ardhur të pyet për fenë. U drejtua kah unë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e la hutben, ia sollën një karigë, mendoj se i kishte këmbët e hekurta, u ul në te dhe filloi të ma mësojë fenë. Pastaj e vazhdoi hutben e tij dhe e përfundoi". (Muslimi).

Enes ibën Maliku, radijall-llahu anhu, thotë:

"Një grua që kishte diçka në kokë i tha Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem:

unë kam nevojë për ty. I tha: shiko se në cilin vend dëshiron të takohemi, që ta kryej nevojën tënde". U vetmua në një vend dhe ia keru nevojën që kishte.

Dakordohet me veprat të njeriut të dobët me të cilat nuk do të ishte dakorduar po të ishin të fuqishëm

Kur i erdhi Damam ibën Thalebe dhe kërkoi prej tij ti mësoi obligimet e Islamit, Damami tha: Vall-llahi as nuk do të shtoj e as nuk do të pakësoj". Atëherë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha:

"Do të shpëton nëse të vërtetën e flet". (Buhariu).

Mirëpo nuk u mjaftua me ka te disa të tjerë, por kërkoi edhe disa veprime tjera që hyjnë në sunnete ose vepra të vlefshme.

Ubade ibën Samiti, radijall-llahu anhu, thotë:

"I kemi dhënë besën Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, që ta dëgjojmë dhe respektojmë kur na pëlqen edhe kur nuk na pëlqen, që mos ta kundërshtojmë të përcaktuarit tanë dhe ta themi të vërtetën kudo që jemi, duke mos u frikësuar nga qortimet e qortuesve". (Buhariu).

### d) Përgjigja për gjërat që mësuesi e di se nxënësi nuk i di

Kjo është formë e përhapjes së dijes, i përgjigjet nxënësit që për gjërat që i vlojnë në gjoks edhe pse nuk i shqipton.

Një njeri pyeti Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: o Resulull-llah, jemi në deti, kurse ujë të pijshëm kemi pak, nëse marim abdest me te etsohemi, a të marim abdest me ujë deti? Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: Deti ka ujin e pastër dhe coftinat e tij janë hallall". (Buhariu).

Pjesa: "coftinat e tij janë hallall" domethënë dije shtesë, sepse ai që nuk e di se uji i detit është i pastër, ai edhe ma shumë nuk mund ta dije se coftina e detit është hallall.

Kur erdhi një haxhi ta pyet Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, se çka mund të vesh muhrimi, ai iu përgjigj:

"Muhrimi nuk duhet të vesh: këmishë, kësulë, sharvalle, rroba që janë të prekura nga shafrani (aromatike), ai që ska nallane le të vesh këpucë dhe le ti këput që të jenë nën zogun e këmbës". (Buhariu dhe Muslimi).

Një ditë u tha shokëve të vet:

"Mund t'ju vjen shejtani e të thotë: kush e ka krijuar këtë? Kush e ka krijuar këtë? Derisa në fund të thotë: kush e ka krijuar Zotin tënd? E kur të arrijë këtë gradë le të kërkon strehim te All-llahu nga shejtani dhe le të largohet nga ky mendim". (Buhariu dhe Muslimi).

### e) Të japish përgjigje të sigurta dhe mos të flasish pa dije

All-llahu, subhanehu ve teala, na e ndalon të flasim pa dije andaj edhe ka thënë:

"Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të pamurit dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi". (El-Isra: 36).

Xhabiri, radijall-llahu anhu, e pyeti Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: Si të veprojmë në pasurinë time, si ta ndaj pasurinë time? Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, nuk iu përgjigj derisa zbriti ajeti i trashigimisë. (Buhariu dhe Muslimi).

Katër: Si të sillemi me ata që gabojnë

Pasi që gabimi, mangësia dhe injoranca është që e zakonshme të nxënësit dhe studentët, në duhet të parashtrijmë pyetjen: si është sjellur Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, me rastet e këtilla. Në rastet në vijim mund ta lexojmë përgjigjen.

Aisheja, radijall-llahu anha, thotë:

"Asgjësi si ka rënë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, me dorën e tij, as gruan e as shërbëtorin, përpos kur ka qenë në xhihad". (Muslimi).

Pasi që Kab ibën Maliku nuk mori pjesë në

betejën e Tebukut, kur u kthye Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, nga beteja i erdhi Kabi e tha:

"Shkova te ai e i dhash salam, kurse ai u buzëqesh si i hidhëruari". (Buhariu).

Duke qenë muslimanët në xhami, erdhi një bediun dhe u urinos në xhami. Shokët e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i thanë: ndal, ndal, kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: Mos e qortoni, lereni. E ata e lanë derisa e kreu. Kur e kreu, e thërriti Pejgamberi, sal e i tha:

"Në këto xhami nuk lejohen këto ndytësira, qoftë urinë ose nevojë e madhe, por xhamia është për ta përmendur All-llahun, për të falur namazin dhe për të lexuar Kur'an". (Muslimi).

Në transmetimin e Tirmidhiut qëndron:

"Jeni dërguar për të lehtësuar e jo për të vështirësuar".

Një i ri i erdhi Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, për të kërkuar leje për zina (marrdhënie intime jashta kurore). Sahabet e qortuan dhe larguan. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e afroi afër dhe i tha: a ia don këtë nënës tënde? Tha: u flijofsha për ty, vall-llahi jo. Tha: as njerëzit nuk ia dëshirojnë këtë nënave të tyre. Tha: a ia dëshiron këtë vajzës tënde? .....në fund tha: All-llahu im falja mëkatet, pastroja zemrën dhe mbroja organin". (Sahih, Ahmed).

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e injori Kab ibën Malikun dhe ua ndaloi shokëve ti flasin për shkak të mospjesmarjes në betejën e Tebukut. (shiko tregimin e Kabit në saihun e Buhariut).

E treguam më lart rastin e atij që foli në namaz dhe rastin e Enesit kur e urdhëroi tia kryen një punë.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e konfirmoi rrahjen për edukim, siç tregohet me rastin kur shërbëtori i Ebu Bekrit, radi-

jall-llahu anhu, e kishte humbur Devenë. Ebu Bekri, radijall-llahu anhu, e rrihte, kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke u buzëqeshur thoshte:

"Shikoni se çka bën ky që është në ihrame". (transmeton Ebu Davudi, hasen).

Pesë: Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i ka përdorur qysh atëherë disa metoda që i përdorin pedagogët sot

#### a) Sjellja e shembujve

Ka shumë raste që e argumentojnë këtë, siç rasti i shembullimit të besimtarit me hurmën, shoqërisë me aninë, shokun e keq me farkatarin, etj.

#### b) Stimulimi me pyetje

Edhe në këtë formë ka shumë raste.

"A e dini se kush është i falimentuari...". (Muslimi).

"A e dini se çka është përgojimi...". (Muslimi).

"A e dini se cila ditë është kjo ditë...". (Buhariu).

#### c) Stimulimi intelektual duke përmendur ndonjë informatë, ose lajm ose parathënie, etj.

"I nënçmar qoftë, i nënçmar qoftë, i nënçmar qoftë. Thanë: kush o Resulull-llah? Tha: ai që ka takuar pleqërinë e dy prindërve ose njërit prej tyre e nuk ka hyrë në xhennet". (Muslimi).

Kaloi një xhenaze, e njerëzit e lavdëruan, atëherë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha:

"Ashtu u bëftë". E kur kaloi një xhenaze tjetër, të pranishmit e shanë. Pejgamberi, alejhisselam, tha: "Ashtu qoftë"... (Muslimi).

Një ditë tha: sillne minberin. E kur ia so-

llëm, ai kur hypi në shkallën e parë tha: Amin, e kur hypi në të dytën tha: Amin dhe kur hypi në të tretën tha: Amin. Kur zbriti sa-habet i thanë: të dëgjuam duke i thënë aminat, e nuk e kemi dëgjuar këtë më herët, pastaj ua sqaroi këtë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem,... (sahih, Hakimi).

#### d) Fjali të shkurta dhe të përsëritura

Aisheja radijall-llahu anh, thotë:

"Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kur flitke nëse dikush do të dëshironte ti numëron fjalët do ti numëronte". (Sahih, Ebu Davudi).

Kurse Enesi, radijall-llahu anhu, thotë:

"Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kur jepte selam jepte tre herë dhe kur flitke e përsëritke fjalën tre herë". (Buhariu), kurse në transmetimin tjetër qëndron edhe kjo pjesë: "derisa ta kuptojnë njerëzit".

Pra, këto janë disa pjesë nga sjellja e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, si mësues dhe edukator, që pa dyshim luajnë rol të madh në mbarë shoqërinë muslimane, te ata që janë prindër, mësues, pedagog, profesor, etj.

Neve nuk na mbetet asgjë më shumë përpos se të dërgojmë sa ma shumë salavate mbi këtë burrë i cili na i ka dhuruar të gjitha këto mirësi dhe dhurata, paqa dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi te...

E lusim All-llahun të na shtojë dijen e dobishme dhe veprat e mira, të na shtojë urtësinë, të na stolisë me moral të mirë dhe sjellje të bukur dhe të na bëjë të atillë që çdo herë ta kemi shembëlltyrë Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Amin

Përshtati: Bekir Halimi  
Munkidh Sekar,  
17.9.2004

## Dija obligim fetar dhe domosdoshmëri kohore

### Vlera e dijes

Vlerën e dijes do të mundohemi ta spikatim në disa forma dhe aspekte:

1- Dija është dhuntia më e madhe që na e ka dhënë All-llahu, subhanehu ve teala.

All-llahu e ka lavdëruar dijen, i ka nderuar bartësit e dijes, u ka dhënë shpërblime të mëdha, ua ka ngritur shkallët, sepse dija është udhëzimi, është mëshirë, është dritë, është mbrojtje, lartësi dhe ngritje.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"...All-llahu i lartëson ata që besuan prej jush, i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituri. All-llahu është i njohur mirë me atë që punoni". (El-Muxhadele: 11).

Kurse në suren Ez-Zumer thotë:

"...Thuaj: "A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?" Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim". (Ez-Zumer: 9).

2- Prej argumenteve të prera dhe të qarta për vlerën e dijes dhe mjeteve të marjes së dije, fillimi i Kur'anit me ajetet:

"Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruajë me pendë. Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte". (El-Alak: 1-5).

Ashtu sikurse All-llahu e largoj njerëzimin nga erësira e mosekzistimit në dritën e ekzistimit, ashtu i dha dhuntinë e dijes, me të cilën e nxjer njeriun nga erësira e injorancës në dritën e njohjes.

3- Pasi që dija ka vlerë dhe nderë, All-llahu, subhanehu ve teala, na ka mësuar që të kërkojmë shtimin e saj.

E ka urdhëruar me këtë Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke i thënë:

"...thuaj: "Zoti im, më shto dituri!" (Taha: 114).

Kjo pa dyshim e tregon vlerën e dijes dhe shtimit të saj.

Katadeja, rahimehull-llahu, thotë: "Poqëse do të mjaftohej dikush me dijen do të mjaftohej Musai, alejhisselam, mirëpo ai i tha Hidrit, alejhisselam:

"... "A pranon të vijë me ty, që të më mësosh nga ajo që je i mësuar (i dhuruar) ti: dituri të drejtë e të vërtetë?" (El-Kehf: 66).

Këto ishin disa ajete që na treguan vlerën që ka dija në shoqërinë muslimane, kurse sunneti i Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka edhe më shumë fakte që e tregojnë dhe e spikatin vlerën e dijes.

### Hadithet që flasin për vlerën e dijes

- Transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Muavija, radijall-llahu anhu, i cili thotë: kam dëgjuar Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke thënë:

"Kujt ia do All-llahu të mirën ia mëson fenë".

- Transmeton Muslimi nga Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Kush ecë rrugës për të kërkuar dije, All-llahu ia lehtëson rrugën e xhennetit. Nëse mblidhen disa njerëz në një shtëpi të Zotit që të lexojnë Librin e Zotit dhe që ta studiojnë mes tyre, mbi ta bjer qetësia, i mbulon mëshira, i rrethojnë melaqet dhe i përmend All-llahu te krijesat që gjinden te Ai...".

- Transmeton Tirmidhiu nga Enesi, radijall-llahu anhu, se Pejgamberi, sal-lall-llahu

alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Ai që del për të kërkuar dije është në rru-  
gë të Zotit derisa të kthehet".

- Tregon Ibën Abdul-Berri në librin e tij  
"Xhamiu bejanul-Ilmi ve fadlihi" fjalën e Mua-  
dhit, radijall-llahu anhu:

"Mësone dijen, sepse mësimi i dijes për  
hirë të All-llahut është frikë, kërkimi i dijes  
është adhurim, përsëritja është tespih (sub-  
hanall-llah), hulumtimi i tij është xhihad, tia  
mësosh atij që nuk e di është sadaka, tia ja-  
pish atyreve që e meritojnë është afërsi,  
është shoqërues në vetmi, mik kur je në  
gurbet, të flet kur ske me kënd të flasish,  
udhërrëfyes në bollëk dhe vështirësi, armë  
kundër armikut, stolisje pranë miqve, ndriçue-  
es i rrugës së xhennetit, me te All-llahu i  
ngrit disa njerëz e i bën udhëheqës në të  
mirë dhe prijës që ecët pas hapave të tyre  
dhe pasohen veprat e tyre, miret në konsi-  
derat mendimi i tyre, melaqet dëshirojnë tu  
bëjnë hije, kurse me krahët e tyre ti prekin,  
për ta kërkon falje çdo gjë e thatë ose e njo-  
më, peshqit në detë dhe insektet, kafshët e  
buta dhe të egra, sepse dija është ngjallje e  
zemrës nga injoranca, llambë e syve nga erë-  
sira, njeriu me dije arrin gradën e të zgje-  
dhurve dhe shkallët e larta në dynja dhe ahiret,  
logjikimi mbi te vlen sa agjërimi, vazhdimi në te  
vlen sa namazi natës, me të forcohen lidhjet  
farefisnore, njihet hallalli dhe harami, është pri-  
jësi i veprës, kurse vepra pasues, u inspirohet  
të lumturve dhe u privohet fatzive".

#### **Dija është baza e ringjalljes sonë**

Nga mësimit islame, nga civilizimi islam,  
stimulimi për dije dhe respekt të dijetarëve  
në mesin e muslimanëve janë përhapur dijet  
dhe shkencat. Këtë e kanë stimuluar edhe  
prijësit musliman, saqë halifeja Mutevekil i ka  
dhënë ari Hunejn ibën Is'hakut sa i ka pe-  
shuar libri i përkthyer.

- Muslimanër i përkthyen librat e civilizi-  
meve më të hershme.

- Ata nuk u mjaftuan vetëm me përkthim,  
por edhe hulumtuan, vazhduan studimin,  
përmirësuan dhe i zhvilluan, saqë sollën ino-  
vacione dhe ua kaluan tjerëve.

- Dukë ia ditur vlerën muslimanët dijes u bë-  
në të njohur: Ebu Bekr Raziu, si njeri i cili i pari  
bëri operacion në sy, Ibën Sina e shkroi librin e  
parë në mjekësi, "Kanunin", i cili studiohet në  
Kembrixh dhe Oksford, Xhebr ibën Hajjani, i cili  
e zbuloi Algjebren, muslimanët ishin të parët  
që ndërtuan teleskopër astronomik, etj.

- Dija me të cilën ngjallet populli ynë është dija  
e dobishme, qoftë prej dijeve fetare ose shken-  
cave ekzakte, domethënë të gjitha shkencat për  
të cilat kanë nevojë njerëzit në jetën e tyre.

#### **Pozita e dijes në fe**

Dijetarët e kanë ndarë kërkimin e dijes në  
dy kategori: Farzi ajn dhe farzi kifaje.

Farzi ajn është dija për të cilën ka nevojë  
secili individ, domethënë njohja e gjërave të  
domosodoshme dhe primare në jetën e tij, si-  
kurse është besimi në Zot, njohja e të dërgu-  
arve, njohja e fesë dhe rregullave të saja, etj.

Edhe në këtë drejtim ka neglizhencë të  
madhe. Njerëzve sot aspak ose shumë pak  
ju intereson për fenë dhe Krijuesin e tyre.  
Andaj ky mosinteresim edhe e ka sjellur po-  
pullin tonë deri në këto nivele të dekadencës  
morale dhe ajo që edhe ma shumë e keqë-  
son këtë gjendje është fakti se njerëzit ako-  
ma nuk janë vetëdijësuar dhe nuk janë zgju-  
ar nga shkujdesi e të kthjellen dhe të shohin  
rrugën e shpëtimit.

Kurse farzi kifaje janë dijet për të cilat ka  
nevojë shoqëria në mënyrë kolektive dhe  
derisa nuk krijohet kuadër i mjaftueshëm në  
secilën degë, e tërë shoqëria është përgje-  
gjëse dhe është mëkatore.

Andaj mësimi i shkencave të ndryshme



është prej obligimit të përgaditjes, siç na tregon All-llahu, subhanehu ve tealà:

"E ju përgatituni sa të keni mundësi force, (mjete luftarake), e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre (që tradhtojnë) e me të, (me përgatitje), ta frikësoni armikun e All-llahut, armikun tuaj dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini (se kush janë), e All-llahu i di ata. Kado që shpenzoni për rrugë të All-llahut, ajo do t'ju konpensohet dhe nuk do t'ju bëhet padrejtë". (El-Enfal: 60).

Secilën fuqi që kanë mundësi muslimanët ta përgadisnin e nuk e përgadisnin, ata atëherë do të jenë mëkatar, pa dyshim se shkenca bashkëkohore me të gjitha aspektet e saj janë obligim për ummetin, sepse mjeti pa të cilën nuk kryhet një obligim është obligim.

### Mes dijes dhe besimit

Kur të ndalemi të mendojmë rreth qëndrimit të Islamit mbi dijen do ta shohim lidhjen e fuqishme mes dijes dhe besimit, andaj në Islam sado që njeriu është më i ditur është më i devotshëm, kurse sa ma injorant është është ma larg Zotit, për dallim prej krishterimit, ku ka qenë me shekuj sa ma larg dijes, aq më afër Zotit, andaj edhe në bazë të kësaj teorie janë themeluar inkvizicionet dhe djegia e dijetarëve.

All-llahu, tebareke ve tealà, duke treguar faktin se dijetarët janë njerëzit që më së shumti ia kanë frikën All-llahut, thot:

"A nuk e sheh se All-llahu lëshon nga qielli ujë, e Ne nxjerrim me të fruta, ngjyra e të cilëve është e ndryshme, e edhe nëpër kodra ka vija të bardha e të kuqe ngjyrash të ndryshme, e ka edhe shumë të zeza. Edhe nga njerëzit, nga gjallesat, nga kafshët po ashtu ka të ngjyrave të ndryshme. Po All-llahu ia kanë frikën nga robërit e Tij vetëm dijetarët, All-llahu është mbi gjithçka, është mëkatfalës". (Fatir: 27- 28).

Pra, dija udhëzon në besim dhe e forcon atë, kurse besimi thërret në dije dhe stimulon në të. Këtë lidhje kaq të fuqishme mes dijes dhe besimit nuk e gjejmë askund tjetër.

Nëse një popull dëshiron të prosperon dhe të zhvillohet e ka të domosdoshme pajisjen me besim dhe dije, sepse vetëm dija "mund ta ngrit një popull deri në qiell, ti jep komoditet dhe bollëk, mirëpo së shpejti do të shkatërrohet sikurse bijnë gjetet në vjeshtë kur fryn era". "Sa popuj jetojnë të pasur dhe të fuqishëm, mirëpo në vuajtje e cila ua rezikon ardhmërinë, të ciptuar mes vete, ku dominon stresi dhe nihilizmi. Fuqi pa siguri dhe kënaqësi. E tashme e lulëzuar pret të ardhmen e vështirë, është sprovë të cilën e pason vuajtja".

Muslimanët ua kanë kaluar tjerëve shekuj me rradhë kur dija mori vend të lartë në zemrat e tyre, kur ata e kërkuan dijen me sinqeritet dhe i nderuan dijetarët.

### Mes dijes dhe pasurisë

Fatkeqësisht sot vërejmë se njerëzit shumë ma shumë i japin rëndësi pasurisë, pushtetit, publicitetit se dijes, kurse pa dije humbën të gjitha këto, kurse me dije i fiton këto dhe shumë gjëra tjera që ndoshta edhe nuk të bien ndërmend.

Andaj nuk janë të rralla rastet kur disa familje tana në vend se ti nisin fëmijët në shkollë ata i nisin të shkojnë e të miren me punë të ndryshme për të fituar ndonjë dinar.

Është e vërtetë se gjendja e jonë ekonomike është shumë e vështirë edhe shumë herë bëhet shkak për këtë vendim, mirepo ky vendim asnjëherë nuk është i arsyeshëm.

Më mirë është të vuajmë pak për kafshatën e gojës se sa ta ndalim fëmion nga shkolla.

Ibën Kajimi, rahimehull-llah, ka sjellur disa dallime mes dijes dhe pasurisë, për të treguar se vlera e dijes është shumë ma e madhe se e

pasurisë, andaj nuk duhet përmbytur prioritetet.

1- Dija është trashëgëmi e peygamberëve, kurse pasuria është trashëgëmi e mbretërve.

2- Dija e ruan njeriun, kurse pasurinë duhet ta ruaj njeriu.

3- Dija shtohet me ndarje, kurse pasuria harxhohet me dhënie.

4- Dija e përcjell njeriun edhe ne var, kurse pasuria ndahet prej tij pas vdekjes.

5- Dija e sundon pasurinë, kurse pasuria nuk e sundon dijen.

6- Pasuria i jepet secilit kurse dija vetëm atij që e kërkon.

7- Për dijetarin kanë nevojë mbretërit edhe tjerët, kurse për pasurinë vetëm të varfërit.

8- I pasuri mund të bëhet i varfër për një moment, kurse i dituri asnjëherë nuk mund të bëhet injorant.

9- Pasuria njeriun e ban rob të dynjasë, kurse dija e thërret njeriun në adhurim të Zotit.

10- Pasuria mund të bëhet shkak i shkatërrimit të njeriut, kurse dija i jep jetë njeriut.

11- Lumturia e dijes është e përhershme, kurse e pasurisë e përkohshme.

12- Dijetari vlerën e ka subjektive, kurse pasaniku vlerën e ka në pasurinë.

13- I pasuri i thëret njerëzit me pasurinë e tij në dynja, kurse dijetari i thërret në ahiret.

Shiko se cilën rrugë do të zgjedhish!

#### **Përgjegjësia e familjes në këtë drejtim**

Familja obligohet që ti stimulojë fëmijët që të mirren me dije, ti motivojë për epërsi dhe sukses të lart.

All-llahu, subhanehu ve teala, e obligon muslimanin që të ruan veten dhe familjen nga zjari duke thënë:

"O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilit

janë njerëzit dhe gurët. Atë (zjarrin) e mbi-këqyrin engjëjt e rreptë e të ashpër që nuk e kundërshtojnë All-llahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruar". (Et-Tahrim: 6).

Komentatorët e Kur'anit kanë thënë: "Mësoni dhe edukoni fëmijët tuaj".

Prindërit obligohen që:

- Të drejtojnë fëmijun drejt dijes që në fëmijëri, sepse kërkimi i dijs në fëmijëri është sikur shkrimi në gurë.

- Fëmijës duhet mësuar disa rregulla pedagogjike gjatë kërkimit të dijes, siç është sinqeriteti, devotshmëria, durimi, respektimi i mësuesit, organizimi i kohës, mesataria në ushqim dhe gjum, etj.

- Duhet stimuluar në lexim, shfletim, analizë, meditim dhe duhet kujdesur për prirjet që i ka fëmiju.

- Duhet siguruar në shtëpi një bibliotekë të vogël me libra të dobishme për të gjithë anëtarët e shtëpisë.

- Fëmijëve duhet lexuar jetën e dijetarëve, sepse jeta e tyre është përplot me shembuj dhe rastesh interesante dhe të dobishme.

- Duhet stimuluar fëmijët që të lexojnë revista me lëndë të dobishme, të përcjellin programet interesante shkencore, duhet ta njohin përdrimin e kompjuterit, pjesmarrja në kuize të diturisë, në gara të ndryshme shkencore, përcjellja e mësimit të tyre në shkollë, etj.

- Duhet sqaruar dallimin mes këtyre brezave të muslimanëve dhe brezave të kaluar dhe pasionin e tyre për lexim, shfletim, shkencë, libra, shkollim dhe ndikimi i tyre në rrjedhat e civilizimit botëror.

E lusim All-llahun të na bëjë të pasionuar pas besimit dhe dijes, leximit dhe shkollimit, përparimit dhe edukimit.

Përgaditi: Bekir Halimi  
24.9.2004

## Virtytet e nxënësit

Pasi që kemi sqaruar rëndësinë e dijes, cilsitë e mësuesve, duhet të flasim edhe për virtytet që duhet ti posedojnë nxënësit, studentët musliman.

Në mungesë të këtyre virtyteve i mungon edhe suksesi i plotë, sepse do ti mungon edukata ose fisnikëria e qëllimit, sepse posedimi i këtyre virtyteve është i domosdoshëm për sukses dhe shpëtim.

Prej virtyteve që duhet ti posedojë:

### 1- Sinqeriteti.

Kërkimi i dijes është respekt dhe adhurim, kurse sinqeriteti kërkohet në çdo adhurim. All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin All-llahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zeqatin, se ajo është feja e drejtë". (El-Bejine: 5).

Domethënë që kërkimin e dijes duhet ta bëjmë për hirë të All-llahut e jo për të fituar dëftesa, për të fituar pozita të larta ose për të fituar të mira materiale, edhe pse ato vijnë vetvetiu, mirëpo qëllimi yt duhet të jetë për të arritur kënaqësinë e All-llahut, tebareke ve teala.

Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Ai që mëson ndonjë dije me të cilët duhet shpresuar Fytyrën e All-llahut, ai këtë e mëson për të fituar diç nga dynjaja, nuk do të nuhas aromën e xhennetit në Ditën e Kijametit". (sahih, Ahmedi).

### 2- Devotshmëria.

Dijetarët janë njerëzit që më së shumti e njohin All-llahun dhe ata më shumë kanë fri-

kë prej Tij. Dijetari me devotshmëri e shton dijen kurse me dije e shton devotshmërinë.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"...Kini frikë All-llahun se All-llahu ju dhuron dituri (të jashtëzakonshme), All-llahu është i gjithëdijshëm për çdo send". (El-Bekare: 282).

"...Po All-llahut ia kanë frikën nga robërit e Tij vetëm dijetarët, All-llahu është mbi gjithçka, është mëkatfalës". (Fatir: 28).

Devotshmëria është përmbledhëseja e çdo të mire, porosia e të parëve dhe të fundit. All-llahu, subhanehu ve teala, në suren Nisa thotë:

"Vetëm e All-llahut është ç'ka në qiej e ç'ka në tokë. Ne ju patëm sugjeruar atyre që iu pat dhënë libri para jush, e edhe juve që të keni frikë nga All-llahu. Po në mos besofshit, (dine) e All-llahut është ç'ka në qiej dhe ç'ka ka në tokë. All-llahu është i panevojë e i falënderuar". (En-Nisa: 131).

"O ju që besuat, nëse keni frikë All-llahun, Ai do të vërë udhëzim (në zemrat tuaja) për ju, do t'ua mbulojë të këqijat, do t'ua falë mëkatet. All-llahu është dhurues i madh". (El-Enfal: 29).

### 3- Prania e zemrës.

Nxënësi dhe studenti domosod e kanë që gjatë kërkimit të dijes ta kenë zemrën dhe mendjen të pranishme, sepse në mungesë të tyre asgjë nuk mund të mësohet. Për këtë mësuesi duhet të përdore të gjitha mjetet e mundshme që i ndihmojnë për tua tërëhjekur vëmendjen drejt dijes nxënësve, siç është parashtrimi i pyetjeve, debatimi me nxënësit, përkujtimi i të shkujdesurit, lavdërimi të shkathtit, dhënia e dhuratave për stimulim, etj.

**4- Ambicja e lartë.**

Studenti duhet të ketë ambicje të larta dhe duhet të jep tërë mundin e vet për të fituar dije e nuk duhet t'i mbështet dembelisë, përtësës dhe prolongimit.

Ai duhet të ketë shembull dijetarët e mëdhenjë në historinë islame, të cilët kanë dhënë shembuj të paharuar në këtë drejtim.

Për shembull, Ibën Ebi Hatim Er-Raziu thotë:

"Kam qëndruar në Egjipt shtatë vite, nuk kam ngërënë ushqim të lëngët, tërë ditën e kaloj në ligjeratat e dijetarëve, kurse gjatë natës i shkruaj ligjeratat dhe i krahasoj. Një ditë shkua te një dijetar, kurse ai ishte i sëmurë, andaj kalua afër tregut, ku e pash një peshk, i cili më pëlqeu. E bleva peshkun dhe shkua në shtëpi. Erdhi ora e ligjeratës së dijetarit tjetër, e lam peshkun në shtëpi dhe shkua në ligjeratë, tre ditë nuk i erdhi rendi ta përgadisim peshkun, për pak do të kalbej.

Prej shembujve të njerëzve me ambicje të larta është edhe ky rast.

Ebu Jusuf, ishte shumë i dhënë pas mësuesit të tij, Ebu Hanifes, rahimehull-llahu, ai qëndroi afër tij shtatëmbëdhjetë vite, çdo namaz të sabahut e ka falur me te, përpos kur ka qenë i sëmurë. Ky njeri e tregon një rast shumë interesant nga koha e tij. Një ditë më vdiq djali, kurse unë nuk shkova t'ia laj xhenazen dhe ta përgadis kufomën, këtë punë ua lash farefisit dhe fqinjëve, nga frika që mos të më kalon asgjë nga mësuesi im Ebu Hanifeja, e pastaj ta qajë atë dije".

Rasti tjetër është rasti i Ebu Xhafer, Muhamed ibën Xherir Et-Taberiu, i cili që në fëmijëri filloi kërkimin e dijes. Kur i kishte shtatë vite kishte mësuar përmendsh tërë Kur'anin, kurse u ka dalur imam njerëzve kur i ka pasur tetë vite, e ka filluar të shkruan hadithe kur i ka mbushu rëntë vite.

Ky dijetar e tregon një rast që shpalos ambicjet e tyre të mëdhaja.

Më erdhi një njeri dhe më pyeti për disa gështje që kanë të bëjnë me metrikën, kurse unë më herët nuk e kisha mësuar. I thash: eja nesër. E kërkova një libër që flet për metrikën dhe për një natë e lexoi dhe mësoi tërë atë libër të madh dhe bazor në këtë shekncë.

**5- Kujdesi për kohën**

Koha është dhunti hyjnore që kërkon prej neve falënderim. All-llahu, subhanehu ve teala, ka krijuar natën dhe ditën që të zhvillohet jeta njerëzore.

"All-llahu është Ai që i krijoi qiejt dhe tokën, dhe Ai lëshoi prej së larti ujë (shi), e me të nxjerr fruta si ushqim për ju, dhe për të mirën tuaj u vuri në shërbim anijet, të lundrojnë nëpër det me urdhrin e Tij, e në shërbimin tuaj i vuri edhe lumenjtë. Për ju i nënshtroi diellin dhe hënën që në mënyrë të zakonshme vazhdimisht udhëtojnë. Për ju përshtati edhe natën e ditën. Dhe Ai ju dha gjithatë që e kërkuat (që kërkoi nevoja juaj) dhe, edhe në qoftë se përpiqeni t'i numëroni të mirat e All-llahut, nuk do të mund të arrini t'i përkufizoni (në numër). Vërtet, njeriu është i padrejtë dhe shumë përbuzës". (Ibrahim: 32- 34).

Me këto ajete fisnike All-llahu, tebareke ve teala, ua tregon besimtarëve disa dhunti që nuk mund të numrohen, e mes tyre është edhe dhuntia e ditës dhe natës, rreth të cilëve rrotullohet koha, kurse shumica e njerëzve e neglizhojnë këtë dhunti.

"Dhe për ju nënshtroi natën e ditën dhe diellin e hënën. Edhe yjet janë të nënshtuar me urdhrin e Tij. Vërtet, në këto ka argumente për një popull që mendon". (En-Nahl: 12).

Për shkak se shumica e njerëzve nuk ia din vlerën kohë edhe e përbuzin atë, sikur na ka treguar, Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke thënë:

"Dy dhunti shumica e njerëzve i përbuzin: shëndeti dhe koha e lirë". (mutefekun alejhi).

Andaj muslimani i mençur duke iu falëndëruar All-llahut për këtë dhunti e angazhon me gjëra të dobishme dhe të mira.

Koha është amanet dhe përgjegjësi dhe për të do të jap llogari, sikurse jep për amanetet tjera. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Nuk do të lëvizin këmbët e njeriut për derisa nuk pyetet për katë gjëra: për jetën ku e ka harxhuar, rininë ku e ka kaluar, pasurinë ku e ka fituar dhe ku e ka harxhuar, dije, çka ka bërë me të"? (sahih, Tirmidhiu).

Kujdesi i selefit për kohën

Selefus-Salihi kujdeseshin shumë për kohën, ata e shfrytëzonin çdo minut dhe sekund që mos t'ju shkojë kot.

Abdullah ibën Mesudi, radijall-llahu anhu, thotë:

"Për asgjë nuk jam enduar sa jam penduar për ditën që ka perenduar dielli: më është shkruar jeta e nuk i kam shtuar vepret e mira".

Hasan Basriu, rahimehull-llah, ka thënë:

"Njeri! Ti përbëhesh prej ditëve, nëse shkon një ditë të ka shkuar një pjesë. Ashtu sikur të ka shkuar një pjesë të shkon edhe tërë trupi".

Gjithashtu ka thënë:

"Kam takuar disa njerëz që ishin më koprac për kohën se sa që ju jeni për dinarët dhe dirhemët".

Ubejd ibën Jeishi thotë:

"Tredhjet vjet nuk kam ngrënë me dorën time gjatë natës. Motra ime më jepte kafshatat kurse uën shkruaja hadithe".

Duke e shfrytëzuar Selefus-Salihi kohën u ngritën në pozita të larta dhe përmenden përgjithmonë, kurse në kohën tonë prej shkaqeve të prapambeturisë së muslimanëve është harxhimi i kohës në gjëra kote, në kafene, në diskoteka, në rrugë, para televizorit, revistave të padobishme etj.

## 6- Durimi dhe qëndresa.

Rruga e dijes nuk është e shtruar me tran-dafila dhe lula, por ka nevojë për durim, bindje dhe vullnet të çelikt, është rrugë e gjatë dhe shumë herë shkakton mërzi dhe përtesë.

Prej medjaneve më të mëdha ku kërkohet durimi është: në kërkim të diturisë. Përndryshe edhe nuk mund të marrish dije. Durimi ia ndriçon studentit rrugën, është nozull pa të cilin nuk mundesh, është sjellje me të cilën domosdo duhet të stolises. Duhet të durosh gjatë udhëtimit për të dijetarët dhe gjatë përsëritjes së mësimeve. Tregimi i Musait dhe Hidrit, alejhimassalam, është shkollë se pa durim humbë shumë çeshtje të dijes.

Nxënësi dhe studneti asnjëherë nuk duhet të dorëzohen sepse dija është deti pa fund, andaj disa dijetarë të selefit kanë thënë:

"Kërko dije nga djepi deri në varr".

Ata kanë kërkuar dije edhe në pleqëri, andaj kur e kanë parë dikend prej tyre të mosshuar dhe kërkon dije, i kanë thënë: deri kur kështu? Kanë thënë:

"Me libra deri në varr".

Tregon Ebul-Hasen Ali ibën Isa El-Velvalxhiu: hyra te Ebu Rejhan, i cili ishte duke dergjur, pasi që i kishte mbushur shtatëdhjet e tetë vite. Në këtë gjendje më tha: si me the një ditë se llogaria e gjysheve nga nëna (në trashëgëmi) nuk është valid?

I thashë nga dhimbsuria: edhe në këtë gjendje?

Më tha: më mirë të ndahem nga kjo dynja duke e ditur këtë çeshtje se të dal nga kjo dynja duke mos e ditur këtë çeshtje. Ia tregova këtë çeshtje derisa e mësoi. Kur dola nga ai, duke qenë rrugës vetëm se u dëgjua britma për vdekjen e tij".

## 7- Përsëritja e mësimeve

Përsëritja e mësimeve është e domosdoshme në rrugën e dijes, andaj selefi edhe i këshillonin njerëzit që ta përsërisin dijen, saqë njëri nga selefi ka thënë:

"Tërë natën ta kaloj në përsëritje të dijes është më e dashur te unë se sa ta kaloj në adhurime".

### 8- Regjistrimi i dobive

Njeriu kur lexon ndonjë libër ose i përsërit mësime të duhura, duhet të regjistrojë në ndonjë fletore tjetër ose në letra të caktuara që të përsërit disa herë madje edhe ti mëson përmendsh.

Dijetarët kanë thënë:

"Ajo që mësohet përmendsh ik, kurse ajo që shkruhet mbetet".

Kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Lidhne dijen duke e shkruajtur". (Sahih, Tabreaniu dhe të tjerët).

9- Mos ta pengon turpi nga pyetja

Disa dijetarë nga Selefi kanë thënë:

"Nuk mer dije atij që i vjen turp dhe ai që është mendjemadh".

Njërin e pengon turpi që të pyes, kurse tjetrin e pengon mendjemadhësia që të pyet e të përfiton.

Transmeton Imam Muslimi nga Zejneb bintu Ebi Seleme, nga Umu Selemeja, radijall-llahu anha, e cila ka thënë:

Erdhi Umu Sueljma te Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e i tha: o i Dërguar i All-llahut, All-llahu nuk i vjen trup nga e vërteta, a duhet larë gruaja nëse ejakulon në ëndër? Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: po, nëse sheh ujë (gjurmët e lëngut që ka dalur gjat ejakulimit). Atëherë Umu Selemja tha: o i Dërguar i All-llahut a ejakulon në ëndër gruaja? Tha: të lumshin duart, e si ndodh ti ngajë fëmiu nënës".

Abdullah ibën Abasi, radijall-llahu anhu, edhe pse ishte i kujdesëm të shoqëron Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, për te ishte lutur Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ai akoma kujdesej që të mer dije edhe pas vdekjes së Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, prej fukahave të sahabeve.

Ikrimë, radijall-llahu anhu, tregon nga Ibën Abasi, radijall-llahu anhu, i cili ka thënë:

"Kur vdiq Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i thash një ensariut eja të shkojmë e ti pyesim shokët e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, sepse ata sot janë shumë. Kurse ai më tha: po habitem me ty, a mendon se njerëzit do të kenë nevojë për ty. Ai nuk mu bashkangjiti, kurse unë vazhdova ti pyes ata që kisha lajme se kanë hadithe të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. U shkoja dhe i pritja te dera e shtëpisë. Ai pushonte në shtëpi, kurse unë u mbështetja te dera e shtëpisë së tij, e era më frynte në fytyrë dhe më sjellte rërë. E kur dilte dhe më shihte më thonte: o djali i axhës së Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, çka të ka sjellur këtu, pse nuk më thirrje do të vija te ti? U thoja: jo, unë më shumë e meritoj të vijë te tij që të pyes për ndonjë hadith. Jetoj ai ensariu saqë më pa duke u tubuar njerëzit përreth meje që të më pyesin e tha: ky djalosh ishte më i mençur se unë".

### 10- Të veprsh me dijen

Nëse dija nuk shndërrohet në praxsa, atëherë çfarë dobi kemi prej saj. Studenti i mirëfilltë ashtu sikurse duhet të jetë serioz gjat kërkimit të dijes duhet të jetë edhe serioz gjatë zbatimit të dijes në praksë.

All-llahu, subhanehu ve teala, i ka lavdëruar ata që e zbatojnë atë që dinë duke thënë:

"Ndërkaq, ata që u larguan prej adhurimit të idhujve dhe iu drejtuan All-llahut, ata kanë gëzim të madh, e ti përgëzoji pra robërit e Mi! Të cilët i dëgjojnë fjalët dhe pasojnë atë më të mirën prej tyre. Të tillët janë ata që All-llahu i udhëzoi në rrugën e drejtë dhe të tillët janë ata të mençurit". (Ez-Zumer: 17- 18).

All-llahu, subhanehu ve teala, ka qortuar ata që nuk kanë vepruar me atë që kanë ditur dhe i ka përgjajësuar me gomarin, i cili bart libra që nuk ua dinë vlerën:

"Shembulli i atyre që janë obliguar me Tevrat, dhe nuk e zbatojnë atë, është si shembulli i ndonjë gomari që bart libra. Shembulli i keq është shembulli i popullit që i përgënjeshtroi ajetet e All-llahut, e All-llahu nuk udhëzon në rrugë të drejtë popullin jobesimtar". (El-Xhumua: 5).

### 11- Të thërrasish ne fenë e All-llahut dhe ta përhapish dijen

Dija duhet ti shërben fesë dhe përhapjes së fesë.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qar-

ta, e që unë thërras te All-llahu, unë dhe ai që vjen pas meje. Larg të metave është All-llahu, e unë nuk jam nga idhujtarët." (Jusuf: 108).

Ndoshta mund të përmenden edhe disa cilësi tjera, mirëpo këto mund të jenë më kryesoret. Mendoj se nëse i kemi parasysh këto virtyte dhe i realizojmë në jetën tonë studentore do të arrijmë grada shumë të larta në sferat e ndryshme të dijes.

Në fund e lusim All-llahun, az-ze ve xhel-le, që të mësoj gjërat që na bëjnë dobi, që të na bëjë dobi me atë që e mesojmë dhe të na bëjë nga ata që dijen e tyre në praksë e shndërrojnë.

Përgaditi: Bekir Halimi

1.10.2004

## Bë mirë!

Musliman të nderuar në këtë hutbe do t'ju flasim për një hadith, i cili paraqet shkollën pejgamberike të moralit, hadith i cili në mënyrë shumë interesante i paraqet veprat dhe njerëzit më të dashur te All-llahu. Ky hadith flet për rregullimin e raporteve shoqërore dhe krijimin e një shoqërie të mirë dhe bamirëse.

Teksti i hadithit

Transmeton Abdullah ibën Omeri, radijall-llahu anhumu, se një njeri erdhi te Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe tha: o i Dërguar i All-llahut, cili njeri është më i dashur te All-llahu dhe cilat janë veprat më të dashura te All-llahu?

Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i tha: "Njerëzit më të dashur te All-llahu janë më të dobishmit për njerëzit, kurse veprat më të dashura te All-llahu janë:

- gëzimi i një muslimani;
- t'ia largoj një brengë;
- tia lajë borxhin;

- tia largoj urinë;

- të eci me një vëlla timin për ndonjë nevojë të tij është më e dashur për mua se sa të qëndroj në muaj itikaf në këtë xhami (xhaminë e Pejgamberit);

- ai që e përman hidhërimin e tij, All-llahu ia mbulon të metat;

- ai që ngulfat mllëfin e tij edhe pse ka mundësi që të hakmiret, All-llahu ia mbush zemrën me shpresë Ditën e Kijametit;

- ai që ecë me vëllanë e tij derisa tia kryejë nevojë, All-llahu ia forcon këmbët atë ditë që shumë këmbë do të rrëshqasin.

Kurse sjellja e keqe e prish fenë ashtu sikurse e prish mjaltën uthulla". (transmeton Taberaniu, Ibën Ebi Dynja, e të tjerë, hadithi është hasen. Shiko "Es-Sahih", nr. 903)

Një hadith shumë madhështor, i cili shkakton dashurinë ndaj All-llahut dhe dashurinë ndaj njerëzve, përhap frymën vëllezërore mes muslimanëve dhe i forcon marrëdhëniet

mes besimtarëve.

Hadith i madh i cili i përmban vlerat e moralit, edukatën e muslimanit, sjelljen e mirë dhe virtytet e larta.

Udhëzime që pastrojnë shpirtin, përmirësojnë shoqërinë dhe sjellin lumturi te individët dhe shoqëritë.

Këto udhëzime nuk i ke askund, në asnjë shoqëri dhe në asnjë civilizim, udhëzime të pashembullta, sepse vijnë nga: "Ai (Kur'ani) nuk është tjetër pos shpallje që i shpallet". (En-Nexhm: 4).

Vëllezër musliman!

Do të ndalemi në sqarimin e këtij hadithi në disa pika.

Pika e parë: ky hadith potencon që të jemi të dobishëm për njerëzit në të gjitha format e mundshme, sepse kjo është shkak për të fituar shpërblime të mëdha.

Andaj Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Njerëzit më të dashur te All-llahu janë më të dobishmit për njerëzit".

Ky hadith i mëson muslimanët që të jenë dashamirë të së dobishmes, ta duan humanizmin, të jenë filantrop, tua duan njerëzve atë që ia duan vetes. Pa dyshim se ky hadith në këtë formë luan rol shumë të madh në ndryshimin e gjendjeve të këqija të shoqërive tona, ku dominon egoizmi, zilia, grykësia, moskujdesi për tjetrin, e kështu me radhë.

Shoqëria muslimane duhet ndërtuar në këtë formë ndryshe edhe nuk ban edhe nuk mundet.

Mund të jemi të dobishëm për tjerët nëse ua kryejmë nevojat që kanë, pa marë parasysh se a ka nevojë për pasuri, punë, detyrë, ose fjalë të mirë. Këtë mund ta bëjmë duke e mbrotur nga zullumi, duke participu në ndjenjat e tij gjat gëzimeve dhe mërziave.

Ky rregull i madh në fe, rregulli i solidarizimit mes besimtarëve dhe kujdesi për tua kryer nevojat muslimanëve. Nga kjo pikënisje ka

ardhur në këtë hadith detajizimi i këtij rregulli:

"... të eci me një vëlla timin për ndonjë nevojë të tijë është më e dashur për mua se sa të qëndroj në muaj itikaf në këtë xhami (xhaminë e Pejgamberit)..".

"... ai që ecë me vëllanë e tij derisa tia kryejë nevojë, All-llahu ia forcon këmbët atë ditë që shumë këmbë do të rrëshqasin...".

Këtë gjë e ka sqaruar edhe më shumë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në një hadith të cilin e transmeton Tirmidhiu ku mes tjerash thuhet:

"Udhëzimi i njeriut në vend të humbur është për ty sadaka, të shikosh për njeriun me pamje të dobët është për ty sadaka, largimi i therës dhe ashtit nga rruga është sadaka, të shprazish nga kova yte në kovën e vëllaut tënd është sadaka". (sahih, shiko "Vargun e haditheve të vërteta", nr. 572).

Për këtë bamirësit dhe humanët janë kujdesur që tua kryejnë nevojat besimtarëve dhe të jenë të dobishëm për ta.

Hakim ibën Hizami radijall-llahu anhu, thotë:

"Çdo ditë që kam gdhirë dhe kam parë në prag të shtëpisë sime ndonjë nevojtar, i cili ka qenë në ngushticë e i kam ndihmuar, këtë e kam konsideruar prej dhuntive për të cilat e falenderoj All-llahun, kurse atë ditë që nuk shihja te dera e shtëpisë ndonjë nevojtarë atë ditë e konsideroja prej fatkeqësive, për të cilat kërkoja te All-llahu shpërblim". (Ibën Ebi Dynja në librin me titull "Mekarimul-Ahlak").

Pika e dytë: I ka potencuar ky hadith disa cilësi të veçanta dhe disa vepra që kanë shpërblim të madh te All-llahu, subhanehu ve teala, kurse prej tyre janë: largimi i brençës, larja e borxhit dhe largimi i urisë.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i ka urdhëruar këto vepra në hadithet e tija, sepse vetëm në këtë formë mund të demonstron uniteti në një shoqëri dhe lidhshmëria e fortë mes tyre.



Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Ushqeni të uriturin, vizitoni të sëmurin dhe çlironi të robëruarin". (Buhariu).

Shikoni se si krijohen raporte të mira shoqërore. Si mendoni, nëse realizohen këto udhëzime pejgamberike ne jetën tonë, do të kishte ndonjë situatë të palakmueshme në jetën shoqërore?!

Gjithashtu Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

"A ka kush i ofron i ofron kësaj familjeje një deve për të bartur enën e madhe, se kjo vepër ka shpërblim të madh". (Buhariu dhe Muslimi).

Ti që ke veture, ose ti që ke ndonjë mjet bartës shfrytëzoje për vehte dhe ndihmoi edhe tjerëve, ofroja të shërbehen edhe të tjerët, sepse në këët vepër ka shpërblim të madh te All-llahu, subhanehu ve teala.

Sa i përket faljes së borxheve ose larjes së borxheve, për vlerën e kësaj vepre flet Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke thënë:

"Ishte një njeri që u jepre njerëzve borxh. Djemve që e mbledhnin borxhin u thoshte: nëse takoni ndonjë të ngratë faljani, se ndoshta All-llahu na e fal neve. E kur e takoi All-llahun e gjeti se ia kishte falur mëkatet". (Buhariu dhe Muslimi).

Abdull-llah ibën Ebi Katadeja tregon se Ebu Katadeja e kërkoi një borxhli, kurse ai fshihej. Pas një kohe e gjeti, kurse ai i tha: jam në ngushticë. I tha: pashë All-llahun je në ngushticë? I tha: pasha All-llahun jam në ngushticë. I tha: kam dëgjuar Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke thënë:

"Cilin e gëzon shpëtimi nga bregat e Ditës së Kijametit le tia lehtëson atij që është në ngushticë ose le tia fal borxhin". (Muslimi).

Këto cilësi i kanë patur burrat e mëdhenjë nga brezi i parë i muslimanëve.

Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, thotë: "Ebu Xhaferin e quanim babai i të ngratëve, sepse shkonte në shtëpi e nëse nuk gjente asgjë, na

sillte enën ku kishte mbetur pak mjaltë dhe ne lëpinim atë që kishte mbetur". (Tirmidhiu).

Ebu Berzete El-Eslemiu kishte me vehte një enë të veçantë me përshesh në mëngjes dhe në mbrëmje, të cilin e kishte të rezervuar për të vejat, jetimët dhe të ngratët. ("sijer", 3/42).

Ali ibën Husejni, radijall-llahu anhu, mban-te bukë në shpinë gjatë natës dhe i përcjellte të ngratët në erësirë dhe thoshte:

"Sadakaja në erësirën e natës e fik hidhërimin e Zotit". ("sijer", 4/393).

Muhamed ibën Is'haku, rahimehull-llah, thotë: njerëzive të Medinës u vinte ushqimi e ata nuk e dinin se nga ju vjen. Kur vdiq Ali ibën Husejni, u mungoi ai ushqim që u vinte natën dhe e kuptuan se ai paska qenë. Andaj thuhej se ai kujdesej për njëqind shtëpi në Medinë". (shiko: "Zevaiduz-Zuhd", fq. 166).

Shubeja, rahimehull-llah, thotë: Kur vdiq Zubejri, Hakim ibën Hizami e takoi Abdullah ibën Zubejrin e i tha: sa ka lënë borxh vëllau im? Tha: një milion. Tha: unë i laj pesëqind mijë prej tyre.

Shikoni se sa janë interesuar për njëri tjetrin ata burra të devotshëm, sa janë kujdesur për të ngratët dhe nevojtarët, sa shumë janë kujdesur për shoqërinë, andaj ata edhe meritojnë të jeni shembulli ynë.

Pika e tretë: Ky hadith stimulon futjen e gëzimit dhe lumturisë në zemrën e muslimanit, me fjalë të mirë, me ndihmesë të ndryshme, me participim në bregat e tija, etj.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

". . . veprat më të dashura te All-llahu janë: gëzimi i një muslimani; . . .".

Kurse në hadithin tjetër Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na i tregon disa cilësi me të cilat duhet të pajisemi dhe stolisemi për të sjellur gëzim dhe lumturi në shoqërinë në të cilën jetojmë, duke thënë:

"Mos nënçmoni asnjë të mirë, edhe në qoftëse

është takimi i vëllaut i buzëqeshur". (Muslimi).

Pastaj tregon se buzëqeshja konsiderohet edhe sadaka, një vepër e cila shpalos shpirtin human që ka besimtari në raport me vëllan e tij:

"Buzëqeshja në fytyrën e vëllaut tënd është sadaka". (hasen, Tirmidhiu).

Këto cilësi i kanë poseduar burrat e devotshmë nga gjeneratat e para dhe kanë dhënë shëmbull konkret në këtë drejtim. Zbatimi i këtyre porosive peygamberike ka qenë edhe shkaku i cili i ka bërë ata fatlum dhe shoqëri e artë në historinë njerëzore.

Pika e katërt: Ky hadith thërret në posedim edhe të një vlerë të lartë, e ajo është posedimi i durimit kur të hidhërohet njeriu dhe përmbajtja e vetes gjatë mllëfosjes.

Durimi gjat hidhërimit dhe përmbajtja e vetes gjat mllëfosjes është prej veçorive të burrave të mirë dhe cilësi prej cilësive të njerëzve të devotshëm.

All-llahu, subhanehu ve teala, i sqaron këto cilësi në Kur'an duke thënë:

"Dhe ngutuni (me punë që meritoni) në falje mëkatesh nga Zoti juaj dhe për një xhennet, gjerësia e të cilit është si gjerësia e qiejve dhe e tokës, i përgatitur për të devotshmit. Të cilët japin kur janë shirë edhe kur janë në vështirësi dhe që e frenojnë mllëfin, që ua falin (të keqen) njerëzve, e All-llahu i do bamirësit". (Ali Imran: 133- 134).

Komentatorët e Kur'anit kanë thënë: "frenimi i mllëfit" ka domethënien se njeriu ka mundësi të hakmiret, mirëpo këtë nuk e bën, ai nuk shfaq as fjalë e as vepër e cila mund të kuptohet si hakmarje edhe pse ai ka mundësi ta bëjë këtë gjë.

Kurse Peygamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka sqaruar vlerën e përmbajtjes së vetes gjatë mllëfosjes duke thënë:

"Ai që frenon mllëfin edhe pse ka mundësi të hakmiret, All-llahu do ta thërret në prani të gjithë krijesave dhe do ti jep të zgjedh prej

cilave hurija dëshiron". (Hasen, Tirmidhiu).

Kurse në transmetimin e Ibën Maxhes qëndron:

"Sa gëlltitje me shpërblim më të madh se sa gëlltitja e hidhërimit për hirë të All-llahut". (hasen, Ibën Maxheja, shiko: "sahihu Ibën Maxhe", nr. 3377).

Asnjëherë njeriu nuk duhet ti lejoj vetes që të marrë vendim kur është i hidhëruar, sepse secilin vendim që do ta mer në atë gjendje më shumë do të sjell pasoja negative se sa zgjidhje të problemit. Andaj edhe nga kjo këshillë Peygamberike e përfitojmë edhe këtë mësim pedagogjik, që vendimet tona mos të mirën në afekt dhe si reagim i ndonjë presioni ose padrejtësie, por duhet duruar në goditjen e parë dhe duhet pritur që të na kalojë hidhërimi dhe mllëfi, e pastaj të marrin ndonjë vendim ose qëndrim, pa dyshim se këto qëndrime dhe vendime që do të mirren pas largimit të hidhërimit, do të jenë të sakta dhe të gjithëdobishme.

Pika e pestë: Ky hadith qorton moralin e keq dhe tregon se morali i keq edhe fundin e ka të keq.

Peygamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka ardhur për të përsosur moralin, u ka sjellu njerëzve një sistem të madh moral, i cili i ka fisnikëruar edhe beduinët më të pagdhendur.

Me moral të lartë e ka lavdëruar All-llahu në Kur'an duke thënë:

"Vërtet, ti je në një shkallë të lartë të moralit!". (El-Kalem: 4).

Peygamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në shumë hadithe e ka sqaruar vlerën e moralit të mirë duke thënë:

"Nuk ka gjë më të rëndë në peshojën e besimtarit Ditën e Kijametit se sa morali i mirë, kurse All-llahu e urren ate që flet fjalë imorale dhe të keqin". (sahih, Tirmidhiu).

Gjithashtu Peygamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka treguar se njeriu me moral të mirë arrin gradën e atij që fal namaz nate dhe agjëron vullnetarisht duke thënë:

"Besimtari me moralin e tij të mirë arrin gradën e agjëruesit (vullnetar) dhe atij që fal namaz nate". (sahih, Ebu Davudi).

Disa dijetar të selefite kanë thënë:

"Moralin e keq është e keqe që me te nuk ban dobi sasia e madhe e të mirave, kurse moralin e mirë është një e mirë që nuk ban dëm sasia e madhe e të këqijave".

Transmeton Imam Ahmedi me sened të vërtetë nga Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, i cili tregon se një njeri i ka thënë Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem:

"O i Dërguar i All-llahut, një grua fal shumë namaz, agjëron shumë dhe jep sadaka shumë, mirëpo u pengon fqinjëve me gjuhën e saj? Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: ajo është një zjar. Pastaj i tha: o i Dërguar i All-llahut. Një grua nuk falet shumë, nuk agjëron shumë dhe nuk jep sadaka shumë, sadaka jep pjesë të vogla nga tlyni, mirëpo nuk i dëmton fqinjët? Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: ajo është në xhennet".

Ska dilem se sjellja dhe moralin e mirë i sjellin këto shpërblime, kurse sjellja e keqe ta prish fenë sikurse uthula që e prish mjaltnë, sepse i hap dyert e veprave të këqija dhe e shpien njeriun në gabime shkatërruese.

Keni frikë All-llahun dhe përgjigjuni Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i cili ju thërret në gjëra të cilat ju gjallërojnë, kapuni për këto virtyte të larta, pajisuni dhe stolisuni me to, nëse dëshironi të jeni të lumtur dhe fitimtar.

- II -

All-llahun e falënderojmë, paqa dhe bekimi qofshin mbi Muhammedin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, familjen e tij të pastër dhe të ndershme, shokqët e tij fisnik dhe të sinqertë dhe mbi të gjithë ata që ecin rrugës së tyre deri në Ditën e Kijametit.

Besimtar të nderuar!

Jemi në prag të muajit të bekuar të Ramazanit, andaj duhet të përgaditemi.

Përgaditja nuk është vetëm mbushja e frigoriferave me ushqime të llojllojshme, mirëpo ajo që është më e rëndësishmeja është të përgaditemi psikikisht dhe me iman për ta pritur këtë mysafir të nderuar.

Prej gjërave që konsiderohen si përgaditje shpirtërore janë edhe këto:

1- Vendose të largohesh nga mëkatet që i ke bërë deri tani;

2- Vendose ti shtosh veprat e mira që i ke bërë deri tani;

3- Vendose ta shtosh leximin e Kur'anit dhe bërjen e dhikrit, që së paku një herë gjat këtij muajit ta bësh hatme Kur'anin, në mos ma shumë.

4- Vendose që gjatë këtij muajit ta përmirososh sjelljen dhe moralin tënd, ashtu që kur të përfundon ky muaj i bekuar ta ndërrosh veten tënde tërësisht.

5- Pajisu me një pendim të sinqertë dhe të pastër, i cili të çon në këtë muaj të pastër nga çdo mëkat.

Këto janë disa porosi që duhet ti kemi parasysh dhe të bëjmë nijet për punë të mira, sepse ai që e bën nijet ta bëjë një punë të mirë, All-llahu ia shenon si një vepër të mirë, siç transmeton Imam Muslimi në sahihun e Tij, nga Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

All-llahun e lusim që të na e shton dijen dhe besimin!

All-llahun e lusim që të na jep dije të dobishme, vepra të mira dhe rizk hallall!

All-llahun e lusim që të na jep nga të mirat e kësaj bote dhe nga të mirat e ahiretit!

All-llahun e lusim që të na mundësoj ta arrijmë këtë muaj ashtu si i ka hije një besimtar të devotshëm dhe serioz! Amin..

Përgaditi: Bekir Halimi

8.10.2004

## Mikpritja e Ramazanit

Pa dyshim se njerëzit zakonisht urojnë dhe përgëzojnë gjërat e mira që u ndodhin njerëzve në jetë. Në këtë drejtim duhet të jetë edhe përgëzimi që duhet t'ia bëjmë njëri tjetrit për ardhjen e këtij muaji të bekuar, muajit Ramazan.

Nëse analizojmë gjendjen e muslimanëve të hershëm duke filluar që nga koha e Muhammedit, alejhisselam, do të vërejmë se ata ua kanë përgëzuar njëri tjetrit ardhjen e këtij muajit të bekuar.

Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, tregon se Pejgamberi, salall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

U ka ardhur Ramazani, muaj i bekuar. All-llahu ua ka obliguar agjërimin e këtij muaji. Në këtë muaj hapen dyert e qiellit, mbyllen dyert e xehenemit, lidhen në pranga shejtanët e inatosur. All-llahu në këtë muaj ka një natë, e cila është më e mirë se një mijë muaj. Ai që privohet nga të mirat e kësaj nate, është privuar nga çdo e mirë". (Nesaiu, sahih).

Ky hadith i lartpërmendur na mëson se duhet përgëzuar dhe urrear muslimanët njëri tjetrit ardhjen e këtij muajit të bekuar dhe fitimprurës.

Ibën Rexhebi, rahimehull-llah, thotë: "Si ka mundësi mos të përgëzojë besimtari me hapjen e dyerve të xhennetit?! Si ka mundësi mos të përgëzojë mëkatari me mbylljen e dyerve të zjarrit?! Si ka mundësi njeriu i mençur mos të përgëzojë për kohën, në të cilën prangosen djajtë?! Si ka mundësi që kjo kohë t'i përngajë në ndonjë mënyrë kohëve tjera?!". ("Lataiful-Mearif", fq. 279).

### Publikim i gëzimit dhe lumturisë për ardhjen e këtij muajit të bekuar

Ashtu sikurse gëzohet njeriu në jetë për gjëra të mira që i ndodhin, aq më shumë duhet të gëzohet dhe ta publikon këtë gëzim, kur t'i ofrohet mundësia për adhurim dhe respekt ndal

All-llahut, subhanehu ve teala.

Kjo ndjenjë i ka kapluar të gjithë besimtarët e devotshëm që nga koha e muslimanëve të parë e deri më këto ditë.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

Thuaj: "Vetëm mirësisë së All-llahut dhe mëshirës së Tij le t'i gëzohen, se është shumë më e dobishme se ajo që grumbullojnë ata". (Junus: 58).

Ibën Rexheb Hanbeli thotë: "Arritja e muajit të Ramazanit dhe agjërimi i tij është dhunti shumë e madhe për ate që ia mundëson All-llahu i Lartësuar. Argument për këtë është hadithi që tregon për tre personat, prej të cilëve dy ranë shehidë, kurse i treti vdiq në shtratin e tij, pas tyre. Këtë të fundit e panë në ëndër, se ua kishte kaluar. Atëherë Pejgamberi, salall-llahu alejhi ve sel-lem, tha:

A nuk ka falur pas tyre kaq e kaq namaze, e ka takuar muajin e Ramazanit dhe ka agjënuar. Pasha Ate në Dorë të të Cilit është shpirti im, mes tyre ka dallim sikurse mes qiejve dhe tokës". (Ahmedi, sahih).

Ai që mëshirohet në këtë muaj, ai është i mëshiruari, ai që privohet nga të mirat në këtë muaj, ai është i privuari, ai që nuk mer nozull nga këto ditë për ditën e kthimit, ai është i qortuari". ("Letaiful-Mearif", fq. 280).

### Kush gëzohet me ardhjen e Ramazanit

Ata që gëzohen me ardhjen e muajit të Ramazanit janë dy lloje:

1- Njerëzit e adhurimeve dhe besimit;

Ata gëzohen me ardhjen e këtij muajit sepse në këtë muaj u hapen mundësitë për adhurime të llojllojshme dhe për shkak të shpërblimit që e ka përgaditur All-llahu për ata që agjërojnë.

All-llahu ka përgaditur shpërblime për:

#### a) Agjërimin:

Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, tregon se

Pejgamberi, salall-lahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

Ai që e agjëron muajin e Ramazanit me besim dhe shpresim (të shpërblimit), i falen mëkatet që i ka bërë më herët". (Buhariu dhe Muslimi).

#### **b) Kujdesu për namazin.**

Nëse dëshiron që agjërimi yt të jetë i pranuar te All-llahu, kujdesu për namazin. Sepse namazi është shtylla kryesore e fesë, pa këtë shtyllë nuk ngritet godina e Islamit.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

Islami ngritet mbi pesë shtylla: mbi dëshminë se s'ka hyjni tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi është i dërguar i All-llahut, falja e namazit, dhënja e zekatit, agjërimi dhe kryerja e haxhit". (Buhariu dhe Muslimi).

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"Po, nëse ata pendohen, e falin namazin dhe e japin zeqatin, atëherë i keni vëllezë në fe. Ne sqarojmë agumentet për ata njerëz që kuptojnë". (Et-Teube: 11).

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

"Gjëja kryesore është islami, shtylla kryesore është namazi, kurse kulmi i Islamit është xhjadi në rrugë të All-llahut". (Hadithi është sahih).

Namazi është gjëja kryesore në Islam, pas shehadetit, është binak i shumë ibadeteve, është nëna e ibadeteve, është urdhëri i All-llahut, porosia e fundit e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, është pasqyrë e veprave të muslimanit, shenjë e madhërimit të fesë në zemër të besimtarit, është shtylla e krejt feve qiellore, është simbol i vendit islam, është besim, është denoncim nga nifaku, është rruga e besimtarëve, simbol i grupit të shpëtuar dhe miqve të All-llahut, është ibadet i përbashkët i mbarë krijesave, vepra më e mirë, mënyra më e mirë për t'iu afruar All-llahut, shkollë morale, është qetësi, rehati dhe kënaqësi, është dritë dhe argument, është dhuratë hyjnore, është falënderim ndaj dhuntive të All-llahut, është mlllefosje e shejtanit

dhe ushtarëve të tij, çlirim i njerëzimit, të pengon nga veprat e këqija dhe epshet, t'i shlyen mëkatet dhe t'i asgjëson, është strehimore e besimtarit në vështirësi, është mburojë dhe mbrojtje, ta sjell rizkun, është fillimi dhe mbarimi i Islamit, është shkak i fitores dhe ngadhënjimit në dunja dhe ahiret, shpëtim prej denimit të varit, është shpresa e të vdekurve dhe të denuarëve, shpëtim nga denimi i Zotit, shkak për tu ngritë gradat, të mundëson ta shohish Zotin në xhennet, është çelësi i udhëzimit, etj. Kurse lënja e sajë është mosbesim, prej mëkateve më të mëdha, është dyfytësi, është errësi dhe shkatërrim në dunja dhe ahiret, është shkak për përfundim të keq, shkak për tu denuar në var, është simbol i banorëve të xhehenemit, shkak që të fundoset njeriu në epshe, është fatëkeqësi dhe bela, i mundëson shejtanit ta ngërthen, është tradhëti e emanetit dhe meriton denimin e All-llahut në dy botërat.

#### **c) Namazi i teravisë.**

Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, tregon se Pejgamberi, salall-lahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Kush fal namazin me besim dhe shpresim, i falen mëkatet që i ka bërë më herët". (Buhariu dhe Muslimi).

#### **d) Gjallërimi i natës së Kadrit.**

Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, tregon se Pejgamberi, salall-lahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Kush e gjallëron natën e Kadrit me besim dhe shpresim, i falen mëkatet që i ka bërë më herët". (Buhariu dhe Muslimi).

Aisheja, radijall-llahu anha, tregon se Pejgamberi, salall-lahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Kërkoni natën e Kadrit në netët tek të dhjetshit të fundit të Ramazanit". (Buhariu).

#### **e) Umreja.**

Pejgamberi, salall-lahu alejhi ve sel-lem, i tha:

"Kur të vjen muaji i Ramazanit, kryje umren gjatë këtij muaji, sepse umreja gjatë këtij muajit

është sikurse haxhxi". E në transmetimin tjetër qëndron: "Umreja gjat Ramazanit vlen sa haxhxi ose sa haxhxi me mua". (Buhariu).

f) Leximi i Kur'anit.

Ibën Abbasi, radijall-llahu anhu, tregon se Pejgamberi, salall-llahu alejhi ve sel-lem, ka qenë njeriu më bujar, e më bujari ishte gjat Ramazanit, kur takohej me Xhibrilin, alejhisselam., Ate e takonte secilën natë të Ramazanit, nga i cili e mësonte Kur'anin. Me të vërtetë Pejgamberi, salall-llahu alejhi ve sel-lem, ishte më bujar se era (që sjell pllenimin). (Buhariu).

g) Sadakaja.

Elhamdullillah që te muslimanët tanë muaji i Ramazanit shfrytëzohet edhe për të dhënë zekatin dhe sadakanë, për shkak të shpërblimit të madh që kanë këto vepra të mira. Zaten këto zeqate dhe sadaka janë duke e mbajtur në këmbë fenë Islame në këto vende. Këto kontribute janë shkak për ndërtimin e xhamiave, stipendimin e studentave, kujdesin për jetimat, strehimin e atyreve që nuk kanë kulm mbi kokë e shumë aktiviteteve tjera.

Muslimani nuk duhet të nguron të ndihmon me sa ka, ai që mundet jep 1000 denar, kush nuk ka aq le ti jep 500 denar, e ai që ska aq le të jep 100 denar, e ai që ska ma shumë se një denar, le ta jep një denar, sepse te All-llahu, çdo vepër sado që është e vogël llogaritet, sikurse na ka treguar All-llahu në Kur'an:

"E kush punoi ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë". (El-Zelzele: 7-8).

Ne si musliman e kemi obligim që ti kuptojmë mirë porosinë e Kuranit dhe ti zbatojmë ato, e mos të bëhemi si ata që i lexojnë ajetet, mirëpo i kalojnë sikur asgjë mos të jetë thënë.

Ja një rast se si muslimanët e parë i kanë kuptuar porosinë e All-llahut.

Transmeton Abdullah ibën Meduri, radijall-llahu anhu, i cili thotë: kur zbriti ajeti Kuranor:

"Kush është ai që i huazon All-llahut një hua të mirë, e Ai t'ia shtojë atij shumëfish atë? All-llahu shtrëngon (varfëron) dhe gëron (begaton) dhe kthimi juaj është vetëm tek Ai". (El-Bekare: 154).

Ebu Dahdah El-Ensariu, radijall-llahu anhu, tha: All-llahu dëshiron prej neve borxh? Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i tha: po, o Ebu dahdah. Tha: ma zgjat dorën o i Dërguar i All-llahut. Ia zgjati dorën e i tha: unë kopshtin tim ia jap borxh Zotit tim. Tha: kopshti i tij kishte gjashtëqind pemë hurma, kurse Ummu Dahdah dhe fëmijët e tyre ishin në kopsht. Shkoi Ebu Dahdahi dhe bërtiti: Ooooo Ummu Dahdah! Urdhëro burri im, iu përgjigj gruaja. Tha: dil nga kopshti se ia kam dhënë borxh Zotit tim, e kur e dëgjoi këtë gjë Ummu Dahdahi, ua nxori fëmijëve kafshatat e hurmave nga goja dhe ua zbrazti xhepat. Atëherë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: "Sa e sa kalavesha të rrast do të ketë Ebu Dahdahi në xhennet". (sahih).

2- Njerëzit e shkujdesur, të argëtimit dhe mëkateve.

Ata gëzohen për llojllojshmërinë e ahengjeve dhe argëtimit që bëhen gjat muajit të Ramazanit, prej tyre:

- Ushqimet e llojllojshme të Ramazanit.

Me të cilat ushqime mbushin barkun dhe ngopen dhe e stërngarkojnë lukthin. Nga kjo gjë shumë pak njerëz shpëtojnë. Pa dyshim se kjo është në kundërshtim me urtësinë e agjërit, i cili kërkon pakësim të ushqimit, që ndihmon në pastrimin dhe lartësimin e shpirtit. Pastaj mbushja e barkut me llojloj ushqime të këndshme të pengon edhe gjat faljes së namazit të teravisë.

Të vërtetën e ka thënë Pejgamberi, salall-llahu alejhi ve sel-lem, kur thotë:

"Biri i Ademit nuk ka mbushur enë më të keqe se sa barkun e vet. I mjafton birit të Ademit disa kafshata për ta mbajtur gjallë shpirtin, e nëse e ka domosdo, atëherë një të tretën për ushqimin e tij, një të tretën për pijen dhe një të tretën për frymëmarje". (Tirmidhiu, sahih).

- Televizori dhe tubimet e ndryshme gjatë ramazanit dhe përcjellja e llojloj serialeve.

Këto gjëra të fusin në harame, qofshin harame të syrit, ose të veshit ose të gjymtyrëve tjera. Përdorimi i gjymtyrave tuaja në gjëra të ndaluar gjatë këtij muajit të bekuar, duke pasur para sysh vlerën e këtyre ditëve, me të vërtetë është një mëkat shumë i madh.

- Përzjerja e gjinive, grave dhe burrave nëpër vende të shumta, gjëra të cilat bëhen shkak për të rënë në mëkate edhe më të mëdha, siç është vetmimi me grua të huaj ose rënia në mëkatin e zinasë. Për këtë gjë përgjegjësi i parë dhe kryesor është kryefamiljari.

Pejgamberi, salall-lahu alejhi ve sel-lem, thotë:

“Secili prej jush është bari dhe secili do të jep llogari për tufën e tij. Imami është bari dhe është përgjegjës për tufën e tij (xhematin). Burri është bari në shtëpinë e tij dhe është përgjegjës për tufën e tij. Gruaja është bari në shtëpimë e burrit të saj dhe është përgjegjëse për tufën e sajë. Shërbëtori është bari në pasurinë e pronarit të vet dhe është përgjegjës për tufën e tij”. (Buhari).

Mirëpo si të jemi mikpritës të mirë?

Ndoshta gjërat që duhet t'i bëjë muslimani si përgatitje për mikpritje të mirë të këtij sezoni të adhurimeve janë të shumta, ne shkurtimisht do t'i përmendim disa prej tyre:

1- Ta përgatisim vehten për një sezonë përplot me vepra të mira, e cila është mundësi shumë e madhe për të mira, për të shtuar adhurimet dhe për të fituar shumë të mira.

2- Gëzimi për ardhjen e këtij muajit, zemërgjërësia se na afrohet ky muaj, lumturia se do ta takojmë këtë muaj, sepse një njeri mund të fitojë mëshirën dhe dhuntitë e All-llahut në një natë të bekuar, e të fitojë lumturinë e dunjasë dhe të ahiretit.

3- Të nxitojmë në pendim të sinqertë nga të gjitha mëkatet dhe gabimet, të bëjmë istigfar për çdo mangësi që kemi karshi Zotit, të ndiejmë keqardhje për çdo gjë që kemi bërë në të kaluarën, qofshin të mëdha ose të vogla. Këtë muaj të fillojmë nga fillimi, që ta mbushim faqen e bardhë me të mira dhe vetëm me të mira, e mos të njollosim me asgjë tjetër.

4- Të jemi të vendosur që ta shfrytëzojmë çdo çast të këtij shansi të madh në gjëra që na afrojnë drejt Zotit, qoftë falja e namazit me xhemat në xhami, plotësimi i agjërimit, falja e namazit të natës pa lodhje dhe pa mërzi, leximi i Kur'anit, kujdesi për prindërit dhe farefisën, dhënia sadaka, bamirësia, e shumë vepra tjera të mira, duke përpunuar një planprogram konkret për kalimin e këtij muajit.

5- Ta falënderojmë All-llahun dhe ta lavdërojmë Atë ditë e natë, nëse ta zgjat ymrin dhe ta mundëson ta takosh këtë muaj të bekuar, e nëse ta lehtëson agjërimin dhe namazin në këtë muaj.

6- Përgadit shtëpinë për mikpritje meritorë të këtij mysafiri dhe nxit familjen tënde që të përgaditen për te, duke nxjerrur të gjitha gabimet, që të jetë shtëpia e pastër dhe e përgaditur për tu mbushur me adhurime dhe respekte dhe duke përgatitur numër të mjaftueshëm të mus'hafave.

7- Llogarit paraprakisht sasinë e zekatit që duhet ta japish, nëse e plotëson vitin në Ramazan, ose nëse zakonisht e jep zekatin në Ramazan.

8- Nxito të kompenzosh ditët që i ke të pagjërëuara nga Ramazani i kaluar dhe mos jeni liberal në këtë drejtim, e të arrijë ky Ramazan pa e larë borxhin nga Ramazani i kaluar, sepse kështu bëhesh mëkatar.

Përgaditi: Bekir Halimi  
15.10.2004

## Sqarim për metodën e Ehli Sunnetit

Në kohën e fundit janë përzier shumë gjëra. Secili pretendon se është në të vërtetë, mirëpo askush nuk e mbështetë këtë pretendim me argument të fuqishëm nga Kur'ani dhe Sunneti i e vërtetë i Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, dhe nga qëndrimet dhe pikpamjet e brezave të parë të muslimanëve, ajo që njihet se gjenerata e artë e Islamit (Es-Selefus-Salih).

Duke u nisur nga ky fakt dhe nga fakti se mungesa e njohjes së rregullave të Ehli Sunnetit kanë shkaktuar shumë probleme, dilema dhe kokëçarje në mesin e muslimanëve.

Disa nga mosnjohja e mirë e këtyre rregullave nuk kanë arritur ta kuptojnë rrugën e vërtetë të Ehli Sunnetit dhe kanë përzier mes frakcioneve të shumta që kanë dalur në historinë Islame dhe Ehli Sunnetit.

Të tjerët nga mungesa e kësaj dije kanë shkuar në ekstrem duke e ngushtuar shumë domethënien e Ehli Sunnetit, aq sa të i kaplojë vetëm ata.

Të tretët duke mos e njohur menhexhin e Ehli Sunnetit si duhet kanë shkuar në ekstrem tjetër të anatemosjes së muslimanëve, sikur të jetë kjo detyra e tyre, e jo thirrja në fenë e All-llahut, subhanehu ve teala.

Të katërt duke u munguar njohja e këtij menhexhi, kanë devijuar dhe i janë nënshtruar tërësisht mendimve të tyre personale, ose logjikës në përgjithësi.

Në mungesë të njohjes së menhexhit të Ehli Sunnetit njerëzit kanë shenjtëruar mendjen, njeriun, hoxhën, mësuesin, medhhebin,

filozofinë, filozofët, e jo Kur'anin dhe Sunnetin dhe metodën e muslimanëve të parë të devotshëm (es-Selefus-Salih).

Të gjitha këto devijime në shoqërinë tona kanë ardhur si rezultat i mosnjohjes së këtij menhexhi, ose kësaj metodologjie.

Kjo njëherazi sqaron edhe nevojën e madhe dhe imediate që ka populli ynë për njohjen e parimeve dhe rregullave të metodës së Ehli Sunnetit.

### Termi Ehli Sunnet është përshkrim fetar

Disa e pshor në të kaluarën dhe në kohën e tashme mendojnë se termi Ehli Sunnet është emërtim të cilin selefi ia ka dhënë vetvetes dhe pasuesve të tyre, kurse e vërteta është se Ehli Sunneti është përshkrim fetar për ithtarët e të vërtetës, të cilët kapen për sunnet, pasi që të dalin nga ajo ithtarët e epsheve, bidateve dhe përçarjes. Ehli sunneti është grupi që mbetet e kapur për të vërtetën, siç na ka treguar Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem:

"Do të mbetet një grup nga ummeti im ngadhjimtari me të vërtetën, nuk u ban dëm ai që i tradhton e as ai që kundërshton, derisa të vijë urdhëri i All-llahut, ata do të mbeten në këtë gjendje".

Sipas këtij hadithi del në shesh se feja do të përfaqësohet nga një grup, i cili është grupi i shpëtuar, të cilën e ka veçuar Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, nga grupet e shkatërruara për shkak të divergjencave dhe përçarjeve në fe.



Në hadithin e vërtetë, të cilin e transmeton Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

"Janë përçarë çifutët në shtatëdhjet e një grupacion, kurse kristianët në shtatëdhjet e dy grupacione, kurse ummeti im do të përçarhet në shtatëdhjet e tre grupacione".

Dijetarët dhe imamët e udhëzimit kanë konsensus se grupi i shpëtuar janë Ehli Sunneti vel Xhemaah.

Ehli Sunnetin e përbëjnë: sahabet, tabiinët, selefi i devotshëm, imamët e udhëzimit, dijetarët e hadithit, dijes dhe fikhut në fe, gjatë tre shekujve të parë të vlefshme, ata që kanë pasuar rrugën e tyre, kanë ecur hapave të tyre, që nuk kanë shpikur në fe gjëra që nuk janë pjesë e udhëzimit të tyre, sepse ata kanë qenë në hapësirë të bardhë, kanë patur argumente nga Zoti i tyre, nuk i ka kapluar epshi dhe fitnet, nuk i ka devijuar bidati nga lidhja më e fortë (Urvetul-Vuthka) dhe rruga e drejtë.

Ehli Sunneti janë ata që janë në atë rrugë në të cilën ka qenë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, shokët e tij, tabiinët, në udhëzimin publik dhe të mbrendshëm.

Udhëzimi i Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, sahabeve dhe selefit të devotshëm është i qartë, i transmetuar, i regjistruar dhe i ruajtur: Kur'ani dhe Sunneti i Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, si i ka kuptuar selefi i devotshëm dhe pasuesit e tyre.

Edhe pse kjo çështje është shumë e qartë, shumë musliman në këtë shekull, edhe pse kanë kultura të ndryshme, me përhapjen e bidateve, dominimi i disa grupacioneve dhe sekteve, shfaqja e drejtimeve që hedhin dilema në premisat e fesë, nuk i njohin shumë gjëra të fesë dhe besimit të tyre.

Nga ky shkak në mesin e muslimanëve u bë i panjohur koncepti i Ehli Sunnetit, bazat dhe udhëzimi i tyre, saqë disa injorantë filluan të pretendojnë se:

Ehli Sunneti është histori që ka kaluar.

Asnjë grupacion nuk e meriton këtë përshkrim.

Metoda e selefit është vetëm baza teorie utopike.

Të gjithë muslimanët, pa dallim pikënisjet e tyre janë në Sunnet.

Metodës së Sunnetit i ka skaduar afati, andaj duhet kërkuar alternativa dhe reforma.

Imamët e Selefit e kanë shpikur këtë përshkrim për vetveten.

Përshkrimi i Ehli Sunnetit nuk i përket askujt, sepse secili e pretendon dhe askush se meriton.

Sikurse në kohën e fundit janë shfaqur pretendime dhe parulla nga ithtar të epsheve, nga disa frakcione dhe xhimate, që i kundërshtohen Sunnetit dhe Xhemaatit, se ata janë Ehli Sunneti, ose se janë pjesë e tyre, ose se i përkasin atyreve. Këto pretendime janë të çveshura nga argumenti dhe fakti.

Sqarimi i tërë kësaj vijon në kapitullin e ardhshëm.

Koncepti fetar dhe terminologjik i Ehli Sunneh vel-Xhemaah

Nëse ndalemi dhe analizojmë domethënien e Sunnetit, Xhemaatit, siç përmenden në tekstet e sherijatit, siç e kanë shprehur Selefi dhe e kanë kuptuar, e shohim se në mënyrë të qartë përcaktohet koncepti i shëndoshë i Ehli Sunnetit.

Kush janë ata? Cilët janë cilësitë e tyre? Cila është metoda e tyre?

Duke u nisur nga këto pyetje mund ta definojmë Ehli Sunnetin nga shumë aspekte: nga prizma e cilësive, veçorive dhe metodës së tyre, nga prizma e definicioneve të selefit për ta, nga prizma e definimeve që i kanë dhënë ata për vehten, sepse shtëpiaku më mirë e di se çka në shtëpinë e vet.

Nga këto këndvështrime mund të njohim Ehli Sunnetin se:

Një: Janë shokët e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ata janë ithtarët e Sunnetit, të cilin e kanë mësuar, e kanë kuptuar, e kanë zbatuar, e kanë transmetuar dhe kanë bartur si transmetim, mësim dhe metodë. Andaj ata më së shumti e meritojnë emërtimin e Ehli Sunnetit, sepse janë të parët që janë dhënë pas Sunnetit, si dije, vepër dhe kohë.

Dy: Viojnë pasuesit e sahabeve të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, të cilët e kanë marrë fenë prej tyre, e kanë transmetuar, e kanë mësuar dhe kanë vepruar sipas sajë, tabiinët dhe etbau tabiinët dhe ata që i kanë pasuar këto breza në mënyrë të mirë deri në ditën e Gjykimit. Këta janë ithtarët e Sunnetit të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, të cilët janë kapur për te, nuk kanë shpikur dhe nuk kanë pasuar rrugën e jobesimtarëve.

Tre: Ehli Sunne vel-Xhemaah janë Selefus-Salihu, ithtarët e Kur'anit dhe Sunnetit, ata që veprojnë sipas udhëzimit të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, pasuesit e gjuermëve të sahabeve, tabiinëve, imamëve të udhëzimit, të cilët duhet ti pasojmë në fe, ata që nuk kanë shpikur dhe nuk kanë ndryshuar asgjë në fenë e All-llahut.

Katër: Ehli Sunneh vel-Xhemaah janë grupi i shpëtuar mes grupacioneve tjera, pala ngadhënjimtare dhe e ndihmuar deri në ditën e Kijametit, sepse ata janë që përputhen me hadithin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem:

"Do të mbetet një grup nga ummeti im ngadhënjimtar me të vërtetën, nuk u ban dëm ai që i tradhton e as ai që kundërshton, derisa të vijë urdhëri i All-llahut, ata do të mbeben në këtë gjendje".

Pesë: Janë jabanxhinjë kur të shtohen epshet, devijimet dhe bidatet, atëherë kur të prishet koha, duke patur parasysh hadithin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem:

"Ka filluar Islami si jabanxhinjë dhe do të

kthehet si ka filluar, xhenneti qoftë për këta jabanxhinjë".

"Xhenneti qoftë për këta jabanxhinjë: njerëz të mirë në mesin e shumë njerëzve të këqinjë, ata që nuk i respektojnë janë më shumë se ata që nuk i respektojnë".

Ky përshkrim përputhet me gjendjen e Ehli Sunnetit.

Gjashtë: Ata janë ithtarët e hadithit, si transmetim, mësim, veprim, andaj e vërejmë se dijetarët e Selefët e kanë komentuar palën e ndihmuar dhe grupin e shpëtuar, Ehli Sunnetin, se janë: dijetarët e hadithit. Kjo transmetohet nga Ibën Mubareku, Ahmed ibën Hanbeli, Buhariu, Ibën Medini, Ahmed ibën Sinani, edhe kjo është e vërtetë, sepse dijetarët e hadithit e meritojnë këtë përshkrim, pasi që ata janë imamët e Ehli Sunnetit.

Imam Ahmedi duke folur për palën e ndihmuar ka thënë: "Nëse nuk janë dijetarët e hadithit nuk e di se kush mundën me qenë".

Kadi Ijadi ka thënë: "Imam Ahmedi ka patur për qëllim Ehli Sunnetin dhe ata që kanë besimin e dijetarëve të hadithit".

Në këtë hyn edhe masa e gjërë e muslimanëve, të cilët janë në fitre dhe nuk janë futur në rrugët e epsheve dhe bidateve, edhe ata janë në sunnet, ata i pasojnë dijetarët e tyre.

Pse janë quajtur Ehli Sunneh vel-Xhemaah?

Janë quajtur Ehli Sunnet sepse: ata veprojnë sipas sunnetit të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, veprojnë sipas asaj që kërkon sunneti, e zbatojnë hadithin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem:

"Kapuni për Sunnetin tim".

Sunnet është: ajo që kanë marrë sahabet nga Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, sherijatin, fenë, udhëzimin e dukshëm edhe ate intern, këtë prej tyre e kanë marrë tabiinët, e pastaj etbau tabiinët, e pastaj imamët e udhëzimit, dijetarët e drejtë, ata

që pasohen dhe ata që ecin rrugës së tyre deri në Ditën e Kijametit.

Andaj, ithtarët e të vërtetës që pasojnë sunnetin janë ehli sunneti, sepse ata e meritojnë këtë epitete me të vërtetë.

Sa i përket emërimit me xhemat, sepse: kanë zbatuar porosinë e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, që të kapen për xhematin (bashkësinë), janë bashkuar në hak, sipas saj kanë vepruar, kanë ecur gjurmëve të xhematit musliman që kanë qenë të kapur për sunnet, nga sahabet, tabiinët dhe etbau tabiinët, sepse ata janë bashkuar në të vërtetë, në pasimin e xhematit, ithtar të sunnetit të të vërtetës. Ata vazhdimisht, falë i qofshim Zotit, bashkohen në respektim të prijësve të tyre, bashkohen për xhihad me prijësit e muslimanëve, për të urdhëruar në të mirë dhe për të ndaluar nga e keqja, bashkohen në sunnet dhe pasim, në lënie të bidateve, epsheve dhe grupacioneve, ata janë xhemati, në të cilin aludoi Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e përshkroi dhe urdhëroi të pasohet.

Në fund vimë në përfundim të qartë se Ehli Sunneh vel-Xhemaah është emër dhe përshkrim që nënkupton:

Një: Kapjen për Sunnet, sepse kështu ka urdhëruar Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke thënë: "Kapuni për Sunnetin tim", dhe kapje për xhematin, sepse kështu ka urdhëruar Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe ka ndaluar nga kundërshtimi dhe largimi prej tij, dalja dhe dallimi prej xhematit. Pra, Ehli Sunneti qenka emërtuar dhe përshkruar nga Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Dy: Mbështetjen në gjurmët e sahabeve dhe selefite, fjalët, përshkrimin dhe gjendjen e tyre. Është emërtim dhe përshkrim për të cilin janë unanimit të gjithë prijësit e udhëzimit, kështu i kanë emërtuar dhe përshkruar ithtarët e të vërtetës. Këtë e dëshmojnë

gjurmët dhe dëshmitë e tyre në librat e tyre.

Tre: Termi Ehli Sunneh vel-Xhemaah është përshkrim fetar dhe i realt, i vërtetë dhe domethënës, i dallon ithtarët e të vërtetës nga ithtarët e shpikjeve dhe epsheve, për dallim nga ata që mendojnë se Ehli Sunneh vel-Xhemaah është emër që është shpikur me kalimin e kohës dhe se është i bërë i njohur pas përçarjes. Kurse e vërtetë është se është emër fetar dhe i transmetuar nga Selefite i këtij ummeti, që nga koha e sahabeve dhe tabiinëve, brezi i parë dhe shekujt e artë.

Kurse ata që thojnë disa epsharakë se Ehli Sunneti e përkufizojnë sunnetin dhe selefizmin në ta dhe se me Selefus-Salih kanë për qëllim ata që janë në shkollën e tyre, edhe kjo është e vërtetë dhe nuk është e metë e as gabim, sepse Selefus-Salihu janë Ehli Sunneti dhe Ehli Sunneti janë Selefus-Salihu, andaj ai që nuk ecë sipas shkollës se Selefite dhe nuk pason metodën e tyre, ai është larguar nga Sunneti dhe Xhemati.

Këtyre njerëzve u themi: ky është Sunneti dhe këta janë ithtarët e tij, Ehli Sunneh vel-Xhemaah, e nëse refuzoni dhe kundërshtoni fjalën e vërtetë. Ne nuk na mbetet asgjë përveç thënies së Nuhit, alejhisselam, që ua ka thënë kundërshtarëve:

"(Nuhu) Tha: "O populli im, më thuani nëse unë jam i mbështetur në argument të qartë nga Zoti im dhe Ai më dha mëshirë nga ana e Tij, e juve u janë fshehur ato (argumentet ngase jeni dhëmë pas kësaj jete), a mos do t'ju detyrojmë për to (pranimin e tyre), kur ju jeni urrejtës të tyre!". (Hud: 28).

A janë të kufizuar në kohë dhe vend?

Ehli Sunneti nuk përkufizohet në vend dhe kohë të caktuar, mund të shtohen në ndonjë vend e të jenë të pakët në ndonjë vend tjetër, mund të shtohen në ndonjë kohë e të pakëoshen në ndonjë kohë tjetër, mirëpo asnjëherë nuk ndërpritet kontinuiteti i tyre.

Në mesin e tyre ka prijës të udhëzimit, llamba të ndriçimit, argument të Zotit para krijesave deri në Ditën e Kijametit, nëpërmjet tyre do të realizohet premtimi i All-llahut për ruajtjen e fesë.

Në këtë mënyrë bëhet e qartë se kush është Ehli Sunneti, kush janë Selefus-Salihut dhe se pretendimet e grupacioneve që janë ndarë nga Ehli Sunneti, se ata janë Ehli Sunneti dhe se janë pasardhës të Selefut, refuzohet sipas rregullave të sherijetit, bazave shkencore dhe fakteve historike.

Ashtu sikurse nuk qëndron as pretendimi se të gjithë muslimanët janë në përputhje me Sunnetin, sepse kjo është përgënjeshtër i lajmeve të All-llahut dhe Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, se ummeti do të përçarhet, dhe është mendjemadhësi dhe përgënjeshtër i realitetit.

E njejtë vlen edhe për pretendimet tjera . . .

Andaj: Ehli Sunneti nuk është parti, parullë, medhheb, por është trashëgëmia e pejgamberisë dhe metoda e tij, rruga e drejtë, lidhja më e fortë, rruga e besimtarëve, e qartë sikur dita edhe nata, vetëm i devijuari largohet prej sajë.

Gabimet, rëshqitjet, bidatet që dalin nga bidatçitë ose ata që i përkasin Ehli Sunnetit, nuk janë pjesë e Sunnetit dhe nuk llogariten nga metoda e vërtetë.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, shokët e tij dhe Selefus-Salihut janë shembëlltira në fe

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, është shembëlltira në fe, pastaj vijnë sahabet, radijall-llahu anhum exhmein, sepse All-llahu i ka lavdëruar, kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i ka edukuar, e ka vdekur duke qenë i kënaqur me ta, ata janë bartësit e fesë me dije dhe vepër, na e kanë transmetuar Kur'anin dhe Sunnetin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kanë vepruar sipas kërkesave të tyre, në

mesin e tyre nuk janë shfaqur epshet, bidatet dhe risitë në fe.

Kudo që janë ata aty është e vërteta dhe haku, ata janë pajtuar vetëm në të vërtetë, për dallim nga grupacionet tjera, të cilat i përkasin personave, parullave ose frakcioneve, ata bashkohen në të devijim.

Pastaj Selefus-Salihut që përbehen prej: tabiinët dhe etbau tabiinët, prijësit e udhëzimit në tre shekujt e vlefshme, ata janë shembëlltira pas sahabeve, sepse kanë qenë në metodë të pejgamberisë, rrugën e sahabeve, nuk kanë ndryshuar e as zëvendësuar.

Në këtë metodë kanë ecur prijësit e fesë, Ehli Sunneti deri në ditët tona dhe kështu do të mbeten deri në Ditën e Kijametit, të kapur për atë që ka sjellur Kur'ani dhe Sunneti, duke pasuar gjurmët e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe Selefus-Salihut, sepse rruga e tyre është rruga e besimtarëve, e nëse njerëzit nuk e pasojnë këtë rrugë e fitojnë kërcënimin e All-llahut dhe me këtë binë ndesh me Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe është shkaktare për të hyrë në zjar. All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"Kush i kundërvihet të dërguarit, pasi që i është bërë e qatë e vërteta dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë në atë që e ka zgjedhur (në Dunja) e e fusim në xhehennem. Përfundim i keq është ai". (En-Nisa: 115).

Andaj është vërtetuar se sharja dhe akuzimi i sahabeve dhe Selefut është akuzim i fesë, të cilën e ka sjellur Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, sikurse është tradhti e ummetit dhe mbarë muslimanëve, sepse akuzon shembëlltiren dhe më të zgjedhurit. Për këtë qëllim epsharakët, bidatçitë dhe përçarësit synojnë akuzimin e sahabeve, tabiinëve dhe Selefus-Salihut, ose disa prej tyre.

Burimet e fesë janë: Kur'ani dhe Sunneti (shpallja)

Metoda e vërtetë, metoda e Selefus-Salihut, Ehli Sunnetit ngritet mbi: burimet e fesë, Kur'ani, Sunneti dhe ixhmaja (që ka të bëjë me ta), gjërat përpos këtyreve janë të kota, sepse me vdekjen e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, është ndërprerë shpallja dhe është plotësuar feja. All-llahu, tebareke ve teala, ka thënë:

"...Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju islam in fe...". (El-Maide: 3).

Kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e ka plotësuar amanetin dhe ka kumtuar shpalljen. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Ju kam lënë dy gjë, nuk do të devijoni pas tyre, ato janë: Libri i All-llahut dhe Sunneti im, ato nuk do të ndahen derisa të vijnë te pishini (Haudi)".

Feja e vërtetë ngritet mbi dorëzimin para Zotit, azze ve xhel-le, kurse dorëzimi nënkupton: besimin dhe zbatimin; dhe pasimin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Kjo është feja e All-llahut, të cilën ia ka zbritur Pejgamberit me shpallje dhe ia ka plotësuar, andaj askujt si takon që të shpikë gjëra duke menduar se janë pjesë të fesë, sepse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Ai që shpik në fenë tonë gjëra që sjanë të saja, ato janë të refuzuara". (Muslimi).

Tërë fenë, akiden dhe sherijatin duhet marrë vetëm nga shpallja.

Akideja paraqet bazën, premisat dhe gjërat statike të fesë, andaj burimet e vërteta të akides janë: Kur'ani, Sunneti dhe ixhmaja e selefite. Këto janë burimet e fesë, kurse nga ky rregull i madh degëzohen edhe këto gjëra:

1- Nëse dallojnë kuptimet e njerëzve për fenë, kuptimi i selefite (sahabeve, tabiinëve dhe atyreve që ecin rrugës së tyre) është argument, është vendimi i prerë në çeshtjet e akides dhe çeshtjet tjera, sepse ata janë

më të zgjedhurit e ummetit, më të diturit, më të devotshmit, kurse All-llahu, tebareke ve teala, dhe Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na kanë urdhëruar ti pasojmë, tu referohemi dhe u është kërcënuar atyreve që nuk pasojnë rrugën e tyre, andaj:

2- Metoda e Selefite në akide mbështetet në Kur'an dhe Sunnet, andaj është metoda më e ditur, më e shëndoshë dhe më e përpiktë. Këtë e dëshmojnë gjurmët e tyre në librat e ndryshme, në librat e Sunnetit dhe gjurmëve.

3- Akideja është teukifije dhe nuk lejohet të miret nga burimet tjera përpos të shpalljes, sepse është gajb që nuk e percepton logjika njerëzore e as shkencat e tyre.

4- Akideja është metafizike në detalet e veta, nuk i percepton logjika në mënyrë të pamvarur, iluzionet nuk mundën ta përtheqojnë, nuk perceptohen me shqisa e as me shkencat ekzakte.

5- Secili që mundohet ta mer akiden prej burimeve jofetare, ai ka shpifur mbi All-llahun gënjeshtër dhe ka thënë mbi All-llahun pa dije.

6- Thamë që akideja ngritet mbi dorëzimin dhe pasimin, dorëzimin para Zotit dhe pasimin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Zuhriu, rahimehull-llah, thotë:

"Prej All-llahut vjen shpallja, Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e kumton, kurse neve na takon dorëzimi".

7- Sahabet, radijall-llahu anhum, imamët e tabiinëve dhe pasuesve të tyre, dijetarët e dalluar të Sunnetit, Selefus-Salihut, ishin në udhëzimin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, rruga e tyre është rruga e besimtarëve, kurse gjurmët e tyre janë sunneti dhe rruga e drejtë.

Evzaiu, rahimehull-llah, thotë:

"Kapu për gjurmët e Selefite edhe nëse të refuzojnë njerëzit, iku mendimeve të njerëzve edhe nëse ti zbukurojnë me fjalë, që kur të sqarohen gjërat të jeshë në rrugën e drejtë".

Burimet e perceptimit tek ithtarët e epshit lthtarët e epshit kanë mënyra të shumta në perceptimin e fesë dhe akides, ata u mbështeten llojloj burimeve dhe metodave, ata si burime të fesë dhe akides kanë bërë:

1- Rregullat logjike dhe mendimet personale, iluzionet dhe paragjykimet, të cilat ajnë prej cytjeve të shejtanit dhe miqve të tyre, pasojnë paragjykimet dhe epshet.

2- Filozofi, e cila ngritet mbi idetë dhe mendimet e ateistëve e idhujtarëve grek, indian, ekzestencialist, etj.

3- Akiden e popujve të mëhershëm dhe burimet e tyre, siç janë librat e Ehli Kitabit, thëniet e tyre, zjarputistëve, feve idhujtare, etj.

4- Trillimi dhe gënjeshtër (sidomos te shiitët, sufitet dhe shumica e frakcioneve), kurse burimi i tyre janë zindikët, kokat e bidatçive, ata gënjen mbi Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, mbi sahabet, tabiinët, prijësit e udhëzimit dhe mbi mbarë njerëzit. Trillojnë hadithe dhe transmetime me senede të shpikura dhe iluzionare.

5- Ëndërat, zbulimet dhe shijet (sidomos te shiitët dhe sufitet), kurse burimi i tyre janë epshet dhe inspirimi i djallit.

6- Argumentet e paqarta (muteshabih), të çuditshme (garib) dhe të rralla, qofshin argumente fetare, të gjuhës ose prej thënieve të njerëzve.

7- Mbështeten në mendimet e njerëzve dhe nuk i krahasojnë me sherijatit ose thojnë se imamët e tyre janë të pagabueshëm dhe të shenjtë.

Metoda e argumentimit te Selefi është e shëndoshë, kurse e atyreve që u kundërvihen është e prishur

Metoda e argumentimit përbëhet prej: bazave dhe rregullave, mënyrës se si mirret feja dhe përcaktohet akideja, nxjerjes së dispozitave nga tekstet e sherijatit dhe rregullave të sherijatit që ngriten mbi to.

Metoda e argumentimit te Ehli Sunneti përbëhet prej ketyre rregullave:

1- Përkufizimi i argumentimit në argumentet fetare (shpalljen).

2- Marrja në konsiderat të rregullave të argumentimit, duke mos i përplasur argumentet e fesë mes tyre, por argumentet e paqarta (muteshabih) i kuptojnë nëpërmjet argumenteve të qarta (muhkem), argumentet e përgjithshme, nëpërmjet argumenteve të sqaruara, i grumbullojnë argumentet e kërcënimit dhe premtimit, argumentet e mohimit dhe konfirmimit, argumentet e përgjithshme dhe të veçanta, e marrin në konsiderat edhe neshun (derogimin) në dispozita, etj.

3- Veprojnë sipas të gjitha argumenteve të shëndosha fetare, duke mos bërë dallim mes atyreve që janë ahad ose mutevatir.

4- E komentojnë Kur'anin me Kur'an, Kur'anin me Sunnet dhe në të kundërtën, mbështeten në domethënien e gjuhës arabe, sepse gjuha arabe është gjuha e Kur'anit dhe Sunnetit dhe i refuzojnë gjërat që u kundërvihen këtyre çështjeve.

5- Mbështeten në tefsirin e sahabeve, kuptimin e tyre të argumenteve, fjalëve, veprave dhe gjurmëve të tyre, sepse ata janë shokët e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, janë më të mirët dhe më të pastërtit e ummetit. Kanë jetuar në kohën e zbritjes së shpalljes, më së miri e njohin gjuhën dhe synimet e sherijatit, e pastaj në gjurmët e Selefit dhe prijësve të udhëzimit, të cilët hapave të tyre kanë ecur.

6- Ajo që u ka arritur nga feja dhe që e kanë mësuar, e kanë zbatuar, gjërat që si kanë patur të qarta ose nuk e kanë ditur formën e tyre, siç janë disa tekstet që flasin për gajbin ose kaderin, u dorëzohen atyreve dhe dijen e tyre ia atribuojnë All-llahut, subhanehu ve teala, dhe nuk debatojnë rreth tyre.

7- U ikin termeve të shpikura në akide, siç

është termi xhevher, ard, xhism, etj, sepse ka mundësi të jenë edhe të sakta edhe të gabuara, sepse u mjaftojnë termet fetare.

8- U ikin polemikave dhe zënkave në fe, ata vetëm në mënyrë të mirë debatojnë.

9- Mhojnë kundërthënien mes logjikës së shëndoshë dhe natyrës dhe teksteve të sherijetit, mes hakikatit dhe sherijetit, mes kaderit dhe sherijetit, kurse ato kundërthënie që i supozojnë epsharakët mes logjikës dhe sherijetit, vijnë nga paftësia dhe mangësia e logjikës së tyre.

10- U ikin tevilin në akide dhe çeshtje të gajbit, pa argument të qartë fetar, sepse është bisedë mbi zotin pa dije, pasi që çeshtjet e akides dhe gajbit janë teukifije, aty nuk ka vend për mendim, logjikë dhe nuk perceptohen me shkenca ekzakte.

11- Kujdesen për senedin, përpikshmërinë e transmetuesve, drejtësinë e tyre, për ta ruajtur fenë.

Kurse metoda e argumentimit te ithtarët e epshit, shpikjeve dhe përçarjes mbështetet në këto rregulla:

1- Mosperkufizimi i argumentimit në argumentet fetare, madje edhe në akide, edhe pse aty duhet argumente të prera, ata marrin argument paragjykimet, iluzionet, filozofitë dhe i emërtojnë "rregulla logjike" (el-aklijat), ashtu sikurse mbështeten në tregime, legjenda dhe transmetime që nuk kanë bazë, siç janë hadithet e trilluara dhe tregimet e shpifura, pastaj në mendimet e njerëzve të fesë, të cilat i emërtojnë si zbulesë (keshf), shije (dheuk) ëndëra, etj.

2- Nuk kujdesen për rregullat e argumentimit, i pasojnë argumente e paqarta (muteshabih) dhe nuk i kuptojnë nga prizma e argumenteve të qarta:

"... ata gjurmojnë atë që nuk është krejt e qartë për të shkaktuar hut, ...". (Ali Imran: 7).

I përplasnin argumentet mes veti, supozoj-

në se ka kundërthënie mes tyre, argumentojnë me argumente të përgjithshme dhe nuk i kuptojnë nga prizma e argumenteve të qarta, nuk bëjnë grumbullimin e argumenteve që përmbajnë kërcënim dhe premtim, as argumentet që përmbajnë mohim dhe konfirmim, e as argumentet që janë të përgjithshme dhe të përveçme.

3- I përcaktojnë vehtes rregulla, të cilat i shpikin sipas epsheve të tyre, u sjellin disa argumente nga Kur'ani dhe Sunneti, mirëpo jo sipas metodës fetare në argumentim, kurse ato argumente që nuk pajtohen me rregullat dhe epshet e tyre i refuzojnë ose ua shtrembërojnë kuptimin.

4- I komentojnë argumentet e sherijetit me epshet e tyre, nuk mbështeten në tefsiret e dijetarëve e as në gjuhën arabe, disa marrin për argument vetëm disa aspekte të gjuhës, të izoluar nga kuptimi i selefit dhe argumentimeve tjera.

5- Nuk mbështeten në komentin e sahabeve dhe Selefus-Salihut, as në kuptimin e tyre të argumenteve, as në gjurmët, vepërën dhe udhëzimin e tyre, madje ikin prej tyre dhe nuk pasojnë rrugën e besimtarëve.

6- Futen në gjërat që i ka ndaluar All-llahu, siç janë argumentet që flasin për Kaderin, cilësitë e All-llahut, gajbin, etj:

"...për të shkaktuar hut, e kinse kërkojnë komentin e tyre. Po, pos All-llahut askush nuk e di domethënien e tyre të saktë....". (Ali Imran: 7).

7- Mbështeten në shprehje të shpikura në cilësitë dhe mbarë akiden.

8- Metoda e tyre ngritet mbi polemika sterile, zënka, dhe debate me të kotë.

9- Supozojnë kundërthënie mes logjikës dhe sherijetit, mes hakikatit dhe sherijetit, mes kaderit dhe sherijetit, mes rregullave të tyre dhe sherijetit, e pastaj i arbitrojnë epshet, rregullat dhe logjikat e tyre të prishura,

e u japin përparësi para sherijatit.

10- Mbështeten në te'vil në akide duke thënë mbi All-llahun pa dije:

"...për të shkaktuar huti, e kinse kërkojnë komentin e tyre. Po, pos All-llahut askush nuk e di domethënien e tyre të saktë...". (Ali Imran: 7).

11- Nuk kujdesen për senedin, sepse mbështeten në epshet dhe mendimet e njerëzve, trillojnë hadithe të pabaza, mbështeten në hadithet e trilluara dhe të dobëta, kurse nga ana tjetër refuzojnë hadithe të vërteta, nëse janë kundërshtim me epshin e tyre.

Selefi, Ehli Sunneti nuk kanë divergjencë në asnjë rregull prej rregullave të fesë

Prej cilësive të Ehli Sunnetit, Selefus-Salihut, është se ata nuk kanë divergjencë mes tyre në ndonjë rregull të fesë ose bazë të besimit, ashtu që fjala e tyre mbi akiden është e njëjtë, falë i qofshim Zotit. Ibën Kutejbe, rahimehull-llah, thotë: "Ehli Sunneti nuk kanë divergjencë mes vehte në asnjë çështje të besimit, përpos mbi problemin e Qelamit (të folurit hyjnor)". Domethënë shprehja e Kur'anit me gjuhët tona a është e krijuar ose jo? Mirëpo edhe kjo divergjencë siç është te Buhariu dhe Ahmedi, është divergjencë sipërfaqësore, pasi që janë unanim në esencën e problemit, se Kur'ani është fjalë e All-llahut, i pa krijuar.

Për dallim nga bidatçitë, ku ata nuk pajtohen me rregullat e Ehli Sunnetit, ashtu sikurse nuk pajtohen as mes vehte, kështu që secili grup i gëzohet mendimit të vet, madje edhe një fracion është i përçarë mes vehte në rregullat e tyre.

Kurse, Ehli Sunneti, elhamdulillah, pajtohen në gjërat e përgjithshme dhe në gjërat detale prej bazave të akides, imamët dhe masa e gjërë e tyre, e nëse ndodh ndonjë kundërshtim të këtyre rregullave prej disa personave, është gabim i cili i refuzohet atij

personi, mirëpo duhet ditur se këto raste janë shumë të rralla, kurse rastet e rralla nuk marrin vendimin e rregullit statik.

Qëndrimi i Ehli Sunnetit mbi cilësit, emrat dhe veprat e All-llahut është një.

Qëndrimi i tyre për fjalën e All-llahut, istivanë, uluvin, është një dhe nuk dallon.

Qëndrimi i tyre ndaj parjes së Zotit, shefakit, e gjërave tjera të gajbit, nuk dallon.

Qëndrimi i tyre ndaj besimit, definicionit të imanit, ruknet e imanit dhe çështjet që kanë të bëjnë me te, është një dhe nuk dallon.

Qëndrimi i tyre mbi kaderin është një.

Rregullat e tyre mbi emrat dhe vendimet është një dhe nuk dallon.

Qëndrimi i tyre mbi sahabet dhe selefus-Salihun është një.

Divergjencë mes Ehli Sunnetit ndodh në ixhtihadet mbi çështjet e vendimeve fikhere, ose çështjet sekondare që ndërliken me akiden, për të cilat nuk ka argumente të prera, edhe ate:

Siç është çështja e fjalës tonë gjatë leximit të Kur'anit, a është i krijuar ose jo, çështja a e ka parë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, Zotin në Miraxh, a ishte parje e zemrës ose syrit? Çështja e parjes së zotit në ëndër? Çështja e Ibën Sejadit, a ishte ai Dexhalli që del në kohën e fundit, ose jo? E disa çështje të ngjajshme me këtë, për të cilat nuk ka ndonjë argument të prerë për te, kurse dijetarët e kanë ndërlihur me çështjen e akides, sepse hyn në llojin e saj shkencarisht dhe tematikisht, e jo akaidologjikisht.

Këto çështje dhe të ngjajshmet me te, nuk janë prej bazave të fesë, andaj divergjencë qarkullon me argumentin, e selefi nuk ka folur vetëm nga mendja e tyre.

Kjo i kthehet pajtimit të selefit në shumë gjëra, prej tyre:

1- Kapja e tyre për litarin e All-llahut.

2- burimi i tyre është një, Kur'ani dhe



Sunneti, për dallim nga epsharakët, sepse te ata burimi dallon: ata flasin sipas mendimit të tyre, mbështeten në logjikë për gjërat që logjika nuk mundet të flet për to, marrja nga filozofët dhe popujt e shkatërruar.

3- Besimi i tyre fillimisht ka të bëjë me dorëzimin Zotit, tebareke ve teala, dhe besimit Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem,, për dallim nga epsharakët, të cilët nuk dorëzohen dhe nuk nënshtrohen, edhe nëse dikush prej tyre e pretendon këtë gjë, sepse nga nënshtrimi është të kapemi për shprehjet fetare.

4- Ata ishin larguar nga ajo që i ka ndaluar All-llahu, nuk janë futur në çeshtjet e gajbit, nuk flasin mbi All-llahun pa dije, nuk polemizojnë, nuk debatojnë dhe nuk i shtrembërojnë kuptimin gjërave (te'vil), për dallim nga epsharakët, të cilët i kanë realizuar të gjitha ndalesat.

5- Ata fenë e kanë marrë me udhëzim, pasim dhe pasim të shembullit me dije, ata fenë e kanë marrë nga njerëzit e drejtë dhe të përpiktë me argument.

Sahabet e kanë marrë nga Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tabiinët nga sahabet, kështu e kanë bartur fenë nga çdo brez njerëzit e drejtë, nga çdo gjeneratë njerëzit besnik dhe në çdo shekull dijetarët.

Për dallim nga bidatçitë dhe epsharakët, sepse metoda e tyre është e llojlojshme në perceptimin e fesë, i kanë përizer mjetet dhe mënyrat, saqë kanë mbetur në udhëkryq.

Divergjencat e sahabeve dhe Selefus-Salihut nuk kanë arritur deri në shkallën e kacafytjes dhe përçarjes

Sahabet, radijall-llahu anhum, kanë patur divergjencia mes tyre pas Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në çeshtjet e rëndësishme, në çeshtjet dhe vendimet e shumta, mirëpo divergjencia e tyre përfundonte, sipas kërkesave të Kur'anit dhe Sunnetit, ose me ixhma, ose veprim me mendimin më të shëndoshë, ose fjalën e fundit e thotë Halifeja,

ose Ehlul-Hal vel-akdi, ose mbetet divergjencia e toleruar, duke patur parasysh të gjitha këto çeshtje divergjencat e tyre nuk kanë arritur deri në kacafytje, përçarje ose largim nga xhemati, e as që i ka bërë zullum njëri tjetrit.

Kanë patur divergjencia mbi vdekjen e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem,, mirëpo këtë divergjencë e ka prerë Ebu Bekri, radijall-llahu anhu, duke thënë:

"Kush ka adhurar Muhammedin, Muhammedi ka vdekur, e ai që ka adhurar All-llahun, Ai është i Gjallë e nuk vdes". Pastaj e lexoi ajetin Kur'anor:

"Muhammedi nuk është tjetër vetëm se i dërguar. Edhe përpara tij pati të dërguar (që vdiqën ose u vranë). E nëse ai vdes ose mbytet, a do të ktheheshit ju prapa (nga feja ose lufta)? E kushdo që kthehet prapa, ai nuk i bën dëm All-llahut aspak, kurse All-llahu do t'i shpërblejë mirënjohësit". (Ali Imran: 144).

Pas kësaj divergjence të gjithë iu nënshtroan vendimit të All-llahut, subhanehu ve teala.

Pastaj ndodhi tregimi i tubimit të muslimanëve në bafçen e fisit Sekif, ku sahabet kishin qëndrime të ndryshme se kush do ta zëvendëson Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në udhëheqjen e muslimanëve, kurse kjo divergjencë u tejkalua dhe unanimisht e pranuan Ebu Bekrin, radijall-llahu anhu.

Kishin divergjencë me rastin e ushtrisë së Usames, ta vazhdojnë atë akcion ose jo? Përfundoi kjo divergjencë me vendoshmërinë e Ebu Bekrin, radijall-llahu anhu, i cili ishte Halife i muslimanëve, për të vazhduar akcionin e vet kjo ushtri.

Gjithashtu kishin divergjencia mbi ata që abstenuan nga dhënia e zekatit dhe renegatët, edhe këtë divergjencë e përfundoi Ebu Bekri, radijall-llahu anhu, me vendoshmëri për ti luftuar, kurse sahabet tjerë që kishin mendime dhe qëndrime të ndryshme, u kthyen në qëndrimin e Ebu Bekrit, radijall-llahu anhu.

Pastaj shumica e sahabeve të Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, nuk morën pjesë në betejën e Siffinit dhe Xhemelit, sepse pasi që ndodhi fitneja pas vrasjes së Othmanit, radijall-llahu anhu, shumica e sahabeve u larguan nga kjo fitne, andaj vetëm një pjesë e vogël e tyre morrën pjesë në këto raste, kurse ata që morrën pjesë kishin bërë ixhtihad, ata nuk e dëshironin luftën, por kishin për qëllim përmirësimin, për dallim nga epsharakët, sebiinët, havarixhët dhe shiitët, sepse ata ishin epsharak dhe fitneç, ata ishin shkak i kësaj lufte dhe i shtynë sahabet në këtë gjë.

Abdullah ibën Imam Ahmedi thotë: më ka treguar Ismail Ibën Alijeh, më ka treguar Ejub Sihtijaniu, nga Muhamed ibën Sirini, i cili ka thënë: Ku erdhi fitneja (trazira) sahabet ishin dhjetë mijë, prej tyre vetëm një qind ishin në atë trazirë, madje as tredhjet persona nuk arrinin".

Kurse Shejhul-Islam Ibën Tejmije thotë: "Ky sened është më i vërteti në ruzullin tokësor".

All-llahu e tuboi fuqinë e muslimanëve pas tërhjekjes së Hasanit, birit të Aliut, radijall-llahu anhum, nga hilafeti në favor të Muaviut, radijall-llahu anhu, në vitin e bashkimit, vitin 41, h. kurse epsharakëve aspak nuk ju pëlqentë ky pajtim.

Pastaj sahabet që bënë ixhtihad dhe morrën pjesë në ato ndodhi janë shumë pak, kurse pretendimi se shumica e sahabeve kanë marrë pjesë është pretendim i rrejshëm, është shpifje e historianëve dhe iluzion i njerëzve.

Tregon Hal-lali në librin e tij "Es-Sunneh" me senedin e njejtë, duke thënë:

Është lexuar para Abdullah ibën Ahmedit, i cili ka thënë: më ka treguar babi im, më ka treguar Ismaili, më ka treguar Ejubi nga Muhamed ibën Sirini, i cili thotë: u trazuan telashet, kurse sahabet ishin dhjetë mijë, kurse prej tyre ishin të pranishëm vetëm një qind, madje nuk kanë arritur as tredhjet njerëz.

Gjithashtu në këtë libër tregohet:

Është lexuar para Abdullah ibën Ahmedit, i cili ka thënë: më ka treguar babi im, më ka treguar Sufjani, më ka treguar Mensur ibën Abdurrahmani, ka thënë Shabiu: në betejën e Xhemelit prej shokëve të Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, kanë qenë vetëm Aliu, Ammari, Talha, Zubejri, e nëse bëhen pesë, atëherë unë jam gënjeshtar".

Ndoshta ka patur për qëllim disa raste të betejës mbi Deven, sepse aty kanë marrë pjesë edhe Hasani, Husjeni dhe Aisheja, radijall-llahu anhu exhmein.

Shejhul-Islam Ibën Tejmije, rahimehull-llah, ka thënë:

"Andaj në kohën e Othmanit nuk është shfaqur ndonjë bidat i dukshëm, mirëpo kur u vra, ndodhën dy bidate:

- bidati i havarixhve, të cilët e anatemosën (tekfir) Aliun dhe

- bidati i rafidive që pretendonin se ai është Imam dhe i pagabueshëm, ose se është pejgamber ose hyjni.

Kurse në fundin e kohës së sahabeve dhe në emirllëkun e Ibën Zubejrit dhe Abdul-Melikut, u shfaq bidati i murxhive dhe kaderive. Në fillimin e shekullit të tabiinëve dhe në fundin e hilafetit të emevive u shfaq bidati i xhehmitëve dhe mushebihëve (antropomorfistat), kurse në kohën e sahabeve nuk gjin-deshte asnjë bidat i këtillë".

Sahabet që mbeten pas shfaqjes së grupacioneve nuk kanë marrë pjesë në asnjë grupacion, në asnjë bidat që nxjer nga Sunneti, por ishin të flaktë kundër epsheve dhe bidateve.

Të këtillë kanë qenë edhe tabiinët, pasuesit e tyre dhe mbarë Selefus-Salihu, All-llahun e falënderojmë për këtë gjë.

Ibën Kajimi, rahimehull-llah, thotë:

"Sahabet, radijall-llahu anhum, kishin divergjenca në shumë çështje që kanë të bëjnë me dispozitat e fikhut, edhe pse ishin zotërinjtë e besimtarëve dhe njerëzit me besim

më të plotë, mirëpo, falë i qofshim All-llahut, ata nuk kishin divergjencë në asnjë çështje prej çështjeve të Emrave dhe Cilësive të All-llahut ose për Veprat e Tij".

Gjithashtu edhe bidati i komentimit të gabuar të Cilësive dhe gjërave tjera metafizike, nuk kanë ndodhur në kohën e sahabeve e as prej tyre, sepse tërë ajo që është në Kur'an dhe Sunnet, tekstet që flasin për Cilësit, sahabet nuk ua kanë shtrembëruar kuptimin ashtu siç kanë vepruar kelamistët. Shejhul-Islam, Ibën Tejmijje, rahimehull-llah, ka përmendur se i ka shfletuar tefsirat e transmetuar nga sahabet dhe hadithet që i kanë transmetuar në më shumë se një qind tefsire, mirëpo nuk ka gjetur nga asnjë sahabë se ka shtrembëruar kuptimin (te'vil) e ndonjë ajeti që flet për Cilësit e All-llahut ose ndonjë hadith që flet për këtë temë, përkundrazi nga ata na kanë ardhur aq shumë tekste që e kundërshtojnë tevilin e mutekeliminëve.

Të gjitha çështjet për të cilat kanë divergjencë sahabet, kanë të bëjnë me ixhtihadin dhe dispozitat fikhore, dhe nuk kanë shkakuar përçarje mes tyre.

Edhe pse frakcionet e para, shiitët dhe havarixhët, e më vonë kaderitë, kanë filluar në epokën e sahabeve, mirëpo ata ishin hasmit e tyre dhe askush prej sahabeve nuk ka qenë i akuzuar për pasim të ndonjë epshi ose bidati, e kush supozon diçka të tillë ai ka shpifur mbi ta.

Në mesin e sahabeve nuk kanë lindur bidatet dhe përçarja, askush prej tyre nuk ka folur ndonjë bidat ose është larguar nga xhemati, askush prej tyre nuk ka qenë ithtar o bidateve të njohura, siç janë havarixhët, rafidit, kaderitë, murxhiitët, etj, e mos të flasim për xhehmitë, mutezilit, mutekeliminët, të cilët kanë ardhur pas tyre.

Gjithashtu sahabet nuk kanë bërë tekfir (anatemosje) njëri tjetrit, por kanë arsyetuar njëri tjetrit në divergjencat e tyre, e kur

ndodhi fitneja, e një pjesë anuan kah Aliu, e tjerët kah Muaviu, radijall-llahu anhum ex-humain, kjo nuk shkaktoi armiësi mes tyre e as që anatemosën njëri tjetrit, madje ata nuk kanë anatemosur kundërshtarët e tyre qofshin prej sahabeve ose të tjerëve.

Metoda e Selefiteve ngritet mbi sunnet dhe pasim kurse metoda e kundërshtarëve të tyre në shpikje

Në kohën e fundit është shfaqur fenomeni i "sharjes së selefiteve", sharjes së njerëzve më të zgjedhur të Ehli Sunnetit, këtij zullumi iu përgjigjen edhe disa grupacione dhe sekte nga të moderuarit, shekullarët, racionalistët, neomutezilët dhe mbeturinat nga frakcionet e vjetra, siç janë havarixhët, shiitët, tariketet sufike, etj.

Me ta janë bërë edhe disa munafik, xhahila (injanantë), njerëz të pasionuar pas publicitetit, epsharak, etj, ata dhe këta nxisin dyshime dhe probleme rreth sahabeve, prijësve të Selefiteve dhe Ehli Sunnetit, hedhin dyshime mbi metodën dhe trashigiminë e tyre, i gjuajnë gabimet dhe rëshqitjet dhe i mashtrajnë injanantët duke u treguar se ato janë bazat dhe metoda e Selefiteve. Përdorin nofka të shëmtuara, përshkrime të poshtëra, që nuk u takojnë Selefiteve dhe pasuesve të tyre as në të kaluarën e as në këtë kohë. Mu ashtu si kanë bërë munafikat me Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe sahabet, duke i përqeshur dhe ngacmuar. Sa për ilustrim po e përmendim vetëm një shembull të asaj që kanë thënë ata: "Këta dijetarët tanë lakmojnë ta mbushin barkun, gënjejnë me gjuhë dhe janë frikacak kur takohen me armikun".

Thanë edhe gjëra tjera, atëherë zbriti All-llahu, az-ze ve xhel-le, ajete të Kur'anit që do të lexohen deri në ditën e gjykimit:

"Ka prej tyre që e ofendojnë Pejgamberin e thonë: "Ai është bërë vesh (beson çka dëgjon)". Thuaj: "Ai është vesh i të mirës suaj (dëgjon të mirën dhe vepron e jo të keqen),

ai beson All-llahun (çka i thotë), u zë besë besimtarëve dhe është mëshirues për ata që besuan nga mesi juaj, e ata që nuk e lënë të qetë të dërguarin e All-llahut, ata kanë dënim të dhembshëm. Ata ju betohen (muslimanëve) në All-llahun për t'ju bërë juve të kënaqur (se s'kanë qëllime të këqija), e më e drejtë është që ata të bëjnë të kënaqur All-llahun dhe të dërguarin e Tij (me adhurim dhe vepra të sinqerta) nëse vërtet janë besimtarë. A nuk e ditën ata se kush kundërshton All-llahun dhe të dërguarin e Tij, atij i është caktuar zjarri i xhehennemit, ku do të jenë përjetë, e ky është ai poshtërimi i madh. Hipokritët kanë dro se do të zbritet ndonjë kaptinë që do të nxjerrë në shesh atë që kanë në zemrat e tyre. Thuaj: "Ani, talluni!" All-llahu do ta zbulojë atë që i frikësoheni. E nëse i pyet ti ata (përse tallen), do të thonë: "Ne vetëm jemi mahnitur e dëfruar". Thuaj: "A me All-llahun, librin dhe të dërguarin e Tij talleni?" Mos kërkoni fare ndjesë, ju pasi që (shpallët se) besuat, keni mohuar. Nëse një grupi nga ju i falim, grupin tjetër e dënojmë, ngase ishin kriminelë". (Et-Teube: 61- 66).

Edhe këta munafik bashkëkohor ecin metodës së të parëve të tyre, hap pas hapi, ata, edhe të vjetrit edhe këta modernë, kur i shajnë burrat e mirë prej besimtarëve dhe i ngacmojnë, mund të kapen për disa gjëra që kanë ndodhur prej tyre, qofshin dyshime, rëshqitje, dhe i shfrytëzojnë këto raste për tua përzier njerëzve.

Ka ndodhur që disa besimtarë të devotshëm të gënjejnë, të gabojnë, të rëshqasin, të kenë epsh, të bëjnë zullum, ose ti kalojnë normat, kurse munafikët i përhapin këto dhe ia mveshin mbarë besimtarëve. Kështu veprojnë disa bashkëkohor, të cilet i gjuajnë gabimet e disa ithtarëve të Ehli Sunnetit dhe Selefus-Salihut, gjëra të cilat nuk janë bazë të ata, e nëse ndalesh dhe mendon ma thellë e

kupton se ato gjëra janë bazë e epsharakëve, përcarësve dhe bidatçive, sepse metoda e Selefrit, elhamdulillah, nuk përputhet me te.

Mu për këtë e pashë të arsyeshme të bëjmë një krahasim mes metodës së Selefrit dhe metodave të ithtarëve të epshit, nga e cila do të bëhet e qartë se baza te metoda e selefrit është haku dhe e sakta, kurse gabimet dhe kundërshtimet janë rëshqitje që nuk llogariten si pjesë e metodës, poashtu edhe e kundërta: baza e metodës së epsharakëve është: shpikja, devijimi dhe e kota, kurse e sakta, haku dhe sunneti janë përjashtime.

Gjatë këtij krahasimi do të jem konciz dhe do të mjaftohem me rregullat e përgjithshme dhe metodën, duke mos hyrë në detaje, edhe pse duhet ditur se disa çeshtje që do të përmendën në këtë krahasim janë përmendur edhe në këtë shkrim edhe në vende tjera.

Një: Kuptuam se bazat e Selefrit, Ehli Sunnetit mbështeten në burimet e shëndosha të perceptimit, e ato janë Kur'ani dhe Sunneti, në metodën e shëndoshë të argumentimit, sikur përmendëm më herët.

- Kurse ithtarët e bidatit dhe epsheve metoda e tyre e perceptimit dhe argumentimit dallon tërësisht nga kjo, këtë e sqarojmë me këtë që vijon:

a) Epsharakët nuk mjaftohen me mbështetjen në Kur'an dhe Sunnet, madje disa prej tyre edhe nuk mbështeten shumë në to, por mbështeten në burime tjera, secili sipas shijes së vet, pastaj i refuzojnë argumentet që u kundërvihen rregullave të tyre të shpikura, kurse Selef, Ehli Sunneti, rregullat e tyre kanë bazë në Kur'an dhe Sunnet, andaj ata u dorëzohen argumenteve të verifikuara dhe nuk mbështeten në gjëra tjera përpos shpalljes.

b) Shumica e epsharakëve kanë botëkuptim të gabuar mbi pejgamberllëkun, poashtu edhe mbi shpalljen dhe Fjalën e All-llahut, shumica e tyre kanë iluzione se shpallja është

të rezultat njerëzor ose buron nga krijesa, jo se është Fjalë e All-llahut ose shpallje që i është dhënë pejgamberëve të Tij.

c) Shumë epsharak dhe bidatçi supozojnë se argumentet fetare nuk mjaftojnë për të gjitha çështjet e fesë, kurse Selefë besojnë prerazi se feja është e plotë dhe i plotëson të gjitha nevojat e njeriut në dynja dhe në fe.

d) Prej cilësive të epsharakëve është lëria e sunnetit dhe gjurmëve nëse nuk pajtohen me epshin e tyre, duke pretenduar se u mjafton Kur'ani, kurse Ehli Sunneti mbështeten në Kur'an, Sunnet dhe gjurmët e vërteta, andaj janë Ehli Sunnet në të vërtetë. Epsharakët nuk ngurrojnë të akuzojnë hadithet ahad edhe nëse kanë sened të vërtetë, në këtë mënyrë ata i refuzojnë shumë çështje të fesë, kurse Ehli Sunneti ata i pranojnë të gjitha hadithet e vërteta të Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, edhe nëse janë ahad.

e) Epsharakët pretendojnë se argumentet që flasin për cilësitë e All-llahut dhe mbi gajbin janë të paqarta (muteshabih), pasi që shumica e tyre mendojnë se metodat dhe rregullat e tyre logjike janë të qarta (muhkem), andaj argumentet fetare që vijnë ndesh me ato rregulla janë të paqarta (muteshabih). Për këta ka thënë All-llahu, subhanehu ve teal: "...E ata, që në zemrat e tyre kanë anim kah e shtrembëta, ata gjurmojnë atë që nuk është krejt e qartë për të shkaktuar hutë, e kinse kërkojnë komentin e tyre. Po, pos All-llahut askush nuk e di domethënien e tyre të saktë. Dijetarët e pajisur me dituri thonë: "Ne u kemi besuar atij (atyre që janë të paqarta), të gjitha janë nga Zoti ynë"! Por këtë e kuptojnë vetëm ata që janë të zotët e mendjes". (Ali Imran: 7).

Ehli Sunneti besojnë se të gjitha argumentet që flasin për cilësitë e All-llahut, për akiden dhe gajbin janë të qarta plotësisht (muhkem) dhe se janë të vërteta ashtu siç

ka dashur All-llahu, kurse paqartësia është te kuptimi i njerëzve, logjika e tyre e mangët dhe futja në forma të cilat nuk i di askush përveç All-llahut, subhanehu ve teal.

f) Shumë epsharak pretendojnë se argumentet fetare janë paragjykimet kurse logjika dhe iluzionet e tyre janë të prera, andaj shumica e tyre i përdorin krahasimet logjike për cilësitë e All-llahut, kaderin, gajbin dhe të gjitha rregullat e akides, kurse Selefë besojnë se argumentet janë të prera, edhe nëse fshehet mënyra e argumentimit ose sqarimi i tyre për disa mendje, e kjo ka të bëjë me mangësinë e mendjes së tyre.

g) Shumica e epsharakëve dhe bidatçive mbështeten në te'vil (shtrembërim i kuptimit), ta'til (mohim i cilësive) dhe mexhaz (alegori) kur flasin për cilësitë e All-llahut dhe në të gjitha çështjet e akides, kurse Selefë i ndalon te'vilin dhe mexhazin kur flasin për cilësitë e All-llahut dhe akiden, sepse është thënie mbi All-llahun pa dije dhe nënshtrim ndaj iluzioneve dhe paragjykimëve.

h) Shumica e epsharakëve në shumicën e çështjeve mbështeten në gënjeshtër, trillim dhe gjëra që kanë bazë në fe, kurse Selefë mbështeten vetëm në argumente të vërteta, i refuzojnë hadithet e rrejshme dhe të trilluara.

i) Shumica e epsharakëve dhe bidatçive i madhërojnë mënyrat e filozofëve në qendrimet e tyre ndaj fesë, gjatë gjykimit mbi gajbin, kurse mënyra e filozofëve ngritet mbi trajtimin e pejgamberëve injorantë, refuzimin e të vërtetës që kanë sjellur ata, mbi supozime, iluzione dhe ëndërimet. All-llahu për këta dhe të ngjajshmit me ta ka thënë:

"Mallkuar qofshin gënjeshtarët! Ata të cilët janë gafilë në injorancë (në verbëri, në padituri)". (Edh-Dharijat: 10- 11).

j) Andaj ata mbështeten në rregulla të prishura gjatë marrjes së akides, ata mund të përmendin ndonjë argument fetar, mirëpo si

përforcim e jo për tu mbështetur në te, kurse Selefi e marrin fenë me argumente fetare dhe rregulla të sherijatit, i sjellin argumentet fetare të vërteta për tu mbështet në to e jo për përforcim, ata mund të sjellin ndonjë argument të dobët për përforcim e jo për argumentim me te.

k) Epsharakët dhe bidatçitë i gjenë mangësi fesë, metoda e tyre në marrjen e fesë e jep këtë domethënie, të gjitha te'vilet, rregullat logjike dhe shpikjet që i bëjnë japin kuptimin se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, nuk e ka sqaruar të vërtetën, andaj ata kanë nevojë për këto gjëra, kurse Ehli Sunneti, selefus-Salihi, besojnë se:

"Çdo shpikje është bidat dhe çdo bidat është devijim".

l) Epsharakët dhe bidatçitë e kanë metodë të argumentimit që argumentin mos ta vëndojnë në vendin e vet, kurse prej metodës së Ehli Sunneti në argumentim është që secilit argument ti gjindet vendi, sipas rregullave të shëndosha shkencore.

m) Shumë epsharak dhe bidatçi e publikojnë urrejtjen e argumenteve që flasin për cilësitë e All-llahut dhe tevhidin, i akuzojnë senedet deh transmetuesit edhe nëse janë imamë, e akuzojnë edhe tekstin e haditheve, duke mos përdorur asnjë rregull fetar, andaj ata rregullat e tyre të kota i quajnë bazat e fesë dhe tevhifit, për dallim nga shkolla e Selefite, e cila ngritet mbi parimin e dorëzimit, pëlqimit dhe bindjes.

n) Prej rregullave të epsharakëve në argumentim është: krahasimi i atij që mungon me atë që është i pranishëm, pasi që i krahasojnë cilësitë e All-llahut dhe gjërat që janë gajb me krijesat dhe gjërat e prekshme. Kurse akideja dhe metoda e Selefite është e pastër nga këto iluzione dhe krahasime që vinë ndesh me besimin në gajb.

o) Prej rregullave të tyre është edhe moskujdesi për transmetimet dhe senedet, ata janë injorant në këtë drejtim dhe mbi vlerën

e kësaj metode origjinale shkencore për ta ruajtur fenë, kurse Selefi janë zanatçitë kryesor të kësaj shkence, me të cilën All-llahu e ka ruajtur Sunnetin.

p) Prej cilësive të epsharakëve disa herë është edhe mosnjohja e gjuhës, ose injorimi i saj dhe mos marja në konsideratë përpos në raste kur i shërben bidatit të tyre, kurse Ehli Sunneti i japin rëndësi gjuhës, mbështeten në te në komentin e argumenteve, sipas metodës fetarë të shëndoshë.

Dy: Prej rregullave të Ehli Sunnetit është realizimi i tevhidit, ruajtja e pastërtisë së tij dhe metoda e shëndoshë në konfirmimin e tij. Kurse prej rregullave të epsharakëve dhe bidatçive është devijimi në kuptimin e tevhidit dhe konfirmimin e tij:

a) Realiteti i tevhidit te ata përfundon me ta'tilin, domethënë mohimin e emrave, cilësive, dhe veprave të All-llahut, ose disave prej tyre.

b) Definicioni i tevhidit te epsharakët përfundon me konfirmimin e rububijetit, e aspak nuk kujdesen për tevhidul-ibade, që është qëllimi i dërgimit të pejgamberëve.

c) Gjatë marrjes së tevhidit ata binë në gjëra që i ka ndaluar All-llahu, siç janë iluzionet, supozimet, futja në argumentet jo të qarta, polemikat sterile, debati për gjëra që skanë dije, futje në çeshtjet e gajbit, thënie mbi All-llahun pa dije, etj.

d) Gjithashtu ata kanë metoda dhe kuptime të ndryshme për konfirmimin e tevhidit dhe kuptimin e tij.

Tre: Rregullat e Ehli Sunnetit ngriten mbi dije dhe rregulla të fesë të marrura nga shpallja e pagabueshme, Kur'ani dhe hadithi i vërtetë, kurse rregullat e epsharakëve, bidatçive dhe përçarësve, mbështeten në injorancë mbi argumentet e fesë dhe bazave të saja:

a) Mosnjohja e asaj në të cilën aludon Kur'ani, Sunneti dhe gjurmët e Selefite dhe mosthellimi në dije.

b) Injoranca e tyre mund të rezultojnë: edukatë të keqe me All-llahun dhe futje në emrat dhe cilësitë e Tij pa dije.

c) Trajtimi i Selefëve si injorantë, duke pretenduar se mënyra e tyre (halefit) është më e ditur dhe më e përpiktë se mënyra e selefëve.

d) Përkufizimi i të vërtetës të ata dhe injorimi i Ehli Sunnetit, Selefëve-Salihut, nuk ua dinë vlerën dhe peshën.

e) Prej injorancës së tyre është edhe fakti se ata ia mvëshin selefëve shumë fjalë që vinë ndesh me medhhebin e Selefëve, siç është puna e tefvidit, te'vilit, irxhaja, xhebri, tekfiri, nesbi, etj.

Katër: Metoda e Ehli Sunnetit ngritet mbi hakun e qartë, metodë fetare e qartë, rrugë e drejtë e marrë nga shpallja e pagabueshme, kurse metodat e epsharakëve, ngriten mbi përzjerje.

a) Pretendimi i tyre se ata janë ithtarët e hakut, tevhidit, drejtësisë, përqëndrimit dhe sunnetit.

b) Nga përzjerja dhe injoranca e tyre është edhe shndërimi i sunnetit në bidat e i bidateve në sunnet.

c) Nga përzjerja e tyre është edhe përzjerja e bidateve me vepra të ligjshme fetarisht.

d) Nga përzjerja e tyre është edhe përmbysja e fakteve dhe loja me fjalë.

e) Nga përzjerja e epsharakëve është përdorimi i shprehjeve të përgjithshme dhe që kanë më shumë kuptime, për ti ikur ballafaqimit me argumentet, sepse në këtë mënyrë ata më mirë e përhapin medhhebin e tyre.

f) Prej përzjerjeve të tyre është edhe akuzat se medhhebi i selefëve në konfirmimin e cilësive të All-llahut paraqet teshbih (përgjajësim me krijesat), përshkrimi i Selefëve si tekfiri, sharës, xhebrije, nasibi, e llojlloj nofkash dhe përshkrimes të poshtëra.

Pesë: Metoda e Selefëve ka konsensus, përpikshmëri, stabilitet dhe bindje, kurse e epsharakëve ka kundërtënie, luhatshmëri,

ndryshim dhe mëdyshje.

a) Kundërtënia e epsharakëve dhe përzjerjeve në të gjitha rregullat, metodat, çeshtjet dhe argumentimet, prej kundërtënieve të tyre është përzjerja mes suneteve dhe bidateve, bashkimi mes gjërave të kundërta në akide, etj. Për dallim nga Ehli Sunneti, Selefëve-Salihut, të cilët kanë kompaktësi dhe unitet në rregullat dhe metodën. Andaj në realitet te epsharakët nuk ka gjëra të prera dhe bindje.

b) Rregullat dhe bazat ku mbështeten, nuk janë unanim rreth tyre.

c) Prej cilësive të tyre është edhe kalimi nga një medhheb në tjetrin, ndryshimi i mendimeve dhe mosqëndrimi në një mendim.

d) Ata shumë herë binë në mëdyshje, dyshim, dhe shqetsim gjatë deklarimit të traktave të tyre të prishura.

e) Kundërtënia dhe çregullimi në qendrimet e tyre ndaj fesë dhe Selefëve.

f) Publikimi i fiaskos nga shumica e tyre në akide dhe pranimin e kësaj gjëje në fundin e jetës.

g) Devijimit dhe deformimet te epsharakët janë të llojeve të ndryshme, andaj secili për secilin thot se ska asgjë, mirëpo bashkohen në armiqësi kundër Sunnetit, kurse selefëve dhe metoda e tyre janë të pastër nga ky çregullim, sepse janë në rrugën e All-llahut të drejtë.

Gjashtë: Prej cilësive të Ehli Sunnetit është lojaliteti dhe dashuria ndaj besimtarëve dhe të devotshmive, madhërimi i sahabeve, dijetarëve dhe imamëve të fesë, kurse epsharakët i urrejnë Ehli Sunnetin, e shajnë Selefëve dhe i përqeshin ata:

a) Akuzimi i disa sahabeve të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ngacmimi i Selefëve (ithtarëve të hadithit dhe sunnetit), qortimi, sharja dhe urrejtja e tyre. Ata Ehli Sunnetin e quajnë hanbeli, vehabi, etj.

b) Qëndrimi i ftohur ndaj hadithit dhe dijetarëve të hadithit.

c) Gëneshtra dhe mveshja e fjalëve imame dhe dijetarëve.

Shtatë: Shumica e epsharakëve kanë qëndrime armiqësore me kundërshtarët:

a) Qëndrimi i tyre ndaj kundërshtarëve zakonisht mer forma të mburrjes dhe mendjemadhësisë, nënçmimi i mendimit të kundërshtarit, vet kundërshtarit, dhe ngushtimi i tij, padrejtësisht dhe armiqësisht. Andaj shumica e tyre e mohojnë sunnetin dhe ua ngushtojnë jetën ithtarëve të sunnetit.

b) Shpikin bidate dhe i anatemosin ata që i refuzojnë, ose disa prej tyre nuk bëjnë dallime mes sunnetit dhe bidatit, e as mes besimit dhe kufrit. Kurse Ehli Sunneti, elhamdulillah, janë të matur, modest, kanë dhimb-suri dhe mëshirë, ata nuk i anatemosin kundërshtarët vetëm pse u kundërshtohen, përpos se me argument.

Tetë: Disa rregulla dhe baza të ithtarëve të epshit dhe përçarjes:

a) Dalja kundër kryetarëve të muslimanëve dhe xhematit të tyre, lejimi i përodimit të shpatës mbi muslimanët, kjo është metodë dominante te ata dhe prej cilësive globale te ata. Ata nuk shohin se duhet respektuar sulltanin, nuk e marin porosinë e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, për durim përballë zullumit, padrejtësisë dhe egozimit të kryetarit musliman, andaj disa nga selefi të gjithë epsharakët i emërtonin havarixh.

b) Insistim në bidatet e tyre, ata nuk udhëzohen në hak dhe sunnet dhe nuk u jepet sukses në pendim, për shkak të insistimit në bidate. All-llahu e di më së miri. Ata janë, për të cilët All-llahu ka thënë:

"Thuaj: "A t'ju tregojmë për më të dëshpëruarit në veprat e tyre?" Ata janë veprimi i të cilëve u asgjësua në jetën e kësaj bote, e megjithatë ata mendojnë se janë kah bëjnë mirë". (El-Kehf: 103- 104).

c) Bisedat e shumta për gjëra që nuk u

interesojnë, që skanë të bëjnë me ta, sidomos çeshtjet e fesë dhe akides. Futja e formave apologjetike në shkrimet e tyre, shtimi i librave, shkrimeve dhe replikave, andaj librat, veprat dhe shkrimet e tyre nuk kanë beqet dhe jan pak të dobishme.

d) Kujdesen që të përhapin bidatin, ndikojnë fuqishëm në ata që rrinë me ta, andaj ata zakonisht e mashtrojnë masën e gjërë, mendjelehtët, interesxhitë, të pasionuarit pas publicitetit, këto grupe u përgjigjen shumë shpejtë gjatë trazirave dhe kur të mbetet sunneti jabanxhinjë.

e) Shtirje se janë dijetar dhe mburrje. Ata pretendojnë se janë më të ditur se dijetarët e thelluar në dije, ose së paku sa ata, se meritojnë të japin vlerësime, dispozita dhe të mirren me ixhtihad, edhe pse kanë pak dije, nuk i njohin argumentet, rregullat e argumentimit, bazat e ixhtihadit, madje shumica e tyre në realitet ka injorancë në katror. Nga mburrja dhe mashtrimi i tyre është fakti se ata mendojnë se janë duke e ndihmuar islamin me metodat e tyre të devijuara dhe shkrimet e tyre të shpikura.

f) Rënia ose në ekstremizëm ose në liberalizëm. Të gjithë epsharakët kanë dalur nga metoda e mesme, disa prej tyre cilësohen me ekstremizëm dhe fanatizëm, siç janë havarixhët, shiitët dhe disa mutezilit, kurse të tjerët me liberalizëm, siç janë murxhiitët, xhehmitët, kurse të tretët kanë bashkuar ekstremizmin me liberalizmin, siç janë sufitet dhe shumica e mutezilitëve.

g) Disa grupe të tyre i dominojnë shejtanat dhe xhinët.

h) Guximi para All-llahut, Pejgamberit, fesë dhe robërve të devotshëm. Kjo na tregon se bazat e tyre janë të shpikura, ata nuk i kanë shembull prijësit e udhëzimit dhe imamët e dalluar, andaj kanë rënë në përvehtësimin e rregullave të prishura.



i) I kja nga xihadi dhe urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja, disa për xihadin thonë se është dhunë dhe ashpërsi, kurse ndalimi nga e keqja se është pengim dhe kufizim i lirive.

j) I shkruajnë gjërat pozitive të tyre dhe i publikojnë, kurse i fshehin gjërat negative të tyre dhe i injorjnë.

k) Spitulohen, thellohen, pasojnë gjërat e rënda dhe pa rugëdalje, gjëra për të cilat nuk ka sjellur All-llahu argument.

l) Besimi në gjërat që ua iluzionon mendja, pasi që bazat dhe besimet e tyre burojnë nga iluzionet, ëndërimet dhe supozimet, ata janë në metodën për të cilët ka thënë All-llahu:

"Mallkuar qofshin gënjeshtarët! Ata të cilët janë gafilë në injorancë (në verbëri, në padituri)". (Edh-Dharijat: 10- 11).

m) I tërhjek logjika dhe filozofia, dhe ua zbukuron shejtani, kurse mbështetja në këto gjëra rezulton pretendimin se akideja e sele-

fit është e palogjikshme dhe krijon kundërtënie mes sherijetit dhe logjikës.

n) E kundërshtojnë sherijatin, shkalëzohen në metodën e të kotës dhe janë të nënçmuar dhe të poshtëruar.

o) Ai që analizon gjendjen e bidatçive do të vëren se ummeti nuk ka marrë qëndrim unanim për asnjë dijetar të tyre së është Imam i udhëzimit, mirëpo ata ia mveshin disa imamëve disa fjalë të tyre ose tentojni ti përvehtësojnë disa imamë.

p) Janë ndjellakeq për ummetin, kontribuojnë në dështimet e ummetit, përçarjen, dobësinë dhe fuqizimin e armikut të ummetit.

Rezyme: metoda e Ehli Sunnetit, Selefus-Salihut ngritet mbi Sunnet, bashkim dhe pasim, ashtu siç ka urdhëruar All-llahu, az-ze ve xhel-le, dhe Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, kurse metoda e ithtarëve të epshit ngritet mbi bidate, frakcionarizëm, shpikje dhe mospasim i rrugës së besimtarëve.

(Material i përpunuar mbështetur në një shkrim të dr. Nasir Abdul-Kerim el-Akl)

Përgaditi: Bekir Halimi

17.9.2004

## Gjërat që bëjnë dobi në kohë të fitneve

Falënderimi takon vetëm All-llahut, paqja dhe mëshira qofshin mbi të Dërguarin e All-llahut, mbi familjën dhe shokët e tij...

Prej obligimeve primare që i ka besimtari, që është i kujdesshëm për fenë e tij dhe që bren-goset për vetën, atëherë kur të ndodhin sprovat dhe kur të ndezet flaka e sprovave është t'i përmbahet ligjit të All-llahut dhe t'u përmbahet bazave të sheri'atit që qartësoi feja jonë:

1. Dija e mirëfilltë që mbështetet në njohjen e dispozitave të fesë Islame. Dijetari që e njih mirë natyrën e çrregullimit dhe e njeh

dispozitën e All-llahut do të shpëton vetën dhe tjerët në kohë që i injoranti do të thellohet me tepër në të dhe nuk do të shpëton nga ajo. Njeriu nuk mundet të bëhet i ditur nëse nuk e merr diturinë të trashëguar prej të Dërguarit, sal-lallahu alejhi ve sel-leme.

2. Kërkimi i strehimit dhe mbrojtjes tek All-llahu, subhanehu ve te'ala, nga pasojat e fitneve dhe lutja e sinqertë dhe pandërprerë që All-llahu të mos na sprovon. O Zot mos i lajthit zemrat tona pasi që i ke udhëzuar, na mëshiro, Ti me të vërtetë je Dhurues i madh.

Në sunnetin e të Dërguarit, sal-lallahu alejhi ve sel-leme, janë përmendur lutjet gjatë frikës dhe brengës:

Nuk ka Zotë të vërtetë përpos All-llahut, Zoti i qiye dhe tokës, Zoti i fronit (arshit) madhështor

Lutja e Junusit: Nuk ka Zot të vërtetë përpos Teje, je larg çdo mangësie, unë me të vërtetë jam prej të padrejtëve.

Duhet të mundohet që lutjet t'i bën në kohërat e bekuara kur All-llahu i prenon lutjet, pjesa e fundit të natës, në fund të namazeve të obliguar, gjatë sexhdes, gjatë iftarit, mes ezanit dhe ikametit, kur të bjen shi...

3. Njeriu gjatë fitnes obligohet me maturi, butësi dhe mosnxitim. Duhet të përdorë logjikën dhe të mos shpejton në ndërmarrjen e hapeve dhe qëndrimeve. Të jetë i kujdesshëm nga veprimet e papërgjegjshme që me siguri do të rezultojnë me dëm dhe pasoja të papritura. Butësia zbukuron çdo gjë në kohë që ashpërsia shëmton çdo gjë. I Dërguari i All-llahut, sal-lallahu alejhi ve sel-leme, Eshexh ibën Kajsini e ka lavdëruar për dy cilësi, për butësin dhe mosnxitim.

4. Të mundohet të shpëton veten nga situatat që mundën ta shpiejnë drejtë çrregullimeve ndonëse edhe me vetizolim. I Dërguari i All-llahut, sal-lallahu alejhi ve sel-leme, ka thënë: "Ai që largohet prej gjërave të dyshimta e ka siguruar besimin dhe nderin e tij..." dhe ka thënë: "Do të ndodhin çrregullime, ai që është në gjumë është më i mirë se ai që është i zgjuar, ai që është i zgjuar është më i mirë se ai që është në këmbë, ai që është në këmbë është më i mirë se ai që vrapon. Ai që gjen strehim ose

mbrojtës dhe të strehohet tek ai." (Buhari)

"Kur të ndodhin fitnet ai që ka deve le t'ju bashkangjitet deveve, ai që ka bagëti le t'ju bashkangjitet bagëtive, kush ka tokë le t'i përkushtohet tokës. Një i pranishëm pyeti: Nëse ndonjëri nuk ka asgjë prej këtyre si të vepron? Tha: Le të qëllon me tehun e shpatës ndonjë gurrë pastaj le ta shpëton vetën nëse ka mundësi ta shpëton. O Zot a e kumtova që e përsëriti dy herë..." (Muslim)

5. Të konsultohet me dijetaret e thelluar në çështjet e fesë dhe të dalluarit me devotshmëri duke u larguar prej injorantët ose atyre që kanë dije gjysmake, të rinj të emocionuar dhe mendjelehtë. Tek dijetarët e mëdhenj të dalluar me logjikë, devotshmëri dhe urtësi ai do të gjen përgjigjen e saktë për çështjet e mëdha, për musibetet dhe gjërat e reja që paraqiten.

6. Të ruan unitetin e bashkësisë që është nën udhëheqësinë e drejtë të dijetarëve dhe sundimtarëve besnik duke e mbrojtur nga përçarja në fjalë dhe vepra. Është porosi hyjnore që të gjithë të kapemi fortë për litarin e All-llahut dhe të mos përçahemi dhe të jemi një popull që e ka vetëm një Zot.

I Dërguari i All-llahut, sal-lallahu alejhi ve sel-leme, thotë: "Dora e All-llahut është mbi xhematin (bashkësinë) ai që ndahet do të përfundon në zjarr"

"Ujku e ha delen që largohet prej kopesë"

Në fund All-llahun e lusim të na e ruan fenë, të na mbron nga sprovat ne çështjet e fesë, të na jep siguri në këtë botë dhe në ahiret. Tek Ai mbështetemi dhe kërkojmë strehim dhe vetëm Ai na mjafton. All-llahu i takon dija e plotë.

Prof. Dr. Ali ibën Abdul Aziz Esh Shibl,  
24.9.2004

## Rregulla të arta për hifz të Kuranit

1- nijjeti i pastër-ihlasi

Për hifz (mësimin e Kuranit përmendësh) është i nevojshëm edhe nijjeti i sinqertë dhe i pastër. Hifzi dhe kujdesi rreth Kuranit duhet të jenë vetëm në emër të Allahut të Lartësuar, përfitimt të kënaqësisë së Tij, Xhennetit të Tij dhe shpërblimit të pakufishëm të përgaditur për atë që Kuranin e lexon dhe e mëson përmendësh. Allahu i Lartësuar thotë: "...andaj ti adhuroje All-llahun duke qenë i sinqertë në adhurimin e Tij! Vini re! Adhurim i sinqertë është vetëm ai për All-llahun!" (Zumer 2-3).

Në hadithin të cilin e transmeton Muslimi, Pejgamberi, salAllahu alejhi ve sel-lem, thotë: Allahu i Lartësuar thotë: Unë jam pjesëmarrësi më i pavarur në bashkëpjesëmarrje, andaj vepra e të cilit bëhet për Mua dhe për dikë tjetër, Unë do t'a lë atij tjetrit". Kjo do të thotë se nuk ka shpërblim ai i cili nga për syfaqësi apo famë e mëson Kuranin. Andaj nuk ka dyshim se është mëkatar i madh ai i cili Kuranin e ka mjet të përfitimt të kësaj bote dhe dobisë së saj.

2- shqiptimi i drejtë i harfeve gjatë leximit

Pas nijjetit të sinqertë, hapi i parë në rrugën e hifzit të Kuranit është shqiptimi i drejtë i harfeve, gjë e cila mund të arrihet vetëm me ndëgjimin e lexuesit të përkryer ose hafizit të dalluar, ngase leximi i Kuranit gojë më gojë është mënyra e vetme e saktë. Pejgamberi, salAllahu alejhi ve sel-lem, i cili është arabi me të folur më të bukur, ashtu sikurse transmeton Buhariu Kuranin gojarisht e ka mësuar nga Xhibrili, alejhi selam, e pastaj ia lexonte Xhibrilit, alejhi selam, një herë në vit, ndërsa në vitin kur Pejgamberi, salAllahu alejhi ve sel-lem, u shpërngul në ahiret, Xhibrili, alejhi selam e ka ndëgjuar dy herë. Në të njëjtën mënyrë drejtëpërsëdrejti dhe gojarisht, Pejgamberi, salAllahu alejhi ve sel-lem, i ka mësuar sa-

habet, sahabet nxënësit e tyre tabi'inët, e kështu me rradhë nga gjenerata në gjeneratë. Kështu sot ky bëhet obligim ynë, që Kuranin t'a mësojmë nga lexuesi i përkryer, me përmirësim në kohë të duhur të çdo gabimi dhe pa mbështetje të plotë vetëm në përpjekjet vetanake. Kjo vërejtje vlen edhe për ata të cilët janë njohës të mirë të gjuhës arabe dhe rregullave të saj, ngase rregullat kuranore në shumë ajete janë të kundërta me rregullat e pranuar të gramatikës arabe.

3- çdo ditë të mësohen numër i caktuar ajetesh

Një faktor shumë i rëndësishëm që ndikon në hifz është që për çdo ditë, aq sa mundet të mësohet një numër i caktuar ajetesh, për shembull, një ose dy faqe, një e teta e xhuzit etj. Pas përcaktimit të numrit të ajeteve për hifz, menjëherë duhet adoptuar në shqiptimin e drejtë dhe përsëritjen e pandërprerë. Përsëritja është më efikase nëse bëhet me zë melodik, ngase në këtë mënyrë praktikohet sunneti dhe forcohet hifzi. Ndëgjimi mësohet në melodi, melodia e përforcon mbamendjen, e adopton gjuhën në ritmin e caktuar, i cili nëse e prish harmoninë, e vëren edhe gabimin më të vogël gjatë leximit. Me lexim melodik të Kuranit pasohet edhe shembulli i Pejgamberit, salAllahu alejhi ve sel-lem, i cili thotë: "Nuk na takon neve ai i cili Kuranin nuk e lexon me zë melodik".

4- mos mëso diç të re derisa të mos e përkryesh hifzin e ajeteve të cilat i ke mësuar sot

Është e palejueshme që hafizi t'i mësoj ajetet e reja para se t'i mos i përkryej në tërësi atë që e mësuar, ngase vetëm në këtë mënyrë hifzi mund të forcohet dhe stabilizohet. Kjo arrihet shumë lehtë me leximin në namazet e ditës, ose, kur bëhet fjalë për imamë, në namazet e natës, pastaj në nafilet, gjatë pritjes për namaz dhe pas dhënies së selamit. Në këtë mënyrë të hifzit

adoptohet shumë lehtë, që çdokujt pa dallim i mundësohet t'a mësoj Kuranin përmendësh, ngase nga njëra anë, kjo metodë e të mësuarit të Kuranit nuk kërkon kohë shtesë, ndërsa nga ana tjetër me falje të rregullt të namazeve ajetet do të mësohen mirë para se të vij nata. Nëse puna e hafizit e pamundëson që t'a forcoj atë që e ka mësuar sot, të nesërmen nuk do të mësoj diç të re, por do të përsëris atë që e ka mësuar përderisa të mos e përkryej.

5- gjithmonë lexo nga Mus-hafi i njëjtë

Ndihmës i mirë në hifzin e Kuranit është praktika e hafizëve që për hifz kanë Mus-haf të posaçëm të cilin nuk e ndërrojnë asnjëherë, ngase dihet se njeriu mban në mend edhe atë që sheh sikurse që mban në mend atë që ndëgjon. Më përsëritje të pandërprerë të rradhitjes së ajeteve dhe rradhitja e tyre në fletë, me shikim në Mus-haf ato thellësisht nguliten në mendje. Ndërimi i Mus-hafeve dhe të mësuarit përmendësh të botimeve të ndryshme ku rradhitja e secilës fletë nuk është identike, e vështirëson mbamendjen dhe shkakton përzerje dhe ngatërrësë në hifz, prandaj është e domosdoshme që asnjëherë të mos ndërrohet Mus-hafi nga i cili mësohet hifzi.

6- të kuptuarit e Kuranit e lehtëson hifzin

Ndihmësi më i madh në hifz është të kuptuarit e ajeteve dhe të depërtuarit në kuptimin, gjë e cila ajetet i ndërlidh në tërësinë tematike. Për këtë arsye hafizi është i shtyrë në leximin e tefsirit të ajeteve të cilat i mëson përmendësh. Përveç kësaj, lexuesi duhet të jetë me mendje i pranishëm në lexim, në mënyrë që atë që e ka mësuar t'a përsëris më lehtë. Mirëpo edhe përkundër kësaj nuk duhet tërësisht mbështetur në kuptimin e ajeteve, ngase bazë e të gjithave është përsëritja mekanike e asaj çfarë është mësuar, që gjuha sa më mirë të mësohet në ritmin e leximit qoftë edhe nëse mendja nuk e përcjell vet leximin. Në të kundërtën, mbështetja ekskluzive vetëm në të kuptuarit e ajeteve do të thotë të harruarit e shpejtë e asaj që është mësuar

përmendësh dhe belbëzimi sapo që mendja të mos jetë e pranishme, gjë që rregullisht ndodh gjatë leximit të gjatë.

7- mos mëso sure të re përderisa të vjetrën të mos e mësosh mirë prej fillimit gjer në fund

Kur të mësosh një sure përmendësh, është gabim që hafizi të filloj menjëherë me mësimin e një sureje të re, para se të mësohet në tërësi dhe të jetë i aftë që rrjedhshëm të lexoj suren nga fillimi deri në fund, e të mos ndiej kurrfarë vështirësie në gjuhë e as mundim të mendjes gjatë përkujtimit të rradhitjes së ajeteve. Hifzi duhet të jetë sikurse uji, i rrjedhshëm dhe i lehtë në atë masë sa që pa kurrfarë belbëzimi të thuhet (lexohet) një sure e tërë, qoftë edhe nëse në vetëdije nuk përcillet kuptimi i ajeteve, sikurse që e dijme Fatihanë përmendësh, në pikë të ditës apo në mes të natës, gjë që është fryt i një përsëritjeje dhe leximit të pandërprerë. Duhet përmendur se rrallë ndonjë sure mund të mësohet përmendësh rrjedhshëm sikurse Fatiha, mirëpo shkalla e tillë e hifzit duhet të jetë qëllim i vazhdueshëm, derisa çdo sure të mos mësohet mirë, e kjo mund të arrihet vetëm atëherë kur secila sure ndaras të mësohet mirë.

8- ndëgjimi i vazhdueshëm i asaj që është mësuar

Është e paparamendueshme që gjatë hifzit, hafizi të mbështetet vetëm në vete, që do të thotë se dikush tjetër duhet t'a ndëgjoj, qoftë përmendësh ose duke shikuar në Mus-haf, ani se është praktikë që kjo të bëhet para një hafizi të mirë e të fortë i cili hifzin mund t'a ruaj të pastër e pa gabime. Njeriu shpesh ajetin e mëson gabimisht, gjë që nuk e vëren qoftë edhe nëse shikon në Mus-haf, ngase shikimi vonohet pas gjuhës e gabimi nuk vërehet. Për këtë arsye ndëgjimi është mënyrë që të përmirësohen gabimet dhe Kurani të mësohet drejtë.

9- leximi i rregullt

Leximi i Kuranit përmendësh dallohet nga të mbajturit në mend të çdo gjëje tjetër, sikur ajo e

poezisë dhe prozës, ngase Kurani harrohet shumë shpejt. Në hadithin të cilin e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi, Pejgamberi, salAllahu alejhi ve sel-lem, thotë: “Pasha Allahun i cili e posedon shpirtin tim, Kurani harrohet më shpejt sesa deveja që ik prej lidhëses së vet”. Nëse hafizi shkurt e neglizhon atë që e ka mësuar, do t’a harroj Kurantin, ngase me Kuran jetohet, ndaj asaj që është mësuar vazhdimisht duhet vigjëllyar përmes përsëritjes së pandërprerë, sikurse e ka treguar në mënyrë figurative Pejgamberi, salAllahu alejhi ve sel-lem:” Hafizi i Kuranit është sikurse bari i deveve: nëse vigjëlon mbi to, do ti ruaj, nëse i lë pas dore do t’i ikin”. Edhe hadithi tjetër thekson të njëjtën gjë: “Lexoni pandërprerë Kurantin, ngase pasha Allahun në dorën e të cilit është shpirti im, Kurani humbet më shpejtë (nga mendja) sesa që devet ikin nga lidhëset e veta” (Buhariu dhe Muslimi). Kjo do të thotë se hafizi duhet të ketë virdin e tij ditor, për çdo ditë numër të caktuar të sahifeve, përkatësisht që gjatë ditë duhet të lexoj së paku një xhuz, a maksimalisht dhjetë xhuza, në çka na paralajmëron Pejgamberi, salAllahu alejhi ve sel-lem: Kurantin nuk mund t’a kuptoj ai i cili e lexon për më pak se tri ditë”. Leximi rregullt dhe kujdesi i pandërprerë për hifzin ndihmon që ajo që është mësuar të zgjat më shumë, ngase çdo mospërfillje shkakton dobësim të hifzit dhe harrim.

10- duhet pasur kujdes të posaçëm në ajetet e ngjashme

Ajetet kuranore janë shumë të ngjashme në kuptim, shprehje dhe kontekst. Këtë e thekson edhe ajeti 23 i sures Zumer: “All-llahu e shpalli të folmën më të mirë, librin, të ngjashëm në mrekulli, të përsëritur herë pas herë (me këshilla e dispozita), që prej (dëgjimit të) tij rrënoqethen lëkurat dhe zemrat e tyre...” (Zumer, 23). Nëse Kurani i përmban gjashtë mijë ajete,

atëherë bile dy mijë janë të ngjashme në diçka. Kjo ngjashmëri nganjëherë është aq e madhe sa që nganjëherë disa ajete dallojnë vetëm një harf, një, dy ose më tepër fjalë. Për këtë arsye hafizi patjetër duhet të ketë kujdes të posaçëm në ajetet e ngjashme në mes vete. Fuqia e hifzit do të jetë në përpjestim me kujdesin e kushtuar ajeteve të cilat i përngjajnë njëri tjetrit. Nuk është e tepërt që të lexohen me kujdes librat të cilat i dedikohen këtij lloji të ajeteve.

11- të shfrytëzohen vitet e arta për mësimin e hifzit

Me të vërtetë e ka mëshiruar Allahu atë i cili i shfrytëzon vitet e arta për mësimin e hifzit, do të thotë përafërsisht nga pesë deri në njëzet e tri vjet. Memoria njerëzore në këtë periudhë është shumë e fortë, andaj këto janë vitet e arta për mbajtjen në mend. Para moshës pesë vjeçare njeriu mban pak në mend, ndërsa mbas moshës njëzet e tri vjeçare fuqia e mbamendjes dobësohet, që zëvendësohet me të kuptuarit më të thellë. Për këtë arsye vitet e arta për mësimin përmendësh duhet të shfrytëzohen më tepër për mbamendjen e Kuranit. Në këtë periudhë njeriu shmë shpejt mban në mend e ngadalë harron, në dallim prej viteve të pjekurisë kur mbahet në mend më vështirë e më ngadalë e shumë shpejt harrohet. Sa bukur tregon thënia: “Mbamendja në rini është sikurse gdhendja në guri, e mbamendja në pleqëri sikurse të shkruarit në ujë”. Ky rregull është e rëndësishë së posaçme, andaj duhet t’a zbatoj secili prej nesh në vete, e nëse është vonë që t’a zbatoj në vete, duhet ta’a zbatoj në djemtë dhe vajzat e veta.

I mbështetemi Allahut dhe vetëm nga Ai ndihmë kërkojmë. Ndërsa paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi Pejgamberin tonë, Muhammedin salAllahu alejhi ve sel-lem, familjes së tij të pastër dhe shokët e tij fisnik.

Përkthyer nga: Ebu Eljesa  
Abdurrahman Abdulhalik,  
1.10.2004

**Zinaja- tradhti bashkëshortore dhe kurvëri**

Lavdërimet i takojnë Allahut të vetëm, salatet dhe salavatet i takojnë Muhamedit, salallahu alejhi ve selem, pas të cilit nuk ka më tjetër pejgamber.

Tradhtia bashkëshortore dhe kurvëria shkaktojnë çoroditje dhe fatkeqësi të madhe e cila mund të shpërmdahet lehtë. Pasojat e dëmshme të cilat rezultojnë nga ato shkaktojnë dëm të madh jo vetëm atyre të cilët i kryejnë ato, por edhe umetit musliman në tërësi. Për shkak të faktit që këto mëkate janë të përhapura dhe ngase ekzistojnë shumë rrugë të cilët shpiejnë deri tek to, duhet njohur pasojat e dëmshme dhe dëmin e madh që rezultojnë nga këto mëkate. Tradhtia bashkëshortore dhe kurvëria shpie në:

Kombinimin të gjitha karakteristikat të liga, e dobëson imanin, asgjëson devotshmërinë dhe aftësinë mbrojtëse, prish moralin (virtutet morale) dhe zhduk ndershmërinë.

Zhdukjen e turpit dhe në paraqitjen e kryesve të saj si njerëz të paturpshëm.

Nxirjen dhe ngrysjen e fytyrës për çdonjëri që e shikon në të.

Nxirjen e zemrës dhe humbjen e dritës së saj.

Vuajtjen nga varfëria e vazhdueshme të kryesit të kurvërisë. Allahu në një Hadith Kudsij ka thënë: “Do t’i shkatërroj tiranët dhe do t’i sprovtoj me varfëri kurvarët (zinaqarët).”

Atë që kryesi të bëhet i parëndësishëm para Allahut dhe bënë që të humb respektin dhe vlerën para njerëzve.

Privimin e kryesit nga përshkrimi i të qenurit të moralshëm dhe i pastër dhe zëvendësimi i saj me përshkrimin e të qenurit kurvar (shkelës

i kurorës), mëkatar dhe mashtrues.

Shkaktimin e ndjenjës së vetmisë të cilën Allahu e rrënjos në zemrën e kryesit dhe që reflektohet në fytyrën e tij, gjersa njerëzit e ndershëm kanë fytyra të hareshme, zemra të lumtura, dhe çdonjëri që qëndron me ta kënaqet, gjë që është krejt e kundërt me gjendjen e kurvarëve.

Sjelljen me dyshim dhe mosbesim të njerëzve ndaj kurvarëve.

Atë që gjërat zakonisht të shkojnë (ecin, rrjedhin) kundër asaj çka shpresojnë kurvarët andaj edhe rrjedhimisht ata bëhen të brengosur. Ai i cili kërkon kënaqësi në mosbindje ndaj Allahut do të dënohet duke e arritur të kundërtën e asaj çfarë ka shpresuar. E mira mund të realizohet vetëm përmes bindjes ndaj Allahut, pasi që Allahu mosbindjen ndaj Tij nuk e ka bërë rrugë e cila çon kah e mira. Nëse kurvarët do të dinin kënaqësinë që rrjedh nga të mbeturit i pastër (i ndershëm), ata do të vërenin (kuptonin) se atë çka e kanë lënë anash ëshë shumë e vlefshme se kënaqësia që e patën në kryerjen e mëkatit.

Humbjen e mundësisë që kurvarët të kënaqen me huritë (vashat) e xhenetit.

Ndërprerjen e lidhjeve me prindërit dhe familjen e kryesit, fitim të parave të pista, në shtypjen e njerëzve dhe në humbjen e familjes së tij. Ky mëkat zakonisht ndodh pas kryerjes së mëkateve tjera që shpiejnë deri te ky mëkat, dhe gjithashtu shkakton që të ndodhin mëkate tjera.

Shkatërrimin e dinjitetit të femrës, turpërimin e vajzës dhe familjes së saj.

Ç'nderimin (turpërimin), i cili rezulton nga ky veprim është më i rëndë dhe më i gjatë sesa të veprimeve të njëjta të cilat i kryejnë pabesimtarët, sepse pasi që pabesimtari të pendohet singërisht nga mosbesimi i tij dhe të përqafton Islamin, zhduket turpërimi dhe ai person është i pastruar. Kjo nuk vlen për kurvarët muslimanë të cilët pastrohen pas pendimit, mirëpo konsiderohet të kenë shkallë më të ulët se ata muslimanë të cilët gjithmonë kanë qenë të pastër e të ndershëm. Nëse ndokush e hedh një vështrim të singertë përreth shoqërisë së tij, sigurisht se do të vërej që ato femra të cilat kanë bërë kurvëri, e kuptojnë se e kanë shumë vështirë të gjejnë bashkëshortë i cili është i gatshëm t'i martoj ato.

Atë që nëse femra kryen kurvëri dhe më vonë aborton, atëherë ajo i ka bërë dy mëkate të mëdha. Nëse është e martuar edhe gënjën duke pohuar që fëmija është i burrit të saj, si dhe nëse në shtëpinë e saj e sjell një person të huaj, ... si dhe kryerjen e shumë mëkateve tjera në mënyrë të pavetëdijshme.

Lindjen e fëmijut i cili do të jetë i privuar nga prindërit dhe lidhjet familjare dhe të cilët do t'a udhëzonin dhe mësonin. Për më tepër, ky fëmijë gjatë tërë jetës së tij do të jeton me ndjenjën e të qenurit i degraduar dhe më pak i vlefshëm brenda bashkësisë.

Prishjen e nderit të femrave të cilat më parë ishin të pastërta gjë që mund të shpie në mosmartesën e tyre.

Nxitjen e armiqësisë dhe e zjarrit të hakmarrjes të familjes së femrës, për shkak të turpësimit të cilën e ndien familja e femrës si rezultat i këtij mëkati. Për më tepër, xhelozia është ndjenjë normale e çdo njeriu normal. Sad ibën Ubadeh ka thënë: "Nëse e shoh ndonjë njeri me gruan time unë do t'a godas me shpatën time", ndërsa kur Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem e ndëgjoi këtë thënie, ai ka thënë: "A po çuditeni me xhelozinë

e Sadit? Betohem në Allahun se unë jam më xheloz se ai, ndërsa Allahu është më xheloz se unë, dhe xhelozia e Allahut është në mëkatet e liga të kryera hapur dhe fshehurazi" (Buhariu dhe Muslimi).

Atë që femrat e familjeve të kurvarit më lehtë të bien në mëkatin e njëjtë sa po të zbulohet veprimi i tij, nëse edukimi i tyre (femrave) nuk është në pajtim me parimet islame. Në anën tjetër nëse dikush përmbahet nga kurvëria dhe nuk e pranon atë për vete dhe për të tjerët do të fitoj respekt për shkak të saj dhe kjo atij i mundëson të mbaj dëlirësinë shtëpiake.

Fitimin e shumë sëmundjeve fizike të cilat mund të jenë të pakontrolluara dhe bile mund të shkaktojnë edhe vdekjen, siq është Sida, urdhja dhe sëmundje të tjera ngjithëse seksuale.

Shkatërrimin e umetit islam e cila rrjedh nga hidhërimi i Allahut ndaj njerëzve, në tërësi. Ibën Mesudi ka thënë: "Sa herë që në ndonjë vendbanim përhapet kurvëria, Allahu e urdhëron shkatërrimin e tij." Ç'ka tregon se kurvëria është aq mëkat i madh, që në fakt Allahu ka përcaktuar dënim të posaqëm për ata të cilët e kryejnë atë. Imam Ibën Kajjim, ka thënë: "Allahu dënimet për kurvëri e ka bërë të posaqëm në tri mënyra: e para është dënim me vdekje (kurdo qoftë e zbatueshme), i cili zbatohet në mënyrën më të ashpër të mundshme, e dyta është që Ai robërve të Tij ua ka ndaluar të jenë të mëshirshëm ndaj atyre të cilët kryejnë kurvëri përdërisa t'i dënojnë ata, e treta është që Allahu ka urdhëruar që dënimi i tyre të bëhet në prani të besimtarëve dhe të mos fshihet. Prapa kësaj është një urtësi e madhe, për shkak se vepron si frenues për të tjerët nga kryerja e shkeljes së kurorës ose kurvërisë".

Vlen të përmendet që njerëzit dallohen në lidhje me këtë mëkat, nëse ndokush e kryen këtë me shumë njerëz dallon nga ai që e kryen me një partner, dikush që e kryen atë dhe e fsheh

atë nuk është i njëjtë me atë që e kryen atë hap-tazi, kryerja e kurvërisë me person të martuar është më e madhe se me person beqar, ngase kjo përfshin shkëljen e të drejtave të tjetërkujt dhe shkatërrimin e jetës së tyre bashkëshortore.

Për më tepër, kryerja e kurvërisë me gruan e fqit është më e rëndë se me ndonjë tjetër, sepse ai që e bënë këtë e cenon fqinjësinë e tyre dhe e then urdhërin e Allahut dhe të Dërguarit të Tij salAllahu alejhi ue selem që t'i mos t'i prish ato. Gjithashtu, kryerja e me gruan e një personi i cili ka shkuar në xhihad është më e keqe se me ndonjë grua tjetër.

Përderisa pesha e mëkatit ndryshon varësisht nga gruan me të cilën fle, gjithashtu dallon edhe varësisht nga koha dhe vendi e kryerjes së tij. Nëse dikush bënë kurvëri gjatë muajit të Ramazanit është më i keq se sa nëse dikush e bënë atë jashtë këtij muaji, dhe nëse dikush e bënë atë në vend të shenjtë është më i keq se dikush që e kryen jashtë atij vendi. Kurvëria e bërë nga një plak është më e keqe se nëse e atë kryen ndonjë i ri, dijetari i cili bënë kurvëri është më i keq se personi i zakonshëm dhe ndërsa sa i përket kurvërisë njerëzit e pasur të cilët kanë mundësi të martohen janë më të këqinjë se ata të cilët nuk kanë mundësi të martohen.

Si të pendohemi nga kurvëria

Pasi kemi zbuluar seriozitetin e kurvërisë dhe pasojat e rënda e shkatërruese të këtij mëkati ndaj individëve dhe bashkësive, duhet treguar që është i obligueshëm pendimi i sinqertë për cilindo që e ka kryer atë apo i ka ndihmuar të tjerët t'a bëjnë atë, prandaj personi i tillë duhet të pendohet për atë që ka bërë dhe asnjëherë të mos kthehet në kurvëri. Personi që kryen kurvëri nuk duhet që veten t'a lajmëroj në pushtet dhe t'i rrëfej për krimin, për të mjafton që sinqerisht t'i pendohet Allahut dhe t'a fsheh mëkatin e tij.

Nëse ai posedon fotografi, apo kaseta të dikujt me të cilin ka pasur marrëdhënie të palejuar seksuale, ai duhet t'i shkatërroj ato dhe nëse ai ia jep ato ndokujt, ai duhet t'i rikthej ato dhe t'i shkatërroj.

Femra e cila kryen kurvëri nuk duhet të ndalet nga të penduarit nëse dikush e ka inçizuar këtë mëkat, ajo duhet të nxitoj të pendohet dhe të mos përmbahet nga pendimi për shkak të kërcënimit (shantazhi), sepse Allahu mjafton si Mbrojtës.

Ajo duhet të dij se personi që e kërcënon është frikacak dhe se do të shfaqet nëse i shpërndan ato inçizime. E cila është më e lehtë, të qenurit i ekzpozuar para njerëzve në këtë periudhë të shkurtë në këtë jetë me një pendim i cili i shlyen të gjitha mëkatet, apo në Ahiret, të qenurit i ekspozuar para të gjitha krijesave, e pastaj shkuarja në Zjarr si vendbanim?

Këshillohet që përmes ndonjë mahremi (burrit apo ndonjë mashkulli tjetër, me të cilin nuk të drejtë martese) nga ndonjë njeri i ditur të kërkoj ndonjë zgjidhje nga kjo telashe.

Njerëzit duhet të pendohen për kurvërinë dhe t'i ndërpresin të gjitha lidhjet të cilat mund t'iu përkujtojnë në këtë mëkat, ata duhet t'i nënshtrohen para Allahut ndoshta Allahu ua pranon pendimin e ua fal, dhe mëkatin për veprën e bërë t'ua zëvendëson me shpërblim.

Allahu thotë: "Edhe ata që pos All-llahut, nuk lusin zot tjetër dhe nuk mbysin njeriun që ka ndaluar All-llahu, por vetëm kur e meriton në bazë të drejtësisë, dhe që nuk bëjnë kurvëri, ndërsa kush i punon këto, ai gjen ndëshkimin, Atij i dyfishohet dënimi ditën e Kijametit dhe aty mbetet i përbuzur përgjithmonë, Përveç atij që është penduar dhe ka bërë vepër të mirë, të tillëve All-llahu të këqiat ua shëndreron në të mira. All-llahu është Mëshirues, ndaj Ai falë shumë." (Furkan 68-70)

Përgaditur nga: Muhamed Ibrahim El-Hamad

24.9.2004



## Fakte për statusin social të femrës perëndimore

Në këtë kohë kur gratë perëndimore mendojnë se i udhëheqin çështjet e veta, a don të thotë kjo se ata e kanë arritur pikën e barazisë gjinore? A i ka tejkaluar “femra e sodit” shtypjet dhe maltretimet e “ditëve të këqija, të kaluara”? A është “çlirimi” i gruas një sinjal për një botë me moral më të mirë? Kjo liri a i ka dhënë emancipim real femrës dhe a e ka larguar nga padrejtësia? A e kemi parë përfundimin e shtypjes, keqtrajtimit, prostitucionit, përdhunimit, shkurorëzimit dhe familjeve me një prind (si rezultat i shkurorëzimit)? Përgjigja, sipas feministeve do të duhej të jetë një “PO” këmbëngulëse, mirpo mjerisht përgjigja është një “JO” e zymtë.

Zakonet e vjetra që i kanë praktikuar romakët e vjetër, persianët, arabët (në kohën e injorancës) janë të gjalla dhe të pranishme, mirpo me një maskë të re. Në këtë kohë moderne, në vend që ti varosin vajzat e gjalla, ata i abortojnë në mitër dhe trupat e tyre të pajetë i hudhin si mbeturina. Aborti është vrasje, mirpo asnjëherë ska qenë rëndë të pranohet arsyeja “se femra ka të drejtë të zgjedhë” në një rast vrasjeje siç është kjo! Ata që i bëjnë abortet po gjejnë mënyra të reja për ti mbytur fëmijët e padëshiruar.

Metoda më e re, e cila e ka emrin “aborti me lindje të pjesërishme” që përfshin nxjerjen parciais të fetusit nga mitra; ku koka i ngel në mitër, dhe ai që i bën abortet (i cili se meriton titullin “doktor”) i’a then eshtrat e kokës së fetusit me instrument të fortë, dhe i’a nxjerë trurin jasht. Pas kësaj pjesët e mbetura të fëmijës së mbytur nxiren

jasht. Kjo procedurë e tmershme përdoret që të mund t’i tejkalojnë ligjet e SH.B.A. të cilët thonë se çdo fëmijë i lindur i gjallë i ka të drejtat njerëzore, dhe mbytja e tij do të shikohet si vrasje nga ana e gjyqjeve. Çfar mendjeje të sëmurë dhe të prishur mund t’i kujtohej diçka e tillë? Pse fëmiu i gjallë në mitër ka më pak të drejta se ai që është i lindur?

Gratë me fëmijë lëshohen ende, si në shekujt e kaluar. Ky fenomen tash njihet si “familje me një prind”. Në vend që, si atëherë, të shkojnë në treg e ta gjejnë një grue, burat e sodit mjaftohen me prostitucion, bile edhe me përdhunim. Në kohët e kaluara, burat i kanë mbytur femrat prej të cilave nuk kanë pasur më dobi, kurse ditëve të sodit femrat konsumojnë drogë dhe alkool, dhe në fund bëjnë vetvrasje. Mënyra e vjetër Spartane që gratë të ngelin shtatëzëne nga bura të fuqishëm, tash është zëvendësuar me pllenimin artificial në “bankat e spermës”, të cilat e kryejnë të njëjtin rol mirëpo me maskën e civilizimit dhe shkencës, “zotat” e kohës moderne. Dhe krejt kjo konsiderohet si përparim.

Barazia e femrës me mashkullin në Perëndim është vetëm një ëndër. Për sa kohë bota do ta injoroj mjerimin dhe katastrofën drejt të cilës krejt janë nisur? Mënyra e vetme për të siguruar një të ardhme të sigurtë dhe të drejtë, është duke i praktikuar mësimet e Islamit. Muslimanët kanë përgjegjësi të madhe që ta përhapin këtë mesazh deri te të gjithë popujt e botës.

Sipas feministëve, shekulli 21 ka pas përparim më të madh në drejtim të barazisë

gjinore. Sidomos, periudha pas luftës së dytë botërore shihet si një kohë e artë. Mirëpo gjatë kësaj periudhe, të gjitha krimet e llojeve të ndryshme kundër gruas kanë shënuar rritje për më shumë se 25% (këto janë të dhëna zyrtare, e ne aspak nuk kemi dyshim se realiteti është shumë më i hidhur në botën e tyre të “civilizuar”).

#### Aborti

Në Britani, numri i aborteve të regjistruara është rritur dhjetëfish prej kur u bë “legalizimi” i aborteve në vitin 1968. Atë vitë kishte 22 000 aborte të regjistruara, kurse në vitin 1991 numri u rrit në 180 000. Prej atëherë, numri i aborteve që bëhen çdo vit është duke u rritur me një shpejtësi të madhe. Prej 180 000 aborteve që u bën në vitin 1991, 110 000 aborte janë bërë nga femra të pamartuara. Prej tyre vetëm 1% janë bërë për shkaqe medicinale. Në vitin 1993, në Angli dhe Uells u regjistruan 819 000 aborte. Rezultatet e një studimi treguan se 1/3 e marëdhënieve jashtëmartësore përfunduan me abort në vitin 1993. Më shumë se 3000 aborte u bën nga vajza të moshës nën 15 vjeç, ndërsa më shumë se 31 000 aborte u bën nga vajza të moshës nën 19 vjeç.

Statistikat për SH.B.A.-të janë edhe më të tmershme. Atje çdo vit numri i aborteve është në rritje e sipër, saqë deri në vitin 1994 numri i aborteve “legale, të regjistruara” ishte 1 milion. Instituti Alan Guttmacher, një organizatë për studime që është filijalë e Planned Parenthood, vlerëson se numri i aborteve totale që bëhen brenda një viti është 10 – 20% më i madh se ai i statistikave zyrtare.

Në Kanada numri i aborteve është sa gjysma e numrit të aborteve në Sh.B.A. Sidoqoftë, për vitin 1992, kjo d.t.th. se 25% e shtatëzënive kanë përfunduar me abort.

Në Japoni, në “shtetin më të zhvilluar

industrialisht”, ku koha është para ndërsa paraja është lëndë esenciale e jetës, numri i aborteve është dyfish më i madh se në SH.B.A. Në këtë vend numri i aborteve brenda një viti është 2 milion (kuptohet, sipas të dhënave zyrtare).

Gjaku i pafajshëm i fëmijëve më së shumti është derdhur në ish Bashkimin Sovjetik. Bashkimi Sovjetik ka përjetuar 12.8 milion aborte në vitin 1965, kurse numri i tërë popullatës ka qenë 233 milion!! Ndërsa në kohën e sodit, 3/4 e shtatëzënive në këtë vend përfundojnë me abort.

I’a vlenë të miret pak kohë për të folur për këto numra. Ne nuk duhet të harojmë se këto numra janë shumë më shumë se një statistikë e thjeshtë. Çdo numër paraqet vrasjen e një fëmije të pafajshëm dhe të pambrojtur nga njerëzit e “civilizuar”.

“Liria e zgjedhjes” nën maskën e Civilizimit Botëror, ka lejuar vrasjen e më se 1 miliard fëmijëve gjatë 25 vjetëve të fundit.

Në të kaluarën “barbare”, vajzat e posalindura janë mbytur për shkaqe ekonomike. Kurse sot fëmijët vriten që të zhiduken argumentet e tradhtisë, zinasë dhe amoralitetit. Këto numra janë vetëm për abortet e regjistruara, kurse sa i përket aborteve “ilegale” dhe atyre që janë bërë në klinika private, vetëm All-llahu, subhanehu ve teala, e din saktë numrin e tyre.

#### Dhunimi

Nuk është lehtë të gjindet numri i saktë i dhunimeve. Shumë prej tyre nuk raportohen, andaj mund të themi se numri real i dhunimeve është shumë më i madh se numri oficial.

Sipas policisë Britaneze, në vitin 1984 ka pasur 20 000 incidente dhe përafërsisht 1500 raste përdhunimi. Qendra Për Dhunime në Londër vlerëson se numri i dhunimeve është 5000 – 6000 brenda një viti; e numri real padyshim se është shumë

më i madh. Prej vitit 1984, numri i sulmeve seksuale është rritur më shumë se numri i të gjitha krimeve tjera.

Deri në vitin 1994, numri i dhunimeve të regjistruara është rritur në 32 000. E sa për sot, përafërsisht në çdo orë ndodhë nga një dhunim. Me fjalë tjera, përdërisa ti je duke e lexuar këtë, dikush do të bëhet viktimë e dhunimit në Angli.

SH.B.A., vend ku ka më së shumti "liri të të drejtave njerëzore", është vendi numër një sa i përket numrit të dhunimeve që bëhen. Këtu numri është 4 herë më i madh se në Gjermani, 18 herë më i madh se në Angli dhe 20 herë më i madh se në Japoni. Në vitin 1995 në Jutë, 2071 fëmijës të moshës nën 18 vjeçare dhe 633 fëmijë të moshës nën 6 vjeçare janë dhunuar.

Në SH.B.A. për çdo minutë ndodhin 78 dhunime, gjegjësisht 1872 dhunime për çdo ditë apo 683 280 dhunime për çdo vjet.

Duke i shikuar këto numra, një pyetje na shkon ndër mend: Kush është duke i vepruar këto akte barbare kundër femrave? Realiteti është shokues dhe shqetësues: Mbi 75% të femrave të dhunuara kanë pasur kontakt më herët me dhunuesin, e kjo d.t.th. se ato dhunohen nga njerëz që i njohin dhe u besojnë. 16% e tyre dhunohen nga shokët e tyre të ngushtë.

Një studim i bërë nga Këshilli Nacional Për Liritë Qytetare tregon 38% e meshkujve e përdorin fuqinë dhe pozitën e tyre në punë për ti dhunuar koleget e veta. Sipas një statistike 88% e femrave të anketuara kanë pasur sulm seksual në vendin e punës. Në Britani 86% e menaxhereve dhe 66% e punëtoveve kanë përjetuar kësi probleme.

Në Britani, bile edhe femrat që punojnë në shërbimin policorë janë viktimë e sulmeve seksuale. Shembujt e këtyre incidenteve përfshijnë edhe spiunimin e tyre gjatë larjes,

si dhe sulmimin e tyre në dhomat e veshjes.

Dhunimi ka një efekt shkatëruës emocional, mental dhe psikik në viktimat dhe familjet e tyre. Sa që në SH.B.A. 1.3 milion e viktimave kanë probleme dhe çrregullime psikike.

### **Martesa dhe Shkurorzimi**

Në pjesën e fundit të shekullit 20 është shënuar një rritje e kohabitimit, d.t.th. e çifteve të pamartuara që "jetojnë bashkë". Diku gjysma e femrave që kanë lindur në vitet 1960-ta kanë thënë se kanë kohabituar ndonjëherë.

Ky veprim bëhet "që të arrihet një martesë e suksesshme", mirëpo ndodh e kundërta, me rritjen e rasteve të kohabitimit është rritur edhe numri i shkurorzimeve. Tani Britania e ka shkallën më të lartë të shkurorzimeve në Bashkimin Europian. Në vitin 1983 kishte mbi 147 000 shkurorzime. Deri në vitin 1994 ky numër është rritur në 165 000.

Në SH.B.A. shkalla e shkurorzimeve është rritur prej 708 000 në vitin 1970 në 1 175 000 në vitin 1990. Tabelat e numrit të shkurorzimeve nuk mund t'i paraqesin dhimbjet e atyre prindërve që janë shkurorzuar, apo të fëmijëve të tyre, bota e të cilëve është përmbysur.

Numri i martesave në Britani është zvogluar nga 389 000 në vitin 1983 në 341 000 në vitin 1994. Prej këtyre martesave, përafërsisht 1/3 përfundojnë me divorc, ndërsa shkaku kryesor i divorcit është tradhtia.

Divorci tash është shkaku kryesor i vetvrasjeve në SH.B.A.

Njerëzit e shkurorzuar 3 herë më shumë ka gjasa të bëjnë vetvrasje në krahasim më njerëzit e martuar.

Sa më shumë që njerëzit largohen nga udhëzimi i Krijuesit të tyre aq më shumë u shtohen vuajtjet.

### **Prindërit e vetëm**

Ka edhe një statistik depresive që është

duke u rritur nga implementimi i "çlirimit të gruas". Në vitet e fundit numri i lindjeve nga nënat e pamartuara është rritur nga 90 000 në vitin 1982 në 215 000 në vitin 1992. Nga të gjitha bebët e lindura në vitin 1992, 31% e tyre janë lindur nga nëna të pamartuara. Prej tyre diku 2500 femra kanë lindur duke qenë nën moshën 15 vjeçare, kurse 23 000 kanë qenë nën moshën 20 vjeçare.

Aq sa numri i lindjeve ilegale është rritur, po aq numri i lindjeve nga çiftet e martuara është zvogëluar nga 890 000 në vitin 1961 në 511 000 në vitin 1994. Realiteti pas kësaj është se shumica e femrave largohen nga përgjegjësia e rritjes së fëmijëve.

30% e fëmijëve në Britani përkujdesen vetëm nga njëri prind.

Shkatërrimi i familjeve dhe moskujdesi për gratë Perëndimore ka rezultuar që numri i nënave që kujdesen vet për fëmijët e tyre në SH.B.A. të jetë 10 milion në vitin 1994. Shtëpia normale me babë, nënë dhe fëmijë është një iluzion në botën Perëndimore.

Prej këtyre fëmijëve për të cilët kujdeset vetëm njëri prind 20% e tyre kanë probleme arsimore, emocionale dhe morale. 63% e vetrasjeve bëhen nga fëmijë që rrjedhin nga këto familje.

Kjo ngarkesë mbi gruan për tu përkujdesur vet për fëmijët e saj është një ndër format më brutale të diskriminimit.

#### **Shëndeti**

Sipas studimeve, vetëm 43% e nënave që kujdesen vet për fëmijët e tyre e kanë përkujdesur shëndetin e tyre si të "mirë" dhe përafërsisht 39% kanë raportuar sëmundje kronike.

Gruaja gjithashtu ka shëndet psikik më të dobët se sa meshkujt. Ata i vizitojnë doktorët familjar dhe psikiatrat shumë më shpeshë, dhe janë konsumuese më të mëdhaja të barnave kundër ankthit dhe depresionit.

Femrat janë ato që ndjehen më keq dhe më të pakënaqura se meshkujt për shkak të punës që e bëjnë dhe për shkak të kushteve që i kanë në punë.

Nëse do ta pyetje një njeri të thjeshtë në rrugë se kush vuan më shumë nga sëmundjet psikike, do të thonte: femrat. Sidoqoftë, kështu nuk ka qenë çdoherë. Studimet nga viti 1850 e deri në Luftën e Dytë botërore tregojnë se meshkujt kanë qenë ata që kanë vuajtur më shumë nga sëmundjet psikike. Kurse sa i përket femrave, ata e kanë marrë udhëheqjen në lidhje me sëmundjet psikike pas viteve 1950-ta, në atë kohë kur u "emancipuan".

Kjo përqindje e rritur e problemeve psikike te femrat është për shkak "... se ato e shohin se pozita e tyre në shoqëri është më irrituese dhe më pak shpërblyese se ajo e meshkujve...".

Studiuesit e sëmundjeve psikike gjithashtu e kanë zbuluar se femrat që kujdesen vet për fëmijët e tyre më shumë i nënshtrohen sëmundjeve psikike se sa ato që janë të martuara, si dhe shkalla e vetrasjeve në mesin e femrave që janë të shkurorzuara është shumë e madh.

Prej atëherë të gjitha studimet që e krahasojnë shëndetin mental të grave të shkurorzuara me ato të martuara, tregojnë se të parat kanë një përqindje shumë më të lartë të problemeve psikike. Me rritjen e shkallës së divorceve, është rritur numri i femrave më sëmundje psikike.

#### **Alkoholi dhe Duhani**

Sipas një reporti të publikuar në Sunday Times, numri i femrave që konsumojnë alkohol është në rritje e sipër. Studimi tregon se numri i meshkujve që përdorin alkoholin "mbi sasinë e lejuar" ka rënë në 26%, kurse ai i femrave është rritur në 12%.

Numri i femrave që konsumojnë duhan në

këtë kohë është gati po aq sa numri i meshkujve. Studimet tregojnë se më shumë vajza të reja dhe djem të rinjë fillojnë të konsumojnë duhan, gjë që tregon se në të ardhmen shumica e duhanxhive do të jenë femra.

### **Pornografia**

Rritja e shpejtë e industrisë pornografike, që ka filluar nga vitet 1950 (interesante kjo që mu atëherë kur femra “u çlirua”), ka treguar edhe një herë për të arriturat e “barazisë” në Perëndim. Pornografia nuk e prezanton femrën si një qenie njerëzore me ndjenja dhe nevoja, por si një mjet që përdoret për ti shfryer epshet e pastaj hudhet mënjane. Femrat janë udhëhequr që të besojnë se me shitjen e trupit të tyre ata do ta arrinë “barazinë”, por në fakt ata u bënë rob të meshkujve të cilët e shfrytëzojnë idenë e “barazisë” për ta përdorur femrën për t’i kënaqur epshet e veta dhe për të fituar para.

Në vitet 1980-ta manipulimi me gratë eci në hap para. Sheila Jeffreys, një feministe, shkruan: “Kur kampanja kundër pornografisë filloi, ishte e mundur të sulmohet pornografia si një product mashkullor i dizajnuar për konsumim mashkullor. Kjo nuk është kështu në vitet 1980-ta. Femrave u është thënë nga ana e “liberalistëve” se pasi që “femrat janë të barabarta tash”, është në rregull për femrën të kënaqet me pornografi. Kjo ideologji më shumë shërben për ta dobësuar emancipimin e femrës se sa për ta zhvilluar. Idea e shitjes së pornografisë femrave prej viteve 1980-ta është bërë një mënyrë më e sofistikuar për ta përkrahur dominimin mashkullor”.

Pornografia është kategoria më e madhe e mediave në botë. Ajo hynë në shtëpitë tonë nëpërmjet televizorit dhe gazetave, si dhe nëpërmjet videos, filmit dhe programeve

satelitore. Globalisht, pornografia ka profit 7 miliard Dollar në vit. Në SH.B.A. çdo ditë ka 1 milion filma të ri pornografik, që është 30% më shumë se filmat e zhanrave tjerë. Në Britani, 20 milion kopje të gazetave pornografike shiten për çdo vitë. Në Suedi një shitore pornografike ka më shumë se 500 tituj të gazetave pornografike, kurse një kiosk ka diku 50 tituj.

Është vlerësuar se 18 milion meshkuj në Sh.B.A. blejnë gazetë pornografike çdo muaj. Pornografia në botë është duke u bërë gjithnjë më e dhunshme dhe më e ashpër, dhe kohëve të fundet gjithnjë e më shumë po shpërndahet me anë të internetit.

Kjo është pozita në të cilën “civilizimi” dhe përparimi i tij, si dhe “barazia gjinore” e kanë vendosur njerëzimin, ku femrat janë viktimat në çdo aspekt të krimeve, sulmeve dhe diskriminimeve tjera.

Si rezyme, kjo është çka ka ndodhur në orën e kaluar në Britani: një femër është dhunuar, 18 veta janë shkurorëzuar, 20 femra kanë abortuar dhe 24 fëmijë u kanë lindur femrave të pamartuara. Kjo ndodhi e njëjtë do të përsëritet në orën e ardhshme dhe në orën pas saj. Derisa ti e kalon ditën duke qenë i zgjuar apo i fjetur, kjo gjendje e trishtueshme do të vazhdojë, dhe numri i viktimave të reja gjithnjë e më shumë do të rritet.

Çfarë përgjigje e mundshme mund të jepet për këtë? Si mundet që këto krime barbare kundër femrave të zvogëlohen dhe të zhduken? Rruga e “barazisë” së supozuar në mes gjinive, vetëm se është duke e shtuar problemin, dhe çdokush që ka sadopak mend do ta sheh se bota është duke shkuar drejt barbarizmit dhe injorancës (xhahilijetit). Xhahilijet i njëjtë si ai që ka qenë në periudhën para-islame. Në një shoqëri që pretendon se është e civilizuar dhe e përparuar, si mund të pranohen standardet

e ulta morale që po i shohim ditëve të sodit.

Cilat janë zgjidhjet e këtyre problemeve? Për njerëzit që janë të begatuar me sinqeritet dhe kuptim, nuk ka nevojë të kërkohet shumë për ta gjetur përgjigjen. Kush mund të udhëzojë më mirë se Krijuesi i meshkujve dhe femrave – All-llahu? Nëse i krahasojm praktikat perëndimore me vlerat islame, do të shihet qartë e vërteta dhe do të shihet devijimi dhe shkatërimi moral në të cilin gjenden perëndimorët.

Shkaku kryesor i problemeve që u diskutuan është fakti se shoqëria perëndimore e nxit përzjerjen e lirë të meshkujve dhe femrave. Duke i marrë në konsiderat pasojat e përzjerjes së burrave dhe grave, të cilat u cekën më lartë, zgjidhja e kësaj është e qartë.

Psikologët bashkohorë pajtohen se kur janë bashk dy veta të gjinive të kundërta, ideja seksuale dhe mendime të ngjashme u bien ndërmend. Shkaku i kësaj është lejimi i përzjerjes së meshkujve dhe femrave, si dhe kjo është shkak i krejt dhunës, shtypjes dhe krimeve që bëhen ndaj femrave. Veprimi sipas kësaj të dërgon te krejt sëmundjet e shoqërisë perëndimore: abortit, shkurorzimit, familjeve me një prind, vetvrasjeve, dhunimeve dhe të gjitha sëmundjeve tjera shoqërore. Para 1400 vjetëve, Pejgamberi Muhammed (sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem) i'a tërhoqi vërejtjen njerëzimit për pasojat e përzjerjes së meshkujve dhe femrave dhe na këshilloi të kemi shumë kujdes nga kjo gjë. Në lidhje me këtë ai tha se: "kur vetmohet një mashkull dhe një femër, i treti i tyre është Shejtani".

Siç tham më herët 75% e dhunimeve bëhen

nga njerëz që i njohin vikimat. Në vendet e punës, 38% e meshkujve e përdorin pozitën e tyre për ti shfrytëzuar femrat me të cilat punojnë. Shkaku kryesor i divorcit është zinaja dhe tradhtia bashkshortore, gjëra që bëhen shumë lehtë kur të përzihen meshkujt dhe femrat. Shkaku pse femrat 15 vjeçare po ngelin shtatëzëna, është për shkak shkollave ku mësojnë bashkë meshkujt dhe femrat.

Në botën perëndimore, "barazia" e femrave d.t.th. që ato të duken njësoj si meshkujt, ti punojnë të njëjtat punë që i punojnë meshkujt dhe të sillen njësoj siç sillen meshkujt. Shoqëritë perëndimore e kanë paguar shtrejt sjelljen e këtyllë jonatyrale, duke i humbur vlerat morale dhe njerëzore. Barazia në mes gjinive nuk do të thotë se edhe meshkujt edhe femrat duhet të duken njësoj, të punojnë të njëjtën punë dhe të sillen njësoj. Kjo është absurditet, sepse All-llahu e ka krijuar mashkullin me cilësi që dallojnë nga ato të femrës.

Islami ka vendosur ligje të qarta për rolin e meshkujve dhe rolin e femrave në shoqëri, që përputhen me natyrën në të cilën All-llahu i ka krijuar meshkujt dhe femrat. Mirëpo armiqt e Islamit me qëllim manipulojnë me faktin se në Islam femrat urdhërohen të mbulohen dhe mos të përzihen me burrat e huaj, duke e konsideruar këtë si shtypje mbi femrat. Andaj ne duhet ta tregojmë të vërtetën dhe ta sqarojmë të kotën në cilën gjenden metodat e flliqura të tyre, të cilat i promovojnë pasuesit e shejtanit për të fituar të mira materiale dhe për ti shfryer epshtet e veta, duke e përdorur femrën si mjet në realizimin e këtyre gjërave..

Ismail Adem Patel  
Përktheu: Omer Islami  
8.10.2004

## Abdul Kadir Xhejlani

Shejh Abdul Kadir Xhejlani (471 H-561 H)

Kush ishte Abdul Kadir Xhejlani?

Quhej Abdul Kadir ibën Ebi Salih ibën Abdull-llah El Xhili El Bagdadi. Disa autorë pohojnë se është pasardhës i sahbiu të ndershëm Ali ibën Ebi Talib, radijall-llahu anhu. Lindi në qytetin Kejlan në vitin 471 H që në vitin 488 H të shpërngulet për jetë në qendrën e botës Islame në atë kohë në qytetin e Bagdadit.

Mësuesit e tij:

Në Bagdad përfitoi nga shumë dijetarë nga mesi i ti cilëve në biografisë e tij përmenden: Ebu Galib ibën Bakil-lani, Xha'fer Es Serraxh, Ebu Bekr ibën Sevsen, Ebu Sa'd El Muharremi, Ebu Talib El Keludhani, Zekerijja Et Tebrizi. E shoqëroi zahidin e njohur të asaj kohe Hammad Ed Debbas-in. Pasi që u pasurua me dije në vitin 520 H u bë mësues në medresenë që e udhëqete mësuesi i tij El Muharremi.

Ibën Xheziu kështu e përshkruan këtë medrese: Ishte e vogël dhe udhëqete me të iu besua Abdul Kadir (pas El Muharremi-ut) i cili në të këshillonte njerëzit me gjuhë të ëmbël terheqëse. Këto këshilla tërhoqën shumë njerëz dhe pas pak kohë medreseja u bë e ngushtë për njerëzit që donin të marrin pjesë në ligjeratat e Abdul Kadir.

Abdul Kadiri ishte pauses i medhhebit të Imam Ahmedit. I pohonte (ithbat) cilësitë dhe emrat e All-llahut ashtu siç i takon madhërisë së All-llahut, urrente apologetikën, me besim të pastër në çështjen e kaderit pasues i sunnetit në bazat e fesë dhe dëgët e saj.

Ibën Sem'aniu kështu e përshkruante: Imami i hanbelive dhe mësuesi i tyre në kohën e tij, fekih i devotshëm, i mirë dhe fetarë. Përmendte shumë All-llahun, vazhdimisht ishte i thelluar në

mendime, me sy që shpejtë lotonin...

Njerëzit përfituan shumë nga këshillat e tij dhe fjalët e tij ishin të pranueshëm tek njerëzit në përgjithësi. Për të dhënë një pasqyrim të mirë për dijen dhe besimin e tij do të përmendim rastin në vijim: Në një prej udhëtimeve në shkretëtirë mbeta pa ujë dhe mu ashpërsua etja. Duke ndejtur në atë gjendje mbi kokën time zbriti një re dhe filloi të pikon diçka që i përngjajnte shiut. U paraqit një dritë që e ndriçoi horizontit dhe dëgjova një zë: O Abdul Kadir unë jam Zoti ytë. Ti kam bërë të lejuar gjërat që tjerët i kanë të ndaluara. Thash: Kërkoj strehim tek All-llahu nga djalli i mallkuar, hesht o i mallkuar. Kur i përfundova këto fjalë drita u shndërrua në erësirë dhe tim dhe përsëri dëgjova një zë: O Abdul Kadir shpëtove prej meje me dijen që e ke mbi dispozitat e All-llahut. Në këtë mënyrë i kam mashtruar shtatëdhjetë nga pasuesit e tarikatëve (sufive). Thash: Kjo është dhunti dhe begati e All-llahut. Më pyetën: Nga kuptove se bëhet fjalë për djallin? Thash nga fjala e tij: T'i kam lejuar të ndaluarat. (Tabekat el Hanabile, vëll. 3, fq. 294)

Ai që mendon se shejhut i lejohet ajo që është e ndaluar për tjerët ose mendon se shejhu është i liruar nga obligimet ka bërë KUFRA.

Fjalët e dijetarëve për Abdul Kadir Xhejlanin:

Dhehebiu thotë: Me fjalë përmbledhëse Abdul Kadir Xhejlani ishte dijetarë i njohur dhe i respektuar. Kemi disa vërejtje për disa fjalë dhe lutje që transmetohen prej tij, që do të sqarohen para All-llahut kur do të tubohemi. Shumë prej fjalëve të tilla janë të shpifura. (Sijer A'lam En Nubela vëll. 20, fq. 451)

Ibën Kethir: Paraqitja e tij ishte e këndshme,

dallohej me heshtje përpos kur bëhej fjalë për urdhërim për të mirë dhe ndalim prej të këqijave, ishte i modest...

Pasuesit e tij përmendin disa ndodhi, fjalë dhe vepra shumica e të cilëve janë shpifje dhe ekzagjerim. Është autor i librave "Gunje" dhe "Futuhul Gajb" në të ka gjëra të bukura por edhe hadithe të dobët dhe apokrifë. Me një fjalë ishte prej dijetarëve të zgjedhur. (El Bidaje ven Nihaje vëll.6)

Muveffekuddin ibën Kudame (autori i librit El Mugni) thotë: Askush si Abdul Kadiri nuk është respektuar për shkak të devotshmërisë.

Kur hyra në Bagdad e pash se i pari prej dijetarëve në atë kohë ishte Abdul Kadiri, dijes ia kishte bashkangjitur veprën...

Mjaftonte që kërkuesi i dijes të takohet vetëm me të sepse kishte tubuar dije të shumta, ishte durimtarë me nxënësit, zemërgjërë, paraqitja e tij ta mbushte syrin, dallohej me cilësi të bukura që rradhë gjindeshin tek tjerët. Pas tij nuk kam parë njeri si ai.

Izzuddin ibën Abdus Selam thotë: Kerametet (raste që i ndodhin njeriut të devotshëm në të cilat thehen ligjet e natyrës që i ka vendosur All-llahu si për shembull dritë e cila ndriçon udhën në erësinë e natës) e tij janë transmetuar në mënyrë që nuk len vend për dyshim (tevaturo). (Tabekat el Hanabile, vëll. 3, fq. 292-294)

Ibën Rexheb El Hanbeli: Shejh Abdul Kadiri, në kohën e tij, ishte i respektuar. E respektonin dijetarët dhe zahidët...

Ka thënë fjalë të bukura për teuhidin, cilësitë e All-llahut, kaderin dhe shumë tema në të cilat pasonte Sunnetin...

Shejhul Islam Ibën Tejmijje rrefen: Shihabuddin Es Suhraverdi ka treguar: Kisha dëshirë të lexoi diç nga librat e apologetikës por akoma nuk isha i vendosur a të lexoi librin "Irshad" të Imamul Haramejnit, "Nihajetul Ikdam" të Shehristanit ose ndonjë libër tjetër. Se bashku me dajën tim Ebu Nexhib shkuam tek Abdul

Kadiri i cili më tha: O Omer kjo (leximi i këtyre librave) nuk është prej nozullit për në varr, kjo (leximi i këtyre librave) nuk është prej nozullit për në varr. Pas kësaj vendosa që të mos i lexoi këto libra.

Të pavërtetat që janë shpikur për Abdul Kadiri Xhejanin:

Ky dijetarë i devotshëm u sprovua nga shumë njerëz, në veçanti pasues të tarikateve sufiste, që për të shpikën shumë të pavërteta që nuk i pranon as logjika e shëndoshë e as feja.

Disa sufite të lindjës pohojn se Abdul Kadiri drejton me gjithësinë, e quanin me emrat Kutb (etimologjikisht guri i mullirit, tek sufite "koka e burrave" dhe "evlijau më i madh") dhe Gauth (kutbi i ndihmës tek sufite), ekzagjerimi në lavdrata, i atribuonin shumë nga praktikave sufite që nuk kanë bazë, mendonin se nëse emri i tij shkruhet në qefinin e ndonjë të vdekurit nuk do ta djeg zjarri i xhehennemit dhe kështu me rradhë...

Shumë nga këto pohime që i mvishen Abdul Kadir-it nuk janë të vërteta dhe janë transmetuar në libra që nuk mundën të mirren për bazë sikur poezitë e ndryshme (si për shembull poezitë e Abdur Rahim El Ber'i në divanin e tij në të cilin e cilëson si Kutb, Gavth dhe zëvendës i të Zgjedhurit (Muhammedit) në tokë) si dhe libri i Ebul Hasen Esh Shetnufi që është plotë gënjeshtër dhe shpifje. Ibën Rexhebi, rahimehull-llah, thotë: "Tregimet mbi vlerat e shejh Abdul Kadir-it në një libër prej tre vëllime i tuboi Ebul Hasen Esh Shetnufi në të cilin tuboi gjëra katas-trofale dhe të pavërteta. Mjafton që njeriu të quhet si gënjeshtar nese e flet atë që e ka dëgjuar.

Në këtë libër kam parë gjëra që nuk i pranon zemra ime e as që mundem të mbështetem në të. Për këtë shkak unë transmetoi gjëra që janë të njohura dhe që janë përmendur në librat e tjera sepse libri në fjalë është plotë pretendime dhe fjalë të kota që nuk mundën as të numërohen dhe që nuk lejohet t'i mveshen Abdul Kadir-it, All-llahu e mëshiroftë. Pastaj dëgjova prej El



Kemal Xha'fer El Edfuni i cili më tha se edhe vetë Esh Shetnufi ka qenë i akuzuar për shumë gjëra që i ka përmendur në librin në fjalë.”

Musibeti më i madh tek sufitetë është mos dallimi mes transmetimet e saktë dha ata që janë shpikur, mes të vërtetës dhe të kotës dhe fakti se shuma nga besimet e tyre i mbështesin në ëndra, zbulime shpirtërore (mukashefat), zëra që i dëgjojnë (el hevatif) dhe hadithe të shpikura. Shpëtimi prej këtyre gjërave është në pasimin e sunnetit që është transmetuar në mënyrë të besueshme prej transmetuesve besnik që i dallojnë hadithet e saktë prej atyre që nuk janë të saktë, e që nuk janë ithtarë të ndonjë bidatit dhe nuk janë të dhënë pas pasioneve të tyre.

Ibën Tejmijje, rahimehull-llah, thotë: Sa i përket imamëve sufitetë dhe të njohurve prej të parëve të tyre sikur Xhunejd ibën Muhammed dhe Abdul Kadir, ata ishin njerëz që më shumë se tjerët zbatonin ligjin e All-llahut, urdhëresat dhe ndalesat e Tij, porositinin të pasohet ajo që e ka caktuar All-llahur dhe alarmonin nga mosrespektimi i ligjit të All-llahut. . .

Libri i Abdul Kadir-it koncentrohet në potencialin e detyrave, largimin prej ndalesave dhe durimin gjatë sprovave. . . (El Fetava, vëll. 8, fq.366)

Abdur Rahman ibën Hasen në librin e tij “Keshfu ma elkahu iblis minel behrexh vet telbis” thotë: “Në këto gjëra të ndaluara hyjnë edhe veprimet që i bëjnë disa irakianë, banorë të Magribit dhe bregdetit që ndëruan pallatë mbi varrin e Abdul Kadir-it dhe që ndëruan ndërtesa të posaçme në shumë vende ku adhurohet Abdul Kadiri, ku i drejtohen lutje për ndihmë dhe largimin e brengave. Shumë prej tyre besojnë se ai prej së largu i dëgjon lutjet e tyre dhe u përgjigjet atyre që e lusin. . .

Me këto vepra ata i përshkruan atij cilësi që si ka askush përpos All-llahut dhe po të ishte kjo e lejuar përparësi do të kishin ata që mijëra herë janë më të mirë se Abdul Kadiri sikur katër halifet e drejtë, as'habët e parë që e pranuan

Islamin, imamët e dalluar me dëvotshmëri. . .

Ibën Tejmijje: Të parët e zahidave sikur. . . në mesin e të cilëve është edhe Abdul Kadir Xhejlani nuk lejonin që nxënësi i tyre të del prej suazave të sheriatit edhe atëherë kur ju ndodhin keramete sikurse fluturimi . . .

Nga vërejtjet që munden t'i drejtohen Xhejlani janë:

Përdorja e haditheve të dobët dhe të shpikurë në librat e tij “Futuhul Gajb” dhe “El Gunje li Talibi Et Tarik El Hakk”

Mospërkufizimi me metodologjinë e të parëve tanë të mirë në adhurim dhe promovimi i izolimit në shkretëtirë, që nuk ka qenë traditë e zahidave të selefit.

#### **Fjalë nga Abdul Kadir Xhejlani**

“O ti që tek krijesat ankoresh për fatkeqësitë që të kanë ndodhur, çfarë dobi ke prej ankesës që ia drejton krijesës. Ata nuk munden të të bëjnë dobi e as që munden ta largojnë atë që të ka goditur. Nese mbështetesh (vetëm) tek krijesa do të largohesh prej All-llahut dhe do të shkaktosh hidhërimin e Tij.”

“Vaj për ty, a nuk turpëroresh të kërkosh prej tjetërkujt përpos All-llahut. Atë (All-llahun) e ke më afër se krijesat.”

“Mos iu drejto me lutje askujt përpos All-llahut.”

Gjatë sëmundjes së djalit e këshillonte me këto fjalë: “Mos u frik dhe mos ke shpresa tek asnjë krijesë. Çështjet tua leri në duart e All-llahut. Mos u bind tek asnjë krijesë, dhe dije se vetëm All-llahu është ai që mundet t'i realizon kërkesat tua. Teuhidi (besimi i sinqertë vetëm në All-llahun) është thelbi i çdo të mirës. . . (Libri Fet'hur Rabbani, faqet, 117, 373, 159, 118)

“Krijuesi njihet me anë të argumenteve në gjithësi, me një fjalë besimi është; të dijshtë dhe të bindesh se All-llahu është një, është një. Është ngritur lartë mbi Arsh, dija e Tij ka përfshirë çdo gjë, tek Ai ngritet fjala e bukur dhe vepra e mirë. . .

Nuk lejohet të thuhet është në çdo vend sepse është ngritur mbi Arsh. All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "I Gjithëmëshirshmi u ngrit lartë

dhe qëndroi mbi Arsh." (Ta-Ha, 6)... (El Gunje) All-llahu e mëshiroftë Abdul Kadirin me mëshirën e tij të gjërë.

Talha Kurtishi,  
24.9.2004

## Imam Ebu Davud et Tajalisi

(132 H-204 H) (Hafidhi i Basrasë)

Quket Sulejman ibën Davud ibën Xharud, Ebu Davud El Farisi, El Esedi Ez Zubejri, robi i liruar i familjës së sahiut të ndershëm Ez Zubejri ibën El Avvam, radijall-llahu anhu.

Jetoi në kohën e artë të sunnetit. Ishte i dalluar me kujtesë të fortë gjë kjo e cila ia lehtësoi mësimin e shumë haditheve. Libri i tij El Musned konsiderohet libër i rëndësishëm dhe referencë e pashmangshme për kërkuesit e dijes.

Është lindur diku në vitin 131 H ose 132 H dhe nuk ka detaje të shumta për fëmijërinë e tij. Ajo që me siguri dihet është se ai në moshën e re ka filluar kërkimin e dijes. Nga dijetarët me të cilët është takuar dhe prej të cilëve ka përfituar shumë do t'i përmendim:

Shu'be ibën El Haxhxhaxh, Sufjan Eth Theuri, Ebu Amir El Hazzaz, Davud ibën Ebi Furat, Xherir ibën Hazim, Ibën Ebi Dhi'b, Zem'ah ibën Salih, Abdullah ibën El Mubarek, Sufjan ibën El Ujejne etj.

Nga ky det i dijes përfitua shumë nxënës në mesin e të cilëve si më të dalluar do t'i përmendim:

Imam Ahmed ibën Hanbel, Muhammed ibën Beshshar, Abbas Ed Duri, Taberaniu, Ahmed ibën Ibrahi Ed Deureki etj.

Për këtë njeri janë thënë shumë fjalë që në vete ngërthejnë respektin e madh që për të e patën dijetarët.

Amër ibën Ali el Fel-las thotë: Nuk kam parë njeri me kujtesë më të fortë se Ebu Davudi.

Dhehebiu duke i komentuar këto fjalë thotë: Këtë e thotë njeri që është takuar dhe shoqëruar me imamë sikur Jahja El Kattan, Ibën Mehdi dhe ka udhtuar bashkë me

Ibën el Medini (mësuesi i Imam Buhariut).

Tha: Ebu Davudi më tha: çdo herë jam i gatshëm që nga kujtesa të lexoi 30 000 hadithe. Vetëm prej Uthman El Burri-ut kam mësuar 12 000 hadithe.

Sulejman ibën Harb rrëfen: Kur Shu'beja e përfundonte ligjeraten ulej Ebu Davudi dhe nga kujtesa e përsëriste atë që e ka thënë Shu'beja.

Vekiu (mësuesi i Imam Shafi'ut) thotë: Me përjashtim të Ebu Davudit nuk ka mbetur njeri që i din përmendsh hadithet e gjatë.

Thonte: Ebu Davudi është kodër e dijes.

Amër ibën Shebeh thotë: Në tubimet e tij në Asbehan u shënuan 4000 hadithe që ai i recitonte prej kujtesës.

El Bundar-i ka thënë: Për asnjërin prej muhadithëve nuk kam qajtur ashtu si kam qajtur për Ebu Davudin.

En Nesai: Thikka (i besueshmi) dhe i singert në fjalë.

Jeta e tij në këtë botë përfundoi në muajin Rebi'ul Evvel 204 H

All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e tij të gjërë.

(Për më gjërë shih "Sijer A'lam En Nubela" vëll. 9 fq. 378-384)

Talha Kurtishi,  
8.10.2004

## Tema: Urtësia e agjërimit

**Pyetje:** Ç'është urtësia e obligimit për agjërimit?

**Përgjigje:** Kur e lexojmë ajetin: “O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm” e kuptojmë se cila është urtësia e obligimit të agjërimit, ajo pra është devotshmëria dhe adhurimi i All-llahut, subhanehu ue teala.

Takvallëk d.m.th. lënie e të ndaluarave, në përgjithësi e ka kuptimin e veprimit të urhdërave dhe largimit nga ndalimet.

Resulull-llahu, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, ka thënë: “Kush nuk i largohet fjalëve të kota, punëve të kota dhe injorancës, le ta dijë se All-llahu nuk ka nevojë që ky njeri të largohet nga haja dhe pija”. (Buhari)

Duke e parë këtë, tregohet edhe më tepër rëndësia se agjëruesi duhet t'i respektojë urdhërat si dhe të largohet nga gjërat e ndaluara, qofshin ato gojore apo veprore.

Nuk duhet të bën givet, as të rrenë, as të nxit përçarje mes njerëzve, as të shet gjëra të ndaluara, pra, duhet të largohet nga të gjitha haramet.

Kur njeriu jeton në këtë mënyrë një muaj të plotë, padyshim se gjatë tërë vitit do të kalon ashtu si duhet.

Më e keqja është se disa agjërues nuk bëjnë dallim mes ditëve që nuk kanë agjëruar dhe ditëve kur agjërojnë.

Ata vazhdojnë me traditën e mëhershme, lënien e urdhërave dhe veprimin e ndalimeve. Nuk mund të shohish tek ai prezencën e qetësisë së agjërimit.

Këto vepra nuk e prishin agjërimit, por e mangësojnë shpërblimin, bile poqese i vejmë në terezi mundet që ato vepra ta peshojnë shpërblimin e agjërimit.

Muhammed bin Salih el-Uthejmin  
Marrë nga libri: Fetva rreth shtyllave të Islamit

## Ramazani

Ebu Hurejre, radijallahu anhu, ka transmetuar se Pejgamberi, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Agjëro kur ata agjërojnë, përfundoje agjërimin kur ata ta mbarojnë të tyrin dhe bë kurban kur ata të bëjnë kurban". [1]

El-Bejhaki ka transmetuar përmes Ebu Hanifes i cili ka thënë: Ali Ibënul-Akmar më ka transmetuar mua nga Maskuk i cili ka thënë: "Unë kam hyrë tek Aisha në ditën e Arafatit kështu ajo më ka thënë: "Shërbeje Marsukun me ca përsheha (llapë) dhe bëje më të ëmbël". Masruku i ka thënë: "Asgjë nuk më pengojë mua të agjëroj këtë ditë përveç frikës se mos ishte dita e Kurbanit. Kështu Aisha më ka thënë mua: "Dita e Kurbanit është kur njerëzit bëjnë kurban dhe dita e përfundimit të agjërimit është kur njerëzit e përfundojnë agjërimin e tyre".

Ky zinxhir transmetimi është xhejjid (I mirë) për shkak të asaj çfarë ka vazhduar.

### Kuptimi i Hadithit

Imam et-Tirmidhi ka thënë pasi e ka cituar hadithin: "Një nga njerëzit e dijes e ka shpjeguar këtë hadith duke thënë: Kuptimi i tij është për të agjëruar dhe për ta përfunduar agjërimin bashkë me xhematin dhe maxhorancën e njerëzve".

Es-San'ani ka thënë në Subulus-Selam (2/72): "Në këtë hadith është një fakt që është në përputhje me njerëzit që e kanë pranuar vendosjen e Bajramit (Id- në arabisht) dhe që individit që beson se është ditë Bajrami për shkak të shikimit të hënës atëhere është e obligueshme mbi të të jetë në përputhje me njerëzit dhe që gjykimi i njerëzve...përsa i përket faljes, përfundimit të agjërimit dhe bërjes

Kurban është e detyrueshme mbi këtë individ".

Ibën Kajjim, rahimahullah, e ka përmendur këtë kuptim në Tehdhibus-Sunan (3/214) dhe ka thënë "Është e thënë: Në të është një refuzim për ata të cilët thonë që kushdo që e di pozicionet e hënës për shkak të llogaritjeve astronomike atëhere është e lejueshme për të të agjërojë dhe ta përfundojë agjërimin, madje edhe nëse të tjerët nuk e dinë. Është thënë: Që individit që dëshmon të shfaqurit e hënës, por Kadiu (gjykatësi) nuk e ka pranuar dëshminë e tij atëhere nuk ka agjërim për të, siç nuk ka agjërim për njerëzit".

Ebul Hasan es-Sindi ka thënë në "Hashijah a'ala Ibën Maxhe" pasi ka përmendur hadithin e Ebu Hurejrah-s i cili është transmetuar nga et-Tirmidhiu: "Dhe kuptimi i dukshëm është: Që nuk ka vend për (opinionet) e individëve për të hyrë në këto punë, e as të veprojnë në mënyrë individuale për këtë. Ndërsa kjo punë i përket Imamit (liderit të muslimanëve) dhe Xhematit (trupit të bashkuar të muslimanëve nën udhëheqësi të imamit). Është e obligueshme mbi individët të ndjekin Imamin dhe Xhematin. Nga kjo është se nëse një individ e shikon hënën por Kadiu e ka refuzuar dëshminë e tij atëhere individit nuk ka të drejtë në këto çështje por duhet të ndjek xhematin në këtë".

Dhe ky është kuptimi i cili është i dukshëm nga hadithi dhe i cili është i theksuar nga fakti që Aisha, radijallahu anha, e ka përdorur atë me Masrukun kur ai e ka penguar veten për të agjëruar në ditën e Arafatit duke iu frikësuar se mos është ditë kurbanit. Kështu ajo ia ka shpjeguar atij që nuk ka peshë opinionin e një individit për këtë

dhe që ai duhet të ndjek xhematin. Kështu ajo i ka thënë atij: "Dita e kurbanit është kur njerëzit bëjnë Kurban dhe dita e përfundimit të agjërimit është kur njerëzit përfundojnë agjërimin e tyre".

Dhe kjo është çfarë është më e dobishme; natyrshmëria dhe toleranca e Sheriatit (Ligjit Islam), ku njëri nga qëllimet është bashkimi i njerëzve së bashku, duke i unifikuar rradhët e tyre dhe duke u larguar nga të gjithë ata që ndahen nga bashkimi i tyre i përgjithshëm – nga opinionet individuale. Kështu Sheriati nuk i jep asnjë peshë opinionit të individëve në çështje që i përkasin lbadeteve xhema'ije (rite kolektive të adhurimit) të tilla si agjërimi-Bajrami dhe falja me xhemat – edhe nëse opinionin është korrekt, nga njëra anë. A nuk shikoni që sahabet, radiallahu anhum, janë falur mbrapa njëri-tjetrit. Kështu nga ata ka patur prej tyre që e kanë konsideruar që prekja e një gruaje ose derdhja e gjakut nga trupi e zhvlerëson abdesin dhe janë falur përkrah me ata të cilët nuk e kanë mbajtur këtë pikëpamje. Nga ata ka pasur prej tyre që e kanë kompletuar faljen ndërsa udhëtonin ndërsa të tjerët e kanë shkurtuar. Dhe këto dhe të tjera ndryshime nuk i kanë penguar ata nga të falurit kolektivisht pas një imami të vetëm dhe kanë mbajtur mendimin se është i pranueshëm. Dhe kjo është sepse ata e dinin që tafarruk (përçarja) në fe është më e keqe sesa ndryshimet (Ihtilaf) në disa opinione. Madje, çështja me një prej tyre arriti deri aty sa ta quante të papranueshme asnjë opinion i cili ka ndryshuar me Imamin e madh në grumbullime të mëdha; të tilla si grumbullimet në Mina (gjatë Haxhit) deri aty që ai do ta linte veprimin mbi opinionin e tij në atë grumbullim – duke u larguar nga ajo e cila mund të rezultojë në keq, për shkak të veprimit në opininin e tij.

Kështu Ebu Davudi transmeton (1/307) që

Uthmani, radijallahu anhu, i ka falur katër rekatë në Mina, kështu Abdullah Ibën Masudi e ka kritikuar atë dukë thënë: "Unë kam falur dy rekat me Pejgamberin, salallahu alejhis ua selam, dhe dy rekatë me Ebu Bekrin dhe dy rekatë me Omerin dhe dy rekatë me Othmanin në fillim të qeverisjes së tij, pasta ai e kompletoj atë (duke falur katër rekatë). Pas kësaj rrugët u bënë të ndara me të gjithë ju. Kështu unë shpresoj nga këto katër rekatë që të dyja këto të jenë të pranueshme". Më pastaj Ibën Masudi vet ka falur katër rekatë. Kështu i është thënë atij: Ti e ke kritikuar Othmanin e ti u fale me katër rekatë? E ai ka thënë: "Ndryshimi është i keq".

Kështu ata të cilët vazhdojnë të ndahen përsa i përket faljeve dhe të cilët refuzojnë të ndjekin imamët lokal në disa xhami – veçanërisht në Faljen e vitrit gjatë Ramazanit – duke përdorur si fakt që është kundër medhhebit të tyre atëhere ata duhet të reflektojnë mbi hadithin e mësipërm dhe etherin [trasmetimin].

Pra ata të cilët kanë dituri astronomike dhe për shkak të opinionit të tyre agjërojnë dhe e përfundojnë agjërimin vetëm duke munguar ose ndarë nga shumica e muslimanëve, duke mos parë asnjë gjë të keqe në të vepruarit kështu – ai duhet të reflektojë edhe mbi faktet e përmendura më parë. Kështu të gjithë ata duhet të konsiderojnë dhe të reflektojnë mbi dijen që është përmendur. Ndoshta do të gjejnë për vetet e tyre një kurë për injorancën e tyre dhe vetdëshpërimin, kështu që ata mund të bëhen atëhere një rresht i bashkuar përkrah vëllezërve të tyre musliman – sepse me të vërtetë Dora e Allahut është mbi xhematin.

Shënime:

1) Sahih: i transmetuar nga Et-Tirmidhiu (2/37). Shejh Albani e ka verifikuar sahih në es-Sahih (nr. 224).

Shejh Muhammed Nasirud-din Albani  
Marrë nga: Silsilatul-Ahadithus-Sahihah (1/442-445)

Përktheu: Ammar Ardit Kraja

## 15. Bujaria

Transmeton Ebu Hurerja, radijall-llahu anhu, se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Allahu i Lërtëmadhëruar thotë: shpenzo që të shpenzohet për ty, pastaj tha: Dora e Allahut është përplot, nuk e pakëson shpenzimi i përhershëm, natën dhe ditën. Më pas vazhdoi (Pejgamberi): a e shihni shpenzimin e Tij që prej krijimit të qiellit dhe tokës, nuk është pakësuar ajo që është në Dorën e Tij, Arshi i Tij është mbi ujë dhe në Dorën e Tij është peshorja e ul atë dhe e ngrit"

Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "çkado që t'u jepni të tjerëve nga pasuria, ajo do t'u kompensohet në mënyrë të plotë duke mos u dëmtuar ju." Poashtu thotë: "Pra çkado që të jepni nga pasuria, s'ka dyshim se atë All-llahu e di shumë mirë." Dije, Allahu më mëshiroftë mua dhe ty, se çdonjëri i cili ka udhëhequr në periudhën e injorancës apo të Islamit, derisa është bërë i njohur me famë të lartë, i janë nënshtruar njerëzit, kanë marrë udhën për tek ai i afërti dhe i largëti, fama e tij nuk është arritur vetëm se, duke i ushqyer njerëzit dhe duke i nderuar mysafirët. Të gjithë njerëzit me pervojë përgjatë historisë, fetarët e dashamirët e të bukurës janë të një mendimi se gjëja më e mirë që njeriu mund ta sigurojë për veten në këtë botë dhe gjëja më madhështore që mund ta lë pas vete është bujaria, shoqërimi me bujarët sepse bujaria rezulton përmendjen për të mirë dhe të ngritë famën.

Ai i cili shpenzon, obligohet që me këtë vepër të kërkon kënaqësinë e Allahut "çkado që të jepni nga pasuria, e keni për veten tuaj, po mos jepni për tjetërkë, por vetëm për hir të All-llahut" kurse sa i përket shpenzimit për t'u mburur, kjo nuk është bujaria që lëvdohet, madje mund të jetë edhe mëkat nëse bëhet me mendjemadhësi ndaj robërve të Allahut.

Bujaria ka shumë dobi, prej tyre:

- Allahu, subhanehu ve teala, ia kompenzon shpenzuesit "e çkado që t'u jepni të tjerëve nga pasuria, ajo do t'u kompensohet në mënyrë të plotë duke mos u dëmtuar ju." , siç është përmendur edhe në hadithin e lartëpërmendur: "Shpenzo që të shpenzohet për ty". Poashtu Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë: "derisa një njeri ecte në një hapsirë, dëgjoi një zë që vinte nga një re: ujite kopshtin e filanit, pastaj ajo re lëvizti derisa lëshoi ujin mbi një tokë të djegur nga nxehtësia dhe ja, kur pashë ujin të mbledhur në një gropë. Ky njeri përcolli renë dhe kur arriti te vendi në të cilin ishte lëshuar uji pa një njeri i cili po mudohej të depozitohet ujin dhe i tha: o rob i Allahut, si e ke emrin? Ai ia përmendi të njejtin emër që e kishte dëgjuar prej resë, pastaj i tha: përse më pyet për emrin tim? lu përgjigj: unë dëgjova një zë në renë e cila e lëshoi ujin që thoshte: ujite kopshtin e filanit duke përmendur emrin tënd, për këtë dëshiroj të dij se ç'vepron me këtë kopsht? U përgjigj: pra, pasi e kërkohe këtë gjë po të tregoj se prodhimin që fitoj nga kjo tokë, një të tretën e saj e jap lëmoshë, me një të tretën ushqehem unë dhe familja ime kurse një të tretën e kthej përsëri në këtë tokë."

- Allahu, subhanehu ve teala, ia shumfishon pasurinë shpenzuesit " Shembulli i pasurisë së atyre që e japin në rrugën e All-llahut është si një kokërr prej të cilës mbijnë shtatë kallinj, ndërsa në secilin kalli ka nga njëqind kokrra. All-llahu ia shumfishon (shpërblimin) atij që dëshiron, All-llahu është Bujar i Madh, i di qëllimet." - Shpenzuesi shpreh frikën e tij prej zjarrit të Xhehennemit "Frikoni prej zjarrit qoftë edhe me gjysëm hurme" (Transmeton Buhariu)

- Gjëja më e mirë më të cilën njeriu mjekohet është lëmosha "mjekoni të sëmuarit tuaj me lëmoshë"

- Shpenzimi i pasurisë është mbrotje e saj "mbroni pasuritë tuaja me zekat"

- Bujaria është prej cilësive të lavdëruara tek Allahu, subhanehu ve teala, "Allahu është i Mirë dhe e do të mirën, i Pastër dhe e do pastërtinë, Bujar dhe e do bujarinë"

- Dora e cila jep është më e mirë se dora e cila merr "Dora e lartë është më e mirë se dora e poshtme"

- Bujaria i mbulon shumë të meta njeriut, thotë Imam Shafiju, rahimehull-llah: mbulohu me bujari sepse siç është thënë çdo të metë e mbulon bujaria.

Çdo musliman duhet të stoliset më këtë cilësi e në veçanti davetxhinjtë (thirrësit islam) për shkak efektit që ka kjo cilësi për të pranuar njerëzit Islamin. Enesi, radijall-llahu anhu, thotë: "nuk ka lypur ndonjëri prej Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, diçka vetëm se ia ka dhënë. Njëherë i erdhi një njeri, e Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i dha një tufë të madhe dhensh sa mund të zinte hapsira mes dy kodrave, e pastaj kthehet te populli i tij dhe iu thotë: o njerëz! Pranoeni Islamin sepse Muhamedi jep sikur ai i cili nuk i frikohet skamjes. Enesi, radijall-llahu anhu, thotë: edhe pse njeriu prononte Islamin për shkaqe të dunjasë, nuk kalonte përveç një kohës së shkurtër dhe Islami bëhej më i dashur për të se sa tërë dunjaja dhe ajo që është në të."

Transmeton Ibën Abbasi, radijall-llahu anhu, i cili thotë: "Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka qenë njeriu më bujar. Bujaria edhe më tepër i shtoj në muajin e Ramazanit kur takonte Xhibrilin. Xhibrili takohej me të çdo natë të Ramazanit dhe ia dëgjonte leximin e Kur'anit, pra Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ishte më bujar se era e lehtë "

Ibën Ebi Hatimi me sened të tij transmeton se Alij ibën Ebi Talibi, radijall-llahu anhu, ka thënë: Atij që Allahu i ka dhënë pasuri le ta shfytëzojë atë për mbajtjen e lidhjeve farefisnore, për mikpritje të mirë, për t'i ndihmuar nevojtarit, robrit, udhëtarit, të mjerit, të varfërit, muxhahidit dhe le të jetë durimtar në fatkeqësi sepse me këto cilësi fitohet bujaria në këtë dunja dhe fama në Ahiret;

Është pyetur Haseni, radijall-llahu anhu: cili është bujar? Është përgjigjur: ai i cili po të posedonte tërë dunjanë do ta shpenzonte atë dhe do të mendonte se edhe më tej ka obligime.

Transmetohet se Hudhejfe elAdevij ka thënë: ditën kur ngjau beteja e Jermukut u nisa për të kërkuar djalin e axhës tim në mesin e të vrarëve. Me vete kisha pakëz ujë dhe mendoja që nëse akoma ka frymëmarje do t'i jap nga uji që kisha me vete. Kur e gjeta në mesin e viktimave, iu afrova dhe i thash: të të jap ujë? Ai më dha shenjë pozitive. Ndërkohë dëgjuam një këlthitje dhe djali i axhës më dha shenjë që të shkoj te personi që këlthiste dhe ujin që kisha t'ia jap atij. Kur arrita tek ai e pash se ishte Hisham ibën Asi të cilin e pyeta: dëshiron ujë? Ai më dha shenjë pozitive mirëpo në këtë moment dëgjuam një këlthitje tjetër dhe Hishami më dha shenjë që të shkoj tek i treti dhe ujin që kisha t'ia jap atij. Kur shkova, ai veç më kishte vdekur. U ktheva te Hishami mirëpo e gjeta të vdekur. U ktheva edhe te djali i axhës tim mirëpo edhe ai kishte vdekur.

Një njeri prej fisit Kurjesh ishte nisur në udhë. Duke udhëtuar takoi një udhëtarë në mes të rrugës të cilin e kishte lodhur udha dhe e kishte molisur sëmundja. I sëmuri i tha kurejshitit: zotëri më ndihmo! Kurejshiti urdhëroi djalin e tij që pasuria që i kishte mbetur ta shpenzojë për këtë udhëtarë të sëmurë dhe djali i lëshoi në prehër katër mijë dirhem. I sëmuri deshi që të ngritet në këmbë mirëpo nuk mundi për shkak dobësisë dhe filloi të qajë. Kurejshiti i tha: pse qan, nuk mundesh të pamvarësoshesh me atë që ta dhamë? Ai ia ktheu: jo për Zotin, por m'u kujtua dobia që ka toka nga bujaria yte dhe kjo më bëri të qaj.

Kur Kajs ibën S'ad ibën Ibaden e kaploi sëmundja, shumë pak prej vëllezërve të tij muslimanë e vizituan. Pasi që pyeti për këtë i thanë: ata turpërohen të të vizitojnë për shkak borxheve që të kanë marrë. Kajs tha: Allahu e poshtëroftë pasurinë e cila i pengon vëllezërit të më vizitojnë, pastaj urdhëroi një tellall që të thërret: të gjithë ata që i kanë borxh Kajsit e kanë të falur. Në mbrëmje gati që nuk i thehet pragu i derës nga vizita e madhe e njerëzve.

**Ahmed Muadh Hakkij**

Përktheu: Agim Bekiri

(pjesë nga libri: katërdhjet hadithe mbi moralin)